

Dr. ALI JAKUPI

PER ATA
KOSOVA
ËSHTE
ëndërr

SHQIPTARËT NË VILAJETIN E SAMSUNIT -
(udhëpërshkrime-ese)

CONERT HONLTA

Sayit ve Bazar CONERT
Buyuk Cami Alt. Dursunlar Cd.
No: 3 Tel: 543 25 15-532 22 48
Site V.D. 215 002 8854 BAFRA

VATRA

Dr. ALI JAKUPI
PËR ATA KOSOVA ËSHTE ËNDËRR
- SHQIPTARËT NË VILAJETIN E SAMSUNIT -
(udhëpërshkrime-ese)

Prishtinë, më 12.08.1998
Z. Ali Bytyl-Belbry
me dashirë me të
mirë për prosperitetin
etj.

Ali Jakupi
(signature)

Botues

V A T R A

Dr. ALI JAKUPI

Redaktor
Jonuz Fetahaj

Recensent
Dr. Rifat Blaku

Kopertinën e realizoi
Valon J. Fetahu

**PËR ATA KOSOVA
ËSHTË ËNDËRR**

**- SHQIPTARËT NË VILAJETIN E SAMSUNIT -
(udhëpërshkrime-ese)**

Të drejtat e autorit mbrohen ©

**Prishtinë
1998**

Parathënie

Për temën që është objekt trajtimi kam pasur njohuri të mëhershme. Kontaktet familjare, të lidhura ndërmjet miqësive, bënë të mundur këmbimin e informacioneve të nduarnduarta, edhe për ambiente dhe mjedise të largëta.

Me kalimin e kohës, kërshëria veçsa shtoej për të njohur e ditur më mirë ekzotikën e atyre anëve, në të cilën të mirën dhe të keqen e ndajnë edhe bashkëkombasit, ata të cilët nga e njëjta vatrë, nga oxhaku i përbashkët, morën botën në sy dhe i përziën tymat (blozën) e oxhaqeve. Kompleksi i problemit gjithnjë bëhet më i qartë, siç thellohet edhe dëshira për pikëpjekje më të gjera, edhe më konkrete, sa për të shijuar realitetin e atjeshëm për së afërmi.

Shqiptarët patën fatin e keq në zhvillimin dhe konsolidimin e tyre për shkak të historisë njerë, siç e quajnë disa. Ata u katandisën anekënd botës, jo për shkaqe të ndonjë avanturizmi të natyrshëm, por për shkak të rrethanave të pavoritshme, për të hequr qafe zgjedhën e huaj shekullore.

Vërtetë, heqja e zgjedhës në vatrën e vet, nëpërmjet mënyrës së mërgimit, shpie në zgjedhë tjetër, bile në vend të huaj. Pra, nga krajata kalohet në krahinë. Për këtë, motivet mund të evidencohen dhe të peshohen deri në decimalet e shumënumërta. Shi për këtë, rasti i parë për udhëtimet relativisht të largëta, autorit ia hapi horizontin për hyrje në këtë labirint tejet interesant dhe tërheqës.

Shqiptarët gjatë historisë, afro 22 shekuj rresht

u ballafaquan me të gjitha të këqiat. Nga metodat pushtuese, nënshtruese, një numër i madh nga epoka në epokë u asimiluan, u tjetërsuan në popuj tjerë të Ballkanit dhe më gjerë. Asimilimit të tërësishëm i shtohet edhe pjesa e mërgatës nëpër shtete të ndryshme, ku ambientohet dhe i nënshtrohet çdo gjëje të natyrës përkatëse vendëse. Mbetja tjetër është elementi ekzistues edhe sot e kësaj dite në trojet e veta, i cili sadopak aq sa ka mbetur e ruan autoktoninë dhe kompaktësinë etnike në territor kompakt.

Problem më vete dhe i dhembshëm, është dhe mbetet shpërngulja e shqiptarëve nëpër shtete të tjera, saqë merrë përmasa dramatike dhe shndërrohet në proces historik. Pothuaj gjatë gjithë shekujve, me intensitete të diferencuara, vala e shpërnguljeve shënon tragjike pas tragjike, deri në përgjysmimin e popullatës, në zvogëlimin e saj katastrofik shumë herë me radhë. Shqiptarët sikur nuk gjetën ngrohtësi në vatrën e veta, prandaj kërkojnë strehim edhe në ato vende, të cilat kishin ushtruar pushtet dhe dhunë pikërisht mbi ta, mbi supet e këtyre njerëzve. Shpërnguljet bëhen nëpër vise dhe shtete të ndryshme, ku krijohen enklava, oaza, tërësi të vogla a të mëdha me pjesëtarë të kombit shqiptar, të cilët pas një kohe të caktuar mund të mbajnë veçse atributin e gjenezës së tyre, ngase qenia kombëtare u shndërrohet në një substancë tjetër.

Një prej vendeve që absorbon numër më të madh të shqiptarëve është Turqia. Për ta trajtuar këtë problem kompleks nevojitet angazhim i gjithanshëm dhe njohje serioze e problematikës. Nëpër Vilajetet më të mëdha dhe të rëndësishme për nga zhvillimi i aspekteve të ndryshme, është i pranishëm elementi shqiptar. Kjo problematikë

mund të ndriçohet me angazhimin e ekipeve përkatëse, jo për të zgjidhur problemin tashmë të përcaktuar, por, madje për të mos i humbasur gjurmët, si të mos kishin qenë kurrë. Materia që shqyrtohet në këtë punim është e kufizuar, ngase përfshin vetëm një pjesë të rajoneve ku jetojnë pjesëtarët e etnitetit shqiptarë. Është fjala për Vilajetin e Samsunit, trevë kjo që dikur e lënë dhe e prapambetur, ndërsa tash ka përmasa tjera të zhvillimit dhe të avancimit. Vilajeti i Samsunit dallohet veçanërisht me praninë e shqiptarëve, që nga fillimi i dekadës së dytë të shekullit XX, kur tokat shqiptare sërish okupohen nga pushteti serbomalazez.

Me të shkuar në atë ambient, mund të ndeshesh me elementin shqiptar, të dispersuar nëpër shumë vendbanime. Një prej komunave (kazave) që më së shumti ka pjesëtarë të kësaj origjine është Bafra. Sot e kësaj dite aty mbetet e gjallë shqipja, si dhe disa tipare tjera të traditës. Vera e vitit 1997 autorin e gjen në mesin e bashkatdhetarëve, të një gjaku që nuk mund të mohohet, sadoqë distanca kohore rritet dhe pa ndërprerje e bënë të veten.

Punimi me titull "*Për ata Kosova është ëndërr*", përkatësisht "*Shqiptarët në Vilajetin e Samsunit*" është i zhanrit të udhëpërshkrimeve dhe të eseve. Ka një origjinalitet të plotë, të faktografisë së gjallë, e cila, aq sa dihet, ka qenë temë e paprekur, sikur të ishte tabu. Me hyrje në gjurmimin e këtij segmenti, hapet një kapitull mjaft e rëndësishme, për t'u rrekur edhe me Vilajetet tjera, ku jetojnë shqiptarët anekënd Turqisë, por edhe nëpër vende tjera të botës.

Për të ndriçuar një pjesë sado të vogël të problemit, nevojiteshin të dhëna dhe prova konkrete në terren. Përmbajtjen e udhëpërshkrimeve dhe

të esëve që i prezantohet lexuesit, e begatojnë njerëzit e atyshëm, të cilët pa hezitim e hapin zemrën, që të shpjegojnë për të mirat dhe të këqijat, për motivet, krajetat dhe të arriturat, për vajin dhe nostalgjinë, për natyralizimin dhe pozicionimin e tashëm. Duke e lexuar këtë material, edhe refugjatët e tashëm në Perëndim mund ta gjejnë veten, të cilët duhet ta vënë gishtin në tamtha dhe të meditojnë për epilogun. Tragjika nuk përfundon, nuk përmbyllet me shpërnguljet për në Turqi. Ajo është shndërruar në sindrom dhe gati në kanceroid që metastazon gjithanshëm.

Në këtë rast i falënderoj të gjithë ata që ishin në cilësinë e bashkëbiseduesve, të cilët e patën rolin e dëshmitarit për diçka që ka ngjarë, që ngjanë aktualisht dhe do të ngjajë në të ardhmen. Natyrisht, në veçanti i shfaq mirënjohje nikoqirit, zotërinjve të familjes **Xhymerti** (vëllezërve **haxhi Ahmeti**, **haxhi Hasani** dhe të **Samiut** - të birit të Salihut të ndjerë). Të moshuarëve dhe të tjerëve që e kishin ruajtur thesarin e gjuhës dhe të traditës, e që janë për lëvdatë, iu jam mirënjohës.

Secilit pjesëmarrës në ndihmesën e botimit të këtij libri, i shfaq falenderime të përzemërta.

Prishtinë, tetor, 1997

Autori

1. SHEKUJT E PËRNDJEKJEVE

"Zanafilla e legjendës ka gjasë të jetë tepër e lashtë, por kurrësi më e lashtë se konflikti midis Ilirisë dhe Romës.."

Ismail Kadare

"...Pothuajse të gjitha banorët e pjesës perëndimore të Sanxhakut të Nishit të dorëzuar Serbisë, ishin shqiptar të besimit mysliman... prandaj kur ky sanxhak u pushtua nga ushtria serbe, popullsia nuk i bëri ballë pushtuesit. Ajo e tëra iku në Vilajetin e Kosovës duke lënë tërë vendin të braktisur."

John Ross

Në kontekstin e periudhave të gjata kohore, shekujt e përndjekjeve të shqiptarëve janë të shumtë. Edhe në shekujt më të hershëm, të Antikës së vonë, tronditjet zunë fill të dhimbshëm e të mallkuar. Pushtimet romake të tokave ilire sikur e filluan hallkën e parë të persekutimeve dhe të përndjekjeve; që më pastaj, vijimisht ngjajnë edhe hallka tjera, të cilat e përbëjnë një vargon të zinxhirëve të gjatë. Përkundër të dhënave se Perandoria Romake zbatoi metoda nga më të ndryshmet për të përvetësuar popullsinë autoktone, qoftë nëpërmjet ofiqeve nëpër rangjet ushtarake dhe ato civile, mbeti mjaft hapësirë për ushtrimin e masave të egra ndaj të padëgjueshmëve, për t'i shndërruar në qytetarë lo-

jalë. Këtyre të fundit, përveç represioneve tjera, iu shqiptohet masa e largimit nga trojet e veta, për të punuar nëpër minierat që eksploatoheshin, për të zënë vend në ambient të ri dhe për t'u martuar e krijuar familje, në mënyrë që sa më shpejt të ballafaqohen me asimilimin. Ishte kjo vala e natyrës tragjike, kur pedatjet e fiseve ilire fillimisht hyjnë në një etapë të re, të një shqetësimi fatal, i përcjellur nëpër të gjithë shekujt deri sot.

Perandoria Bizantine veçsa e shton intensitetin e tronditjeve. Zatën pushteti bizantin, një ndër më shovinistët (siç mund ta quajmë me terminologjinë aktuale të kohës), de jure, popujt e ndryshëm i vuri nën një ombrellë të përbashkët, nën lajtmotivin se Perandori është i dërguari i Zotit dhe se atij të gjithë pjesëtarët e popujve i takojnë, janë të njëjtë me sundimtarin. Në këtë veladon të errësirës dhe të mohimit të përgjithshëm mund të ngjatin rropatje nga më trishtueset, por që ato mbështeteshin në arsyetimin se çdo pëllëmbë e Perandorisë është e shenjtë, toka dhe njerëzit janë pronë e sundimtarit dhe e Zotit. Me këtë sikur iu mbylleshin të gjitha mundësitë që të vajtohet vendlindja, atdheu, në kupimin se tërë hapësira perandorake është e njëjtë. Pushtetet e atëherëshme me këtë e bënin të veten, arrinin të shpërngulnin popullatën ku të dojnë, me qëllime të caktuara: për të mbrojtur kufijt e gjerë të Perandorisë dhe në ato mjedise të harrohet përgjithmonë origjina nga mjedisi dhe nga kanë ardhur.

Pushtimi sllav i disa tokave shqiptare, në fund të shekullit XII dhe në fillim të shekullit XIII (kur definitivisht pushtohet Kosova), krijon një bizantizëm të ri, më skrupuloz dhe më të vrazhdë. Jo vetëm feja skizmatike, e kultivuar në Perandorinë Bizantine, që i jep rast të ushtrimit të trysisë së gjithanshme te popujt e

okupuar, por edhe egërsia e mbartur nga Karpatet, formësojnë klimë tejet të veçuar, kur atëbotë nuk zbatohet politika e debimit nga trojet e veta. Ngjanë e kundërta. Ligjet drakonike dushaniane nuk lejojnë ndërrimin e trojeve, ngase ekzistonte frika që pjesëtarët e konfesionit katolik të mos ndikojnë në prishjen e mendjeve të atyre që e kishin të përqafuar fenë orthodokse. Getoizimi i tillë kishte për qëllim, që nëpërmjet kristalizimit fetar skizmatik, presioneve të shumta, të realizohet asimilimi i plotë.

Me shpërngulje të dhunshme pasojnë shekujt XIII dhe XIV, kur qarqet greke, sidomos në rrethin e Janinës, ende pa ardhur pushteti turk, dëbuan në mënyrë masive masat shqiptare, për të shpopulluar këtë element autokton dhe Janinën me rrethinë të gjerë të popullzohë me popuj tjerë. Dhespoti grek, me emrin **Tomas**, në vitin 1380 e tutje **"arriti ta zbrazte Janinën nga banorët e saj burimorë"** (shih: Faik Konica Vepra II, Rilindja, Prishtinë, 1995, fq. 294). Episodi në fjalë është ngjarje tronditëse, e shënuar rrallëkund në histori. Aktet si kjo dhe të ngjashme vandale nuk kishin motiv eliminimin e pjesëtarëve që kanë fe tjetër, por faktikisht të atyre që kanë përkatësi tjetër nacionale. Shqiptarët e asaj kohe, që likuidoheshin edhe fizikisht, deri në vdekjen më barbare, duke iu nxjerrë sytë, ose duke iu prerë ndonjë gjymtyrë tjetër të trupit, dhe nga derdhja e gjakut, helmimi dhe çrregullimet tjera, vdesin në mënyrën më mizore, dalëngadalë, me tortura fizike e shpirtërore, që nuk mund të përshkruhen. Ata nuk persekutoheshin kështu nga shkak i fesë që e kishin (sepse ata kishin të njëjtën fe me grekërit, fenë orthodokse), porse qëllimi ishte që të çrrënjoset populli i vjetër, mbase edhe më i

vjetër se vet grekërit dhe në tokat shqiptare të bëhen zot të tjerët.

Nuk mund të thuhet se fate tragjike pati vetëm te shqiptarët. Në rruzullin tokësor, nëpër etapa të caktuara kohore, për shkaqe politike, ekonomike, strategjike, ndodhën ngjarje më tepër se tragjike. Mirëpo, shqiptarët nuk radhiten ndër ata popuj që, vërtetë, u ndeshën me krajatat më të mëdha, me përmbyllje të kaptinave të pakuptimta, në të cilat veçsa përkujtohet prejardhja e tyre, atdheu i tyre i dikurshëm.

Luftërat e famshme të Skënderbeut, të veçuara në tërë historinë e re të popujve të civilizuar, shqiptarëve u sollën famë dhe dinjitet të plotë, çfarë nuk e patën popujt tjerë, ndonëse në të njëjtën kohë janë shkaktare për pasoja të rënda, me përmasa të përgjysmimit të popullsisë. Turma e madhe e popullsisë e kaloi detin dhe shkeli në tokat e jugut të Italisë, popullsi kjo që sot e kësaj dite ruan kujtesën e mbartur nga gjenerata në gjeneratë për atdheun e stërgjyshërve dhe me nostalgji nuk pranë kurrë se kënduari këngën "**Moj e mira More...**".

Sikur thuajse janë burim i pashtershëm. Me zulm të madh i sfiduan zhdukjes së plotë. të syrgjynosur e të sakatosur, të përgjysmuar sa e sa herë, megjithatë, ishin më të fortë, më vital se sa shumë popuj që i përmend vetëm historia, të cilët u zhdukën përgjithnjë.

Pas luftërave austriako-turke (fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII), ku morën pjesë shqiptarët nën udhëheqjen e At Pjetër Bogdanit dhe të Tomë Raspasarit, epilogu përfundon me shpërngulje masive të shqiptarëve për në rrafshirat e Banatit dhe të Hungarisë.

Ndodhitë e shndërruara në refren të dhemb-

shëm nuk kanë të ndalur. Shekulli XIX dhe XX janë më të shënuarit për ndjekje dhe gjenocid të paparë. Vitet 1877/78 e tronditën popullsinë shqiptare, kur nga hordhitë shoveniste serbe, para tytave dhe bajonetave barbare u gjend një popullësi e tërë shqiptare, e cila me armën e dhunës detyrohet t'i lëshojë të shtatëqind vendbanimet e veta shekullore. Kosova bëhet vatër e dytë e tyre, porse për fat të keq, më vonë, për një numër të madh të kësaj popullate kjo trevë e re veçse shndërrohet në kujtesë, ngase marrin në sy edhe meridiane më të largëta.

Ripushtimi i tokave shqiptare nga serbomalazezët (1912) bëhet shkaktar i shpërnguljeve të mëvonshme. Shqiptarët detyrohen t'ia kthejnë shpinën për gjithnjë vatrave të tyre shekullore. Deri në Luftën e Dytë Botërore trualli shqiptar shpopullzohet me qindra mija frymë, për të vazhduar edhe pas Luftës së Dytë Botërore me numër edhe më të madh. Shqiptarët, të cilët mezi u çliruan nga zgjedha e Perandorisë Otomane, nuk gjetën zgjidhje tjetër përveç t'i kthehen përsëri nënshtrimit të sojit të Anadollit. Këtë përcaktim mbase ua mundësoi feja e përbashkët islame, prandaj sipas përshtypjeve të përfituara nga bisedat e lira, mund të konkludohet se më lehtë e patën të hyjnë nën sqetullën e sundimitarit të mëhershëm, të mëparshëm se sa të pranojnë një përbindësh, të cilit që nga Mesjeta i njiheshin kthetrat.

Shembull, vërtetë, i përndjekjeve është ky i sotmi, i shekullit XX, i cili edhe në përmbyllje të tij karakterizohet si mjaft tragjik, ngase më tepër se kurrë, më se gjysmë milioni i shqiptarëve, të të gjitha moshave ia mësyen qendrës dhe veriut të Evropës, për të mbijetuar të sotmen, por, me parashikime reale, për të humbasë çdo gjë kombëtare në të

ardhmën e afërt, pa kaluar shumë kohë. Njëkohësisht shqiptarët nga Shqipëria sikur gjejnë prehje në Greqi (më se treqind mijë, të cilët në mënyrën më të pakuptimtë edhe i ndërrojnë emrat, gjest ky që nuk mund të arsyetohet me asnjë kushtëzim, as me sigurimin e ekzistencës materiale etj.), madje në Itali e gjetkë. Me fjalë të tjera, shqiptarët e të gjitha viseve, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva e Bujanoci, Çamëria, nëpër shumë periudha e vite vërshojnë nëpër vende tjera, ku nëpërmjet strehimit dhe padijes, e gjejnë humbëtirën kombëtare.

2. KUSH E HAPI RRUGËN PËR TURQI?

*"O nizamë, nizamë të tretun,
Banu bashkë e çoni 'j letër,
A jeni gjallë, a jeni dekun?
- S'jena gjallë, as s'jena dekun,
Në Stamoll jena të tretun!
Në Stamoll, në Anadoll,
Gur'e pluma po ngarkojm',
Gjuhën turçe s'mund ta mësojmë,
Se s'e dona, as s'na donë.*

Populllore

Për shqiptarët, sikurse edhe për popujt tjerë që ishin të sunduar pesë shekuj nga Sulltani, edhe viset më të largëta të Anadollit, në njëfarë dore, ishin ngapak të njohura. Nëse asgjë tjetër, një numër i vogël kishte kaluar vite të tëra nëpër ato vise të largëta, duke shërbyer në radhët e ushtrisë osmane. Një numër tjetër, jo aq i dukshëm, këtë klimë dhe ambient e kishin shijuar nga gradat dhe titujt, udhëheqjet dhe drejtimet deri në nivelet më të larta.

Prandaj, është e pamundur që gjatë sundimit osman të mos formoheshin enklava të vogla të shqiptarëve edhe në Azinë e Vogël. Logjika imponon konkludimin se, si gjithnjë, kishte lakmitarë të pasurisë, të karrierizmit dhe të famës. Kjo shtresë,

ndonëse e pakët me numër, mund të konsiderohet si çelës për hapjen e dyerve drejt këtyre hapësirave.

Me kalimin e viteve, të situatave dhe të ndryshimeve të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore dhe politike, krijohen rrethana, kushte të reja. Edhe gjatë sundimit osman, shqiptarët, që në të gjitha viset kishin përjetuar ditë përmytëse, kur në mënyrë masive marrin botën në sy, për të ruajtur diç, pa e pasur të qartë humbasjen e çdo gjëje, mbi të gjitha atë që është thelbësore, kombëtarën. Skena të ngjashme u shënuan në dyndjet masive për në Itali (Sicili, Kalabri), në Greqi, në Vojvodinë dhe në Hungari si dhe më vonë për në Turqi. Shqiptarët e të gjitha këtyre epokave donin që të mos e humbnin fenë dhe dinjitetin kombëtar, mirëpo, në këto orvatje të ruajtjes, e humbën atë më qenësoren - kombin.

Në këto raste është vështirë të matet ku është e drejta: të ngelin aty ku ishin apo të ikin. Pa dyshim, mbizotëron e para, sepse këtu diç do të ruhej në krahasim me ato mjedise, ku dalëngadalë pësojnë ndryshime të pandalshme.

Embrionet e enklavave shqiptare në Anadoll janë tepër të vogla, përkatësisht të pashënuara. Ato veçse mund të shërbejnë si njëra nga motivet tjera për hapjen e rrugës për Turqi. Këtë shtet, siç mbeti dhe u formësua pas shpërbërjes së Perandorisë osmane, shqiptarët detyrohen të përfaqësojnë pikërisht pas okupimit sllav të tokave shqiptare, në vitin 1912. Ishte ky moment i papresedencë, ku pas çlirimit të vendit nga vet forcat shqiptare, ndodhë një situatë trishtuese, kur në vend të kremtimit të fitores, shkel çizmja shoveniste okupuese serbe e malazeze, të gllabëruesit të fshehur si skilë dhe që ishte i mbështetur në Rusinë cariste, si dhe në Forcat e Mëdha tjera, siç ishin Franca, Anglia etj.

Ky përbindësh i ri iu shtini datën në palcë popullësisë së pambrojtur, e cila edhe ashtu e varfër, ishte tëholluar edhe më shumë gjatë Lëvizjes së Përgjithshme Popullore të viteve 1908-1912. Popullsia e ardhur nga Sanxhaku i Nishit, e kishte ende të freskët dëbimin me dhunë, masakrën e paparë, të palarën e sllavit, të cilën pushtuesi e kishte shndërruar në kreni. Ata veçsa kishin filluar të mëkëmben në Kosovë, të krijojnë plang e stabilitet, të formësojnë marrëdhënie e fqinjësi të reja. Këtë fije shprese, të gjendur në një rrethinë, ku disi mund të jetohej, e shkëput zullumi orthodoks sllav, i cili njihet herët me brutalitetin dhe vulgaritetin e pakrahasueshëm.

Asnjë okupator nuk është i mirë, porse disa dallohen nga të tjerët. Në rast se pushtuesi është fqinj imediat, primitiv, i pangopur për grabitje dhe plaçkitje, sepse nuk e ka krijuar bazamentin historik të mirëqenies nga djersa dhe përpjekjet e veta dinjitoze, bëhet më i uritur se egërsira dhe posa t'i jepet rasti bënë ç'mundet, çka nuk e mbërthen as mendja e njeriut. Ky farë soji tradicionalisht mbështetje e ka dhunën, korrupcionin, mitet, dredhitë dhe gënjeshtren. Prandaj, kush bie në kthetrat e tij, duhet të jetë tepër i vendosur që t'ia topitë dhëmbët e mprehtë. Në të vërtetë, po të hyhet thellë në përmbajtjen e problemit, në anatominë e këtij organizmi patologjik, mund të shihet se nuk është i pamposhtur, nuk është aq i fortë siç duket. Përkundrazi, është aq i ligë, saqë i pushtuari kur është syçelë dhe i vendosur, i mobilizuar si duhet, këtë në çdo kohë mund ta gjunjëzojë dhe ta vë në pozitë të mjerë.

Shqiptarët ishin të zënë në dy fronte. Lufta katërvjeçare deri në çlirim i kishte pllakosur, si në pikëpamje ekonomike, po ashtu edhe në atë njerëzore. Faktikisht, ky komb historikisht vuan nga

mungesa e udhëheqësve, të prijësve karizmatikë, të cilët proceset e filluara do t'i përmbyllin deri në fund. Nga ky aspekt, shqiptarët historikisht, pothuajse gjithmonë, pësuan humbje, ndërsa fitoret edhe kur ngjanin ishin të pjesërishme, ose plotësisht të padukshme. Në këtë drejtim edhe luftërat për çlirim të këtij shekulli nuk kurorëzohen me fitore konzistente e shi për këtë fitorja shumë shpejtë shndërrohet në disfatë.

Okupatori sllav dhe metodat drakonike dhe tejet të vrazhda popullësinë e pambrojtur e vënë para një sprove të rëndë: për të qenë apo për të mos qenë. Marrja e vendimeve se ç'duhet bërë, duhet ta kishte taban edhe forcën. Kjo faktikisht për ne atë kohë ishte shterrur. Popullsia autoktone shqiptare e Kosovës (jerlitë) kishin e nuk kishin sa duhet prova për okupatorin. Si duket te shqiptarët nuk është i zgjedhur një dimension psikologjik, i cili vetëm kur e provon vet, e di peshën e barrës, ndërsa për të tjerët nuk formon paradispozita të mjaftueshme për peshën e realitetit. Në kohën e sundimit otoman, popullsia serbe në Kosovë e në rajonin e Sanxhakut të Nishit që ishte pakicë, më tepër e fliste gjuhën shqipe se sa atë amtare. Këtë gjest nuk e bënte nga dashuria që e kultivonte ndaj kësaj gjuhe, por nga mbështetja që e gjenin te shqiptarët. Në përgjithësi ishin të nënshtruar, dy popuj që jetonin në një truall, por që kishin pushtues të përbashkët. Së këndejmi, nuk kishin konflikte të theksuara dhe, natyrisht së bashku e ëndërronin lirinë. Ky ishte shkaku që këta nuk kishin hyrë thellë në djallëzitë e këtij fqinji të "qetë" e të "urtë". Vitet dhe shekujt e kishin bërë të vetën. Mesjeta tashmë ishte harruar. Pushteti shtypës i asaj kohe ishte shënuar në analet historike, por këtë nuk e dinin shqiptarët e shumë gjeneratave

të mëvonshme. Një popull analfabet, megjithatë, me dinjitet e ruan mëvetësinë, traditën, anipse më tepër nëpërmjet gojëdhënave, kultivimit të folklorit dhe të kulturës së lashtë.

Realisht ishin të njohtuar nga vëllezërit e tyre të dëbuar nga Toplica, Kosanica e Pusta Reka, përkatësisht nga tërë Sanxhaku i Nishit. Dosido, kjo kishte krijuar rrëqethje, keqardhje, indinjatë, ndonëse nuk ishte barazi me përjetimin e drejtpërdrejtë. Është karakteristike edhe vonesa e formësimit të ndjenjës kombëtare. Do të ishte iluzore të thuhet se shqiptarët atëbotë ishin të formësuar kombëtarisht. Ky dimension edhe sot e kësaj dite dukshëm është problematik. Në mënyrë spontane, por edhe nga rutina e krijuar kishin bindje se guri nuk duhet të luhet nga vendi, sepse pastaj atë e rrokullisë kush e kah të dojë. Prandaj, dhuna dhe terrori serb ishte i qartë, mirëpo gjithësesi duhet t'i bëhet ballë, ngase çështja më madhore është mosikja nga atdheu.

Për ardhasakët (muhaxherët) ishte diç më specifike, më dramatike. Për vetëm 35 vjet të intervalit kohor ngjanë tronditja e dytë, okupimi i sërishëm. Pjesa dërrmuese e popullsisë ende e mbanin të freskët krahajatën e pashembullt, të pastrimit të plotë etnik të trojeve të tyre; mbanin mend si e kanë lënë pronësinë dhe pasurinë e vet, si iu kanë mbetur foshnjat në rrugë e s'kanë pasur si t'i mbrojnë, si janë shlyer nga harta e të parëve të tyre. Dhe, ja njeriu duhet të rropatet të jetojë, të ndërtojë kulm të ri. Mirëpo, në këtë nismë, ende të pa mbyllur nga plagët e dhembjes, si uragan paraqitet i njëjti përbindësh. Faktikisht, duke i ditur masakrat dhe logjikën e shtazës më të egër, pjesëtarët e muhaxherisë kishin shumë gjëra të qarta, më

shqetësuese. Hordhitë pushtuese nuk ndanin popullsinë shqiptare, por në të gjithë, si në një ushtronin gjenocid, terrorizëm dhe shtypje marramendëse. Rrezistenca ishte pothuaj e shterrur, e pafuqishme. Ata që kishin dalë nëpër male bënë aq sa mundën rrezistencë. Disa vriten, disa të tjerë nuk kanë kah t'ia mbajnë. Nga alternativat e mangëta duhet të zgjedhin ndonjërin nga më të arsyeshmet, sipas bindjes së tyre.

Në këtë konglomerat të problemeve dikush e zgjedh udhën e mërgimit. Grupi i shqiptarëve që ishte më i dëmtuar, i dhunuar dhe i nënçmuar që në raundin e parë, tashmë në raundin e dytë, me rastin e ballafaqimit me pushtetin e mëparshëm, me okupatorin e njëjtë, i cili dje i kishte dëbuar me dhunë, reprezalie të nduarnduarshme, kishte vështirësi ta bind veten se mund të jetohej nën këto kthetra. Dhe, si një prej fatkeqësive më ngushlluese, zgjedhet ikja e përgjithmonshme nga vatrën e ngrohta shqiptare.

Marrëdhëniet e tilla mund të mirren si pretekst real për të marrë vendim për emigrim masiv në vende të huaja. Pushtetmbajtësit serbomalazez ishin të përgatitur heret për shtypjen e shqiptarit si limonin. Masat fizike, psikologjike dhe shfarosëse iu shërbenin pushtuesve si armë efikase për ta bindur këtë popull se nuk duhet të jetojë në këto kushte, sepse nuk mund të kenë kurrëfarë ekzistence, as minimale. Në këtë mënyrë, në rreshtin e parë gjenden ata që janë me vajë në buzë dhe nuk hezitojnë shumë e të vendosin për fatin e tyre. Është plotësisht e kuptueshme se shteti serb kombinon metoda nga më të ndryshmet. Te shtresa e palëkundshme, e lidhur me truallin dhe vatrën e të parëve, përdore represione specifike, deri në shfarosje fizike, sa për t'i trembur ata dhe të tjerët se këtu nuk mund të kenë

jetesë. Shtresën tjetër, që ishte neutrale e dhënë më pak ndaj kauzës atdhetdashëse, tentonte ta përvetësojë në njëfarë mënyre tjetër. Nëse nuk ia arrinin, në kohë të caktuar sikur nuk iu bënë keq dhe i ndihmonin, me qëllim që t'i bindin se nuk kanë armiqësi kundrejt tyre. Sjelljet në fjalë reflektohen në "ndihmat e dhëna" për të rregulluar dokumentacionin, për të gjetur lidhje me ndonjë autoritet, për t'iu gjetur kanalet për dhënie të mitos. Të gjitha këto përkohë me ndihmën për shpërngulje. Është e çuditshme, por reale se udhën e mërgimit të parët e marrin pikërisht shtresa që kishte një lloj lojaliteti, kishte ndonjë miqësi me fqinjët, me autoritetet serbe.

Kësisoj, çelës për hapjen e dyerve për Turqi e gjetkë s'është asgjë tjetër, përveç dhunës, platformës së gjenocidit dhe politikës së definuar për shfarosjen e shqiptarëve. Pushtuesi sllav krijon parakushtet për hapjen e rrugës për në Turqi, një rrugë të gjatë e të përsëritshme, që zgjatë një shekull, deri tash. Pas ngopjes së Anadollit hapen rrugë të tjera për në Evropë dhe në kontinentet tjera. Tragjika e shpërnguljes rrjedh, rrjedh dhe, fatkeqësisht, vetëm rrjedh.



Trung i trashë, i lashtë, me rrënjë të thella, por...
(Foto: H. Reka)

3. SHQIPTARËT NËPËR VILAJETET E TURQISË

*Po kndoj kangën, o mërgimtarë,
Po kndoj kangën, o për shtegtarë,
Po kndoj kangën, o shok't e mi,
Qi po tresin, o një nga një.*

Popullore

Fillimisht elementi shqiptar, përveç rasteve të mëhershme, vendoset në Azinë e Vogël, pas kryerjes së shërbimit ushtarak, për shkak të martesave më vendëse, pas shkollimit në ato qendra të atëhershme, ose për shkak të ushtrimit të funksioneve të ndryshme. Ajo derë mësyhet dukshëm veçmas në vitet 1877-78, pas dëbimit me dhunë të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit. Luftërat Ballkanike hapin kaptinë të re, kanal që kohë të gjatë i ndjellë për në Turqi. Për t'u përcaktuar në rrugën e pakthim, nuk është vetëm spontaniteti dhe pamundësia për t'i bërë ballë regjimit gjakpirës, porse një gjë të tillë e vërejtën dijetarë të ndryshëm, siç është Gjergj Fishta (Shih: Revista "Përparimi", 3-4/1991). Skënder Rizaj lidhur me këtë thotë: "Ndonëse pozita e shqiptarëve sikurse edhe e popujve të tjerë, sidomos nga shekulli XVII e këtej, në kuadrin e Perandorisë Osmane, sa vinte keqësohej, megjithatë, shqiptarët në kuadrin e Perandorisë Osmane, ishin në gjendje më të lak-

mueshme sesa nën sundimin e mëvonshëm serbomalazez (pas vitit 1912). Përveç kësaj, në kuadrin e Perandorisë Osmane shqiptarët ishin në kompaktësi dhe pushtetmbajtës, kurse në kuadrin e Serbisë dhe të Malit të Zi, e më vonë të Jugosllavisë shqiptarët ishin (janë) të shkapërderdhur dhe pa kurrfarë të drejte politike" (Giuseppe Catapano, Nermin Vlora-Falaschi, Skender Rizaj, Shqiptarët - popull i ndarë - The albanians - a divided nation, libri I, Pejë, 1996, fq. 184, 185).

Pra, nuk është fjala për errësirën e mendjes së një pjese të madhe të popullsisë shqiptare, por zulumi dhe presioni është dimension tjetër dhe vendimtar. Ata që ishin të kafshuar nga shlliga e mëhershme, e kishin vështirë t'i nënshtrohen përsëri këtij helmi kaq të rëndë. Dhe, si rezultat e gjendjes së papresedencë, mbetet vetëm një rrugë e hapur, një rrugë e pa dëshiruar, e pa shtegdalje tjetër. Shkuarja në gjirin e pushtuesit pesë shekullor dhe gjetja strehim nën sjetullën e tij, dikur të urreyer dhe të shkatërruar edhe nga ky element, i cili tashmë detyrohet ta dojë, paraqet një lloj diskursi të veçantë. Hapi i marrë është për analizë gjithëfarëshe, si nga aspekti sociologjik, poashtu edhe nga ai psikologjik. Padyshim, sublimimi i parametrave real, është mjaft i megjulluar, i vështirë të ndriçohet si duhet. Megjithatë, nuk është çështje që nuk mund të trajtohet, bile me përmasa të argumentuara dhe objektive. Lidhur me këtë, ekziston aksioma e pa ndryshuar: se vepër madhore, e pa zëvendësuar me asgjë tjetër, është ruajtja e kombit, e atdheut. Në këtë spektër fshihen shumë parakushte dhe kushte, shumë fakte relevante. Sidoqoftë, shqiptarët nuk janë të pafajshëm. Edhe pse në një mënyrë mund të arsyetohen për psikologjinë e robrit, të cilën nuk kanë qenë në gjendje të mos e parapëlqejnë dhe përqafojnë, si

pasojë e robërisë shumëshekullore, mirëpo në këtë kreaturë, ky komb në vete përmban diç specifike, në të cilën nuk flen arsyetimi i plotë. Këtë specifikë nuk e kanë të gjithë popujt tjerë. Falë lashtësisë, kulturës së moçme, rrënjës së thellë, begatisë materiale e shpirtërore, nuk u zhduk tërësisht.

Tkurrja, zvogëlimi i tij në numër e në territor është një dëshmi tragjike, se si shkrihet, sakatoset populli i gjerë, por që gjendet në shënjestër të gllabruësve, të fqinjëve që gjithmonë qenë armiq, edhe atëherë kur u shtirën si miq. Përkundër kësaj rrethane fatkeqe, vitaliteti shqiptar fluturonte për mbijetesën e mundshme, të sfidimit titanik të situatave plotësisht shfarosëse. Nga kjo prizëm mund të thellohet problemi dhe të paraqiten një mori pyetjesh konkrete, siç janë: çfarë funksioni të njëkahshëm kanë sfidimi e fundosja; rrezistenca dhe tkurrja; shërbimi dhe fama në llogari të të tjerëve dhe ikja nga ajo që është vendimtare, më shumë se e shenjtë etj. etj. Në këtë rast përgjigjet e sakta marrin primesa shqetësimi, ndërlikohen në definimin e rezultateve dhe të konstatimeve objektive.

Nuk mund t'i iket të së vërtetës, që përkon me faktin se ky popull formësimin e dimensionit të kombit e ka të vonuar, të megjulluar, ose pjesërisht të padefinuar kurrë e si duhet. Në këtë rast nuk është tema e thellimit të eseut në realitetin e hidhur, çka si parësore paraqitet dështimi i të madhërishmës, të asaj që quhet ekzistenciale, e pa humbur tërësisht, e që sot e kësaj dite nuk ekziston vetëdija e plotë për ruajtjen e trungut dhe të kurorës së tij, pa ia prerë, këputur dita më ditë nga një degë.

Fillimi i këtij shekulli shënon laryshinë, si në aspektin e të arriturave, ashtu edhe në aspektin e humbjeve. I pamohueshëm është rezultati i formimit të një shteti shqiptar, anipse të sakatosur dhe të

gjymtuar, me toka e njerëz, të lërë jashtë gjiut të vet me asimetri labile, e cila do të krijojë pasoja deri në rindërtimin e saj përfundimtar. Mund të thuhet se me këtë u arritën dy çështje përnjëherë:

1. Shënimi në hartë i një shteti të ri, i cili është shumë i rëndësishëm për shqiptarët edhe kështu siç është, ndërsa shumë i padëshirueshëm për fqinjët e paskrupulltë dhe,

2. Identifikimi i kombit, që për shkak të rrethanave është i vonuar, por askush, me përjashtim të kuazishkencës sllavo-greke, këtë fakt nuk mund të mohojë, as në periudhat më të hershme të aktivitetit.

Kurorëzimi i mangët i suksesit gjithmonë përcillet me mangësi. Lidhja Shqiptare e Prizrenit veçsa u konfirmua, se me gjithë kundërshtimet e fqinjëve fanatik e gllabërues, të Fuqive të Mëdha, për shkak të interesave të ndërlidhura me Ballkanin e më gjerë, nuk mund të shuhet tërësisht, ndonëse nga të Katër Vilajetet Shqiptare që ishin nën administrimin osman, në shtetin e ri përfshihen më pak se një e treta e tyre. Rëndësia e shtetit shqiptar është e padiskutueshme për shqiptarët, siç është e vërteta tjetër se, shkelja flagrante e të drejtës shqiptare do të ketë pasoja të pandërprera, deri në zgjedhjen e plotë të problemit.

Pikërisht nga kjo sakatosje, me të cilën që në start pushtuesve sllav dhe grek iu jepet mundësia që shqiptarët t'i dëbojnë me dhunë nga trojet e veta, do të lindin problemet e mëpastajme. Është çështje multidisiplinare thellimi i vështirimit rreth mentalitetit të popujve që ikin nga vatrat stërgjyshore. Kjo më së shumti konsiston me dimensionet politike, të një politike të padrejtë e asimiluese, gjë që populli sado i vetëdijshëm të jetë, udhërrëfyes i vetes, nuk e ka lehtë të flakë politikën e përbindëshit. Regjimi okupues

veçse rrënon, dezorienton dhe shkel mbi të gjithë, në këtë rast mbi shqiptarët, që nuk janë të sojit të tij.

Prandaj, ndër format ekzistenciale zgjedhet riatdhesimi në Turqi. Do të ishte më pak fatale po të fillohej kjo kaptinë dhe të përmbyllet paksa më shpejtë. Realisht, kjo kaptinë jo vetëm që nuk u përmbyll, por mbeti gjithnjë e më e zgjeruar. Kështu, për në Turqi, nga Kosova dhe viset tjera shqiptare jashtë Shqipërisë shpërnguljet fillojnë me hov të veçantë në vitet 1912-1913-1914, për të vazhduar pas Luftës së Parë Botërore, në vitet e njëzeta dhe për t'u intensifikuar në vitet e tridhjeta, sidomos pas nënshkrimit të kontratës në mes Turqisë dhe Jugosllavisë së Versajit, në vitin 1938. Me këtë marrëveshje famëkeqe parashihet shpërngulja e më se 400 mijë frymëve shqiptare, do të thotë pothuaj tërësisht elementi shqiptar.

Ç'është edhe më keq, atë që pengoi Lufta e Dytë Botërore, realizohet pas saj, në kohën e regjimit socialist, kur nga Beogradi trumpetohej politikë e rreme, si gjithnjë më parë, por me petk të ri. Marrëveshja e quajtur xhentëlmene e arritur në mes Titos dhe autoriteteve turke në vitin 1953, e zgjeron edhe më tepër kanalin tragjik të udhëtimeve të pakthim për në Turqi. Kësisoj, tërë shekulli XX, përkundër një rrezatimi të pjesërishëm, me një shtet të vogël, por që e simbolizon të vërtetën për ekzistencën e pamohueshme të popullit shqiptar, skenat tjera të errëta e tejkalojnë çfarëdo baraspeshe.

Meqë fjala është për vetëm një rajon, ku shqiptarët e gjejnë follenë e riatdhesimit, është e arsyeshme më tepër përqëndrimi të bëhet në te, ndonëse paraqet mangësi, ngase madhësia e masivit të ekzodit dhe vendosja nëpër territore është i madh.


Nëpër etapat e përmendura kohore në Turqi krijohen enklava tipike me shqiptarë, të cilët në

kuptimin e përgjithësuar mund të thuhet se janë të shtrirë anekënd Turqisë së sotme. Nga të dhënat që mund të verifikohen nëpërmjet burimeve të ndryshme, masë e madhe e shqiptarëve të riatdhesuar janë të shtrirë në Vilajete të shumta të Turqisë. Ndër këto Vilajete mund të veçohen: Adapazari, Stambolli, Brusa, Eskishehir, Kytahia, Manisa, Izmiri, Ajden, Adana, Ankara, Tokat, Samsun, Elazey, Edrene e tjerë.



Shqiptarë të Kosovës të dëbuar me dhunë nga trojet e tyre prej pushtuesve serbë në vitin 1912

Duke e vënë në peshojë dispersionin (shpërndarjen) e shqiptarëve nëpër viset e Turqisë, mund të arrihet te përfundimi se politika lidhur me pranimin e shqiptarëve ka qenë e dispersuar. Sa herë janë hapur dyert për këtë etni, gjërat, krieteret për vendosjen e tyre kanë qenë me kohë të definuara. Sipas të dhënave që fitohen nga bashkëbiseduesit (të cilët nuk kanë pretendime analitike) edhe nga burimet tjera mësohet se politika turke për shqiptarët ishte e trefishtë. Së pari, shqiptarëve iu mundësohej vendbanimi nëpër shkretëtirat, gjysëmshkretëtirat, përkatësisht nëpër vendet e largëta kufitare, në pjesët e lindjes e të perëndimit, ku do të jenë element



Përveç në Vilajetet e shënuara pothuajse në të gjitha viset tjera të Turqisë ka popullsi me origjinë shqiptare

i qëndresës dhe i mbrojtjes së kufijve. Meqë në ato mjedise kushtet ishin të disfavorshme për jetesë, vendosja bëhej pa kurrfarë pagese, gratis. Së dyti, shqiptarët kishin mundësi të gjejnë fole edhe nëpër kryeqendra të shquara, siç është Stambolli, Izmiri etj., me rrethina të përafërta, porse për këte ishin të detyruar ta blejnë pasurinë e patundshme. Familja e Brahim Ismajlit (atëherë Amitoviq) nga Koliqi (komuna e Prishtinës) në vitin 1925 shpërngulen dhe vendosen Turgutli (në afërsi të Izmirit). Duke mos qenë të kënaqur pas gjashtë muajsh kthehen prapa (shih: pasaportin dhe fotografinë e familjes). Së treti, në pjesën Evropiane të Turqisë, nuk ekzistonte disponimi i autoriteteve turke për formimin e enklavave të gjera me elementin shqiptar. Mbase një qëndrim i tillë mund të arsyetohej me faktin se shqiptarët duhet të jenë sa më larg nga atdheu i tyre i mëparshëm, për të pasur kontaktet më të rralla dhe influencim të paktë, ose fare të pashënuar.

Për secilin përcaktim ka argumente të shumta. Bie fjala, Sylejman Lladovci me të dy vëllezërit në vitin 1925 shpërngulen në Keshan (pjesë evropiane e Turqisë në kufi me Greqinë). Të tre vëllezërit ishin të martuar dhe kishin fëmijë. Këta i shpërndajnë nëpër fshatra të ndryshme, meqë sipas dispozitave nuk lejoheshin më shumë se dy familje shqiptare në vendosen në një vendbanim (fshat).

Për të hyrë në realitetin e këtyre territoreve lypset mund dhe kohë e konsiderueshme. Është simptomatike se për këtë element dihet pak. Më tepër ekzistojnë përfolje orale, se sa ndonjë realitet i argumentuar. Autori i këtij shkrimi mund të thellohet më tepër në Vilajetin e Samsunit, duke e veçuar kazanë (komunën) e Bafrës, një çerdhe të vërtetë me shqiptarë.

4. VILAJETI I SAMSUNIT E MBANË GJALLË SHQIPEN

*"Pra, mallkue njai bir shqyptari,
Qi ketë gjuhë të Perendis,
Trashigim, qi na la i Pari,
Trashigim s'ia lën ai fmis,
Edhe atij i u thaftë, po, goja,
Qi e përbuzë ketë gjuhë hyjnore;
Qi n'gjuhë t'huej, ku'r s'asht nevoja,
Flet e t'veten lën mbas dore".*

Gjergj Fishta

Qasja japoneze se koha nuk duhet të kalohet kot dhe për këtë më parë duhet të planifikohet çka të vështrohet në mjedisin e caktuar, çka të venerohet, të nënvizohet dhe në ç'mënyrë të bëhet përceptimi, ndihmon shumë në angazhimin e mirëfilltë të njerëzve. Nga kjo thënie imponohet përcaktimi që në ndonjë udhëtim të gjatë të kihet kujdes se çka të gjurmohet, me qëllim të trajtimit të segmenteve që janë në interes më të gjerë.

Të marrësh udhën për në tokat anadollake, do të thotë të kalosh në një hapësirë të largët, të panjohur dhe herë herë ekzotike. Po të udhëtohet pa ndonjë pikësynim, pa dyshim, të kaplon lodhja dhe monotonia, sepse si çdokund edhe këtu mund të hasësh në lartësira dhe rrafshira, male të rrëpinjtë,

fusha e ara, lumenj e shkëmbinj, si dhe në gjelbërime, që përbëjnë peizazhe, të thot mendja, të pafundme. Mirëpo, koncepti i përpunuar që në start, thadrimi në kokë i qëllimit të caktuar, mundësojnë rrugëtim më të rehatshëm, pak më të lehtë, prej nga lindin përfytyrime e imagjinata nga më të ndryshmet. Kureshtja shtohet edhe më tepër kur e di se shkelë në tokën, ku bashkëkombasit e dikurshëm aty janë të riatdhesuar, ku sado e zvetnuar, nuk është e zhdukur tërësisht rrënja e trungut të përbashkët.

Në udhëtimin e rëndomtë, pothuaj nuk vëren asgjë të jashtëzakonshme. Shteti turk, megjithatë, lë mbresa të pashlyeshme, sepse nga të sillesh vërehet gjallëri, ndërtim, me fjalë tjera një distancë e dukshme kundrejt kohës së mëparshme. Natyrisht, preokupimi për t'u takuar më atë që e dëshiron, është i ndieshëm, ndonëse nuk sjell befasira para dhe posa të arrihet te caku i paraparë. Bredhjet më të shumta mund të ndërrojnë planin, kahen, edhepse bezdisjet janë të përfshira në hapësirë të kufizuar, të quajtur arenë e shpërndarjes së gjerë të elementit të përbashkët, tashmë të ndarë, të ndarë edhe gjeografikisht edhe kombëtarisht, si dhe në çdo aspekt tjetër.

Kur udhëtohet drejt objektivit të synuar, çfarëdo rrugëtimi, sado i gjatë dhe i mundimshëm, nuk është i parrealizueshëm. Për në Samsun, një lima i largët, që çdo herë fërkohet me ujë jo aq të njelmët dhe të vakët të Detit të Zi, kalohet rrugë relativisht e gjatë. Për të arritur në Samsun, në qytetin modern dhe në limanin me renome ndërkombëtare, duhet të kalohet një rrugë, përafërsisht aq sa është gjatësia e rrugës nga Prishtina deri në Stamboll, d.m.th. vetëm nëpër Turqi kalohet një rrugëtim prej afro 1000 kilometra.


Samsuni është kryeqendër e Vilajetit omonim. Shtrihet në një rrafshirë absolute, në brigjet e Detit të Zi, ku puhia e detit çdo ditë i ledhaton fytyrat e njerëzve, të banorëve të përhershëm, të turistëve dhe të kalimtarëve të rastit. Qyteti ka më se 400 mijë banorë dhe gjithësesi e ka edhe historikun që flet për lashtësinë e theksuar. Është qendër universitare. Objektet e fakulteteve gjenden në një kodrinë paksa më të lartë, në rrugën për në Bafrā (në të majtë) dhe thuasje qytetit në çdo kohë i rrëfejnë se dituria është mbi të gjitha. Në aspektin administrativ përbëhet nga kazatë (komunat), siç është ajo e Samsunit, e Tekekojyt, e Bafrës, e Allaçamit, e Sinopit, e Gezles, e Merzifunit, e 19 Mays, e Kavak, e Havza, e Vezirkoprū etj.

Me rëndësi të veçantë është prania e dukshme e elementit shqiptar nëpër shumë vendbanime të këtij Vilajeti. Prania e shqiptarëve është dominuese në kazanë e Bafrës, madje për nga numri dhe dendësia radhiten Samsuni, Merzifuni, Tekekojy, Allaçami, Sinopi e tjerë. Në këtë rrafshirë bregdetare të begatë me kodra jo aq të rrëpinjëta, një pjesë e dukshme e popullit shqiptarë e gjeti atdheun e dytë. Natyrisht, gjendja e tashme zhvillimore nuk mund të krahasohet me asnjë periudhë tjetër.

Samsuni, kryeqendra e Vilajetit, si një forcë magnetike i gëlltiti shqiptarët, ishte qytezë, të cilën më tepër e njihnin marinarët e Turqisë dhe të vendeve të tjera. Së bashku me marinarët i pranonte dhe i përcillte edhe udhëtarët e ndryshëm.

Në kuvlinë e vet kishte bujtina të mjaftueshme, por për ata që mendonin të jetojnë më gjatë, u preferohej rrethina e Samsunit, e gjerë dhe e gjatë, ku do të mund të vendoseshin ardhacakët. Me kalimin e kohës Samsuni modernizohet dhe e fiton

famën e limanit modern me përmasa ndërkombëtare dhe, njëkohësisht, qyteti zgjerohet, modernohet në mbështetje me standardet bashkëkohore.



Përmendorja e Atatürkut në qendër të Samsunit

Ky qytet bëhet edhe më i njohur dhe në tërë Turqinë jehon kumbueshëm, sepse në rrethinën e tij fillojnë luftërat e organizuara e të sukseshme të ekspeditave të Mustafa Kemal - Atatürkut. Më saktësisht: luftën e ka filluar në mes të Samsunit dhe të Bafres, në vendin e quajtur Balixhe, i cili tash e mban emrin 19 Mays (në sajë të përkujtimit të datës së fillimit të luftës; tash është komunë).

Prandaj, më vonë, shqiptarët ardhacak, siç ishte edhe ai vet (M. Kemal), e vazhdojnë traditën, duke luftuar kundër elementit jo turk dhe që nga ajo kohë prestigji ka mbetur i ruajtur për shqiptarët, arnautët. Në këtë pikëpamje, kush e vëren pozitën sociale dhe politike të shqiptarëve, mund të vejë në pah se arnautët - siç quhen në gjuhën turke, nuk janë aspak qytetarë inferiorë. Përkundrazi, në jetën e përditshme, në sjellje, në stilin e jetës, dominojnë dhe janë qytetarë të respektuar.

Shqiptarët gjatë tërë historisë i shërbyen me besnikëri të tjerëve, pra, jo vetëm Perandorisë Osmane (më vonë Mustafë Kemal Atatürk bëhet themelues i Turqisë moderne), por edhe në Perandorinë Romake dhe Bizantine, në të gjitha perandoritë, të cilave iu dhanë perandorë, kryevezirë e sadriazema. Pa u thelluar në këtë çështje, shqiptarët çdokund që gjenden në këtë shtet, konsiderohen si njerëz të vendosur, të mençur, trima, të besës e fjalës dhe, para së gjithash, për mënyrën e avancuar të jetesës. Zatën, një mënyrë e tillë kushtëzohet edhe me krijimin e paradispozitës për të siguruar ekzistencë dhe mirëqenie të dukshme.

Në pikëpamje ekonomike, po ashtu, nuk kanë pozitë inferiore. Në pjesën dërrmuese të vendbanimeve të banuara me shqiptarë në rrethin e Samsunit, ata bëjnë pjesë në ambientet, pothuaj, më të zgjed-

hura. Kjo gjendje nuk është privilegje e qeverive dhe pushtetmbajtësve të kohëve të caktuara, por më tepër është rezultatë e syçeltësisë së vet shqiptarëve, të cilët kishin prirje të ikin nga vendbanimet e pavolitshme dhe të grumbullohen, të krijojnë enklava nëpër mjediset ku mund të jetohej më mirë. Krijimi i enklavave nuk ka të bëjë vetëm elementin ekonomik, por edhe me ndjenjën spontane që të ruhet gjuha dhe tradita nga kanë ardhur.


Nëpërmjet bisedave të shumta me vendësit mund të dëgjohet jo një herë e dhëna se mik pas miku, në bazë të njohurive, ose së pakut vetëm që janë shqiptarë, janë përcaktuar të jetojnë në ambiente mundësisht sa më të përafërta.

Kësisoj, Samsuni në gjiun e vet e mbanë një numër të dukshëm të pjesëtarëve të kombësisë shqiptare, të cilët përveç nëpër qytete, në masën më të madhe janë të vendosur nëpër vendbanime të tjera, në veçanti në komunën e Bafrës, e cila, vërtetë, edhe sot e kësaj dite gumëzhin shqip, mbanë lidhje të pandërprera me atdheun e të parëve, apo të mëparshëm (memleqetin siç e quajnë vetë vendësit). Megjithatë, kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron, sipas ligjshmërive të natyrës, edhe në ta depërton dalëngadalë diç e re, element ky që dikur me intensitet më të madh zbrapsej, ndërsa koha e bën të vetën; gjeneratat dallëzohen në bashkëkohësi dhe kështu, në këtë oazë, pas një kohe relativisht të shkurtër veçse do të mund të flitet për origjinën, për të parët, për traditat dhe disa kryeparë, të cilët pikërisht në këtë rrethinë krijuan emër të pashlyshëm.

Samsuni me rrethinë, ndonëse me zvetnime të theksuara, nëpër disa vendbanime të tij, pra, jo vetëm në komunën e Bafrës, e ruan gjallë shqipen,

frymon shqip. Tekekojy, Merzifuni, Allaçami, Sinopi (pika më veriore që puçet në Detin e Zi, ku në qytet mund të hyhet vetëm me një udhë të vetme, ngase është i rrethuar nga të tri anët me ujë), në gjiun e tyre kanë numër më të pakët të shqiptarëve, ku varësisht nga masivi i pjesëtarëve ruhet, apo nuk ruhet tradita dhe gjuha shqipe. Në ato mjedise, lagje, ku më tepër janë koncentruar shqiptarët, edhe gjuha shqipe është më e kumbueshme, sikurse ajo që ndodhë në të kundërtën, në rastet e tjera, ku numri më i pakët i shqiptarëve nuk janë në gjendje t'i bëjnë rezistencë ruajtjes së gjuhës dhe zakoneve të mëparshme.

Dosido, këtu mund të gjesh elementin e gjallë të gjuhës shqipe, e cila dita më ditë është duke u fundosur, zhdukur. Gjëra plotësisht të ngjashme e të theksuara gjen edhe në mjedise tjera, por që, me qëllim të kuptimit, kudo që janë, është obligim të gjurmohen dhe të vehen në spikamë karakteristikat e tyre në ambient të ri, ose së pakut të shërbejnë si shembull edhe për të tjerët, edhe për ata që sot, të cilët gati si të shfrenuar ia kanë mësyer dyerve të Evropës dhe epilogun sikur nuk dëshirojnë ta parashikojnë. Turqia, me enklava të shumta me shqiptarë, ndër to edhe Samsuni, duhet të shërbejë si shembull tipik, për të mësuar se peshku i madh e gëlltitë të voglin, se kultura më e avancuar e absorbon kulturën më të limituar, më të kufizuar, se lakmia për ambientin e ri, me kalimin e kohës të përvetëson, të zhveshë nga çdo gjë që është e jotja, të vë në trekëndshin e vetëvarjes.



Dokument me të cilin shpërnguleshin shqiptarët (viti 1925).
Është i prindërve dhe i xhaxhallarëve të prof. dr. Hilmi Is-
mailit, i cili e kishte ruajtur sot e kësaj dite.

5. BAFRA - OAZË E VËRTETË E SHQIPTARËVE

*"Këngë e vargje thurin për Kosovën,
Mua fati ende s'po më ndrit;
S'di ku endet trupi im me kokën,
trupi im i mbetur invalid."*

Dritëro Agolli

Me të arritur në Samsun, në rrugën e kthyer veri-perëndim, shkohet në një gadishull të vogël, ku gjendet qyteti Bafra. Është ky një qytet i lashtë, që fillohet me një xhami, e quajtur Kizin-xhami (xhamia e vashës), pasi që atë e kishte ndërtuar një vajzë e re. Megjithatë, lashtësia e qytetit është shumë më e largët, para se të ndërtohet ky objekt fetar.

Me rrugë dhe rrugica, me lagje deri diku i ngjanë qyteteve bregdetare, edhe pse në brendi të siujdhesës shtrihet larg detit nga 10-15 kilometra. Aktualisht ka nga 100 mijë banorë dhe në përgjithësi, në tërë madhësinë e tij, ka pamje të bukur. Në veri dhe në perëndim shtrihen fusha të gjera, të përbëra nga toka shumë e rrafshët, sa për të mos e hetuar kah ecën ujët dhe kjo hapësirë përfundon me moçale të gjera, që nga deti ndahen me nga një rrip të ngushtë, sa për një udhë të gjerë ose për ndonjë vendbanim që sapo ka filluar të ndërtohet viteve të fundit. Në veri-lindje shtrihen kodrat më të larta.

Bafra është një prej kryeqendrave të rrethit (Vilajetit) të Samsunit. Territori i komunës është i rrethuar me Detin e Zi, madje me komunat 19 Mays, Samsunin, Kavak, Havza, Vezirkopru dhe Allaçam. Është e njohur me dy karakteristika, që veçohen nga shumë komuna (kaza) të Turqisë. Së pari, Bafra me rrethinën e begatshme dhe relativisht të gjerë është një prej hambarëve të Turqisë, prej nga shumë vise furnizohen me perime dhe drithëra të bardhë dhe me bimë industriale. Prej këtu fitohet duhan cilësor dhe për këtë shkak ekzistojnë disa fabrika të vogla për përpunimin e duhanit, të cilat qoftë këtu apo ngjati janë të drejtuara nga kjo fushë. Orizi mbillet në komplekse të gjera dhe jep rendiment dhe cilësi të lartë. Bostani dhe duhani janë produkte të njohura, prandaj, pikërisht në qendër të Bafres janë vënë simbolet e shalqinit dhe të duhanit, me çka veçohet begatia e Bafres.


Në këtë qytet, që nga muaji korrik e deri në muajin mars të vitit që vjen, bëhet qarkullim i pandërprerë, këmbim i mallit për tregun e gjerë të Turqisë. Shitja realizohet kryesisht me shumicë. Tregtarët grosistë vijnë në qytet dhe aty në tregun e përmbushur plot me perime të llojllojshme furnizohen, për t'i shpërndarë më tutje për blerësit, konsumatorët e panjohur.

Toka e Bafres kryesisht është argjilore, e mbetur nga pyjet si të pashkelura, të cilat nga popullata e këtushme janë çelur dhe më pastaj janë shndërruar në ara, në të cilat vilen dy bereqete. Pjesët moçalike që kanë mbetur edhe sot e kësaj dite dhe me gjuhën memece flasin për faktin se ky rajon ishte i përmbushur me male, shavarinë, moçale dhe mushkonja, të cilat edhe aktualisht dukshëm janë të pranishme.

Karakteristikë e dytë e Bafres me rrethinë është prania mjaft e theksuar e elementit shqiptar. Këtu gjendet një koncentrim me muhaxherët shqiptarë,

të cilët si rrallëkund tjetër, në ndonjë vilajet tjetër, janë të dispersuar në 25 (njëzet e pesë) vendbanime. Pra, në Bafra dhe rrethinën e saj janë të njohura 25 vendbanime ku banojnë shqiptarët.

Vendbanimet ku jetojnë shqiptarët janë: Bafra (qyteti dhe kryeqendra komunale), madje fshatrat: Karpus këjy (katundi i bostanit, i cili më parë quhej



Harta e Bafres: Vendbanimet e nënvizuara tregojnë praninë e shqiptarëve

Herc), Karenxhak (Karincak), Kushukëjy (Kosukóyu), Ballkallar (Baliklarkoyu), Osmanbëjlekëjy (Osmanbeylikoyu), Yçponarkëjy (Uçpinarkoyu), Sarikëjy (Sari Cevnekoy), Jeshiljazikëjy (Jesiljazi koyu), Donaxhekëjy (Doganca koyu), Lengerlekëjy (Lengerle koyu), Turbe köy (Tyrbe koyu), Domuzagikëjy (Domauçi koyu), Allëllarkëjy (Agillar koyu), Shenrënkëjy (Seharen koyu), Azaykëjy (Azay), Eldavutkëjy (Eladavut koyu), Gëkçesikëjy (Gökçesu koyu), Akteklu këjy (Aktekhuç koyu), Elifli këjy (Elifli koyu), Evrenusagi këjy (Everenuçagi koyu), Jakintashkëjy (Yaktinas koyu), Tashkëprikëjy (Taskopru koyu), Koshikëjy (Kosukoy), Ullagkëjy (Uluagacovkoyu).

Ndër këto vendbanime, fshatra të banuara kryesisht me shqiptarë, përkatësisht pastër vetëm me shqiptarë janë: Domuzagikoyu, Osmanbeylikoyu, Ballkëllarkoy e tjerë. Karpuskoyu, si dhe disa të tjerë janë të banuar kryesisht me shqiptarë, përkatësisht më numër të konsiderueshëm të tyre.

Bafra me rrethinë është vetëm një pjesë e vogël në krahasim me atarin e përgjithshëm turk, ku shqiptarët janë të vendosur dhe frymojnë. Nëpër Turqi ka plot vendbanime (lagje të tëra nëpër qytete të mëdha, fshatra), me popullsi homogjene me prejardhje shqiptare. Në bisedat e rëndomta përmenden fshatra të "arnautëve" të shtrira anekënd Turqisë. Vihet në spikamë qyteti Gjejlani (Adana), i banuar vetëm me shqiptarë, fshati Naxharli, Jenixhe dhe Osmanoll (të dyja në komunën e Merzifunit). Atje larg në Lindje është i njohur fshati (katundi) Kapoaz, i banuar plotësisht me shqiptarë, në Elasy (te kurdët), po ashtu jetojnë shqiptarët, në kufi me Sirinë gjendet Kylisi, në të cilin ka Mollakë, Prebrezë etj. Në Vilajetin Tokat, në një lartësi mbidetare prej 900 m. shtrihet fshati Niksor, ekskluzivisht me

banorë shqiptarë. Në Stamboll, Ankara, Izmir, Brusa e gjetiu ka sa e sa katunde dhe lagje të mëdha që njihen me emrin "arnaut mahallasi". Këto janë veçse të dhëna episodike, kundrejt pranisë reale të elementit shqiptar. Përkundër procesit të pandalshëm të asimilimit, të një numër i caktuar i individëve (sidomos te plakati) shqipja në çdo periudhë, edhe sot, ka mbetur e vetmja gjuhë, pa u "infektuar" aspak me asnjë gjuhë tjetër.

Për fshatin Niksor rrëfen Murat Sarë (Dragusha), polic, me banim në Ankara, por që kishte shërbyer pikërisht në këtë lokalitet. Bashkëbiseduesi e kishte të harruar gjuhën e të parëve, ndonëse me pietet flet për ta. Ai tregon se Niksor gjendet në nahijen Tokat. Katundi ka më se 400 shtëpi dhe është i banuar plotësisht me shqiptarë. Është lokalitet malor, me male të dendura me drunj të ahish-tave. Murati deklaron se askush, as nga pushteti nuk guxon të hyjë në të. Partitë i kanë në dorë. Deri vonë vetëm shqip kanë folur. Femrat kryesisht ishin të veshura me pshtjellak ("zavijaça"), ndërsa pleqtë edhe sot kanë veshje kombëtare shqiptare. Jetojnë mirë dhe janë kompakt, unik. Çka të ndodhë brenda, nuk mund të depërtojë jashtë, sepse nuk ka gjetur vend konfidenca. Pushtetarët kanë problem në këtë drejtim, sidomos kur është fjala për ndonjë vrasje, krim dhe për zbulimin e kryesit të veprës. Edhe pse katund malor, e kanë të zhvilluar trafikun, kështu që me mjetet e shumta transportuese, kryejnë shërbime të transportit për vise të gjera të Turqisë. Me të mbaruar të një rrëfimi autentik e real, bashkëbiseduesit i shtrohet pyetja: - Ju si patët mundësi të shërbeni, të kryeni detyrën pa pengesa në ato kushte kaq specifike? Ai pa hezitim përgjigjet: - Për arsye se isha (jam) shqiptar (arnaut).

Vendosja në trevën e Bafrës, me dendësi të

konsiderueshme me shqiptarë, e ka gjenezën dhe logjikën e vet. Pushteti i atëhershëm turk, si sundimtar shumëshekullor, e njihte shpirtin e shqiptarit. Atë më tepër e pranonte për sakrificat që mund t'i bëjë, se sa për shkakun e parapëlqimit dhe të përqaimit të fesë islame, sa për t'u ruajtur muslimanizmi. Shi për këtë, elementin që e kishte shtypur gjatë, që ia kishte mohuar kombësinë dhe gjuhën, me të cilin kishte rënë në konflikte të ashpra, deri në humbje të plotë po nga ky element, në vitin 1912, e pranon në gjiun e vet. Këtu mund të shtrohet pyetja: Si është e mundur që këtë kundërshtar, i cili e kërkonte lirinë, që kishte dhënë prova të shumta të kundërshtimeve, bile edhe me kryengritje të armatosura, të organizuara si ato të Skënderbeut, të Bushatlinjëve, të Ali Pashë Tepelenës dhe ato më të njohurat të Kosovës (1908-1912), përsëri të vënë nën sqetull dhe t'i gjejë strehim. Faktet janë të qarta për dhënien e përgjegjes së saktë. Turqia është shtet i përzier me kombe të ndryshme, si p.sh. turke, tatare, çerkeze, llaze, kurde, ermene, arnautë e tjerë. Në këtë konglomerat shqiptarët assesi nuk do të jenë në gjendje të krijojnë enklava ndikuese, me identitetin e vet, me aspirata të pavarësisë së gjuhës, të kulturës.

Të gjithë si një, të gjitha kombësitë do të shkriheshin nën flamurin e gjysmë hënës. Asimilimi i të gjitha kombësive është i patjetërsueshëm, pasi që feja e bën të vetën, siç e bën edhe sistemi politik dhe shtetëror. Së këndejmi, në këtë labirinth mund të gjenden arsye të shumta. Ndër to dallohen ato të cilat kanë të bëjnë me interesat e vet shtetit, për të përmirësuar, begatuar popullsinë me elemente vitale, që kanë shpirt luftarak, e po të udhëhiqen mirë, janë plotësisht besnikë ndaj të tjerëve, ndaj pushtetmbajtësve. Turqia me kohë e kishte peshuar

dhe përlogaritur mirë problemin. E kishte të qartë, sepse këtë ia kishte mësuar përvoja perandorake, se shqiptarët duhet të vehen në treva neuralgjike dhe në ato arrihen dy qëllime: të jenë mbrojtës dhe të likuidohen, njëkohësisht. Për të luajtur rolin e mbrojtësit, shqiptarëve iu gjendet vend për së gjeri e për së gjati nëpër shkretëtirat ose gjysmëshkretëtirat anadollake, nëpër vendet moçalike, deri në pikat më të largëta të lindjes dhe të perëndimit. Në ato pjesë kishte mjaft hapësira të lira, por problem ishte si të punohen. Klima e ashpër dhe niveli i ulët i zhvillimit ishin pengesë e madhe për prosperitet.

Në këtë gjendje të pakthim ngjajnë viktimat të shumta, të fëmijëve dhe të pleqëve, të të gjithëve që nuk janë në gjendje të mbrohen e nuk mund t'i bëjnë rrezistencë kushteve klimatike. Nga mushkonjat e moçaleve vdesin dhe e kanë vështirë të gjallojnë. Kështu, në mënyrë të tërthortë zhduket dalëngadalë një element kundërshtar, i cili jo vetëm në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881) diti të shfaqë aspiratën për pavarësi.

Një pjesë e shqiptarëve, të ardhur nëpër vise të gjera të Turqisë, megjithatë, nuk u zhduk. Ata ishin më të dalluarit dhe kudo që gjendeshin treguan shkathtësi dhe trimëri të pasqorë për t'i zmbrapsur kundërshtarët e Turqisë. Mustafa Kemal Atatürk i kishte në çetat dhe në radhët e tij të organizuara edhe shqiptarët, me të cilët arrinte rezultate të pamohuara, pothuajse në çdo front.

Shqiptarët kishin edhe shkathtësi tjera. Pjesa dërrmuese e tyre nuk ndeji duarkryq, por kërkoi kushte më të mira. Në ato mjedise ku ekzistonte mundësia, dhuntitë e natyrës ia përshtatën nevojave të veta. Kështu, në Bafra, që fillimisht ishin të vendosur nëpër male, nga të cilat mezi dukej qielli, gjeti tokën

me përbërje pedologjike të plleshme, të cilës ia mësynë ta çelin dhe pyllin ta shndërrojnë në tokë të punueshme. Në këto rrafshira bregdetare, lulëzon hapësira për lakmi. Moçali i gjerë mbetet më larg, i cili fshatarëve edhe tash u shërben si rezervat, ku rriten kuajt, buallicat. Tash për tash edhe moçali është i dobishëm.



Moçali, ku shihen tufë të gjedheve të trasha, të cilat dimër e verë vet ushqehen, shumohen, ndërsa pronarët iu vejnë damka, që dallohen nga të tjerat. Në këtë rezervat nuk ka barinj dhe rojtës të tjerë.

Është kjo një prej fakteve që dëshmon ku u vendosën shqiptarët. Atëbotë, vendbanimi, toka në këtë trevë fitohej pa kurrëfarë kompensimi. Nga pleqtë e gjallë që nga koha e ardhjes, aq sa nuk i mashtron kujtesa, mund të mësohet se këtu kanë ardhur nga dy arsye: sepse nuk dinin kah t'ia mbanin kur e shkelnin tokën e Turqisë dhe, për në Samsun dhe Bafra orientoheshin nga njohuria e njerëzve, të cilët këtu kishin qenë ushtarë, ose për shkak se kur kërk-onin strehim në Stamboll, në Izmir e gjetiu, në ato

mjedise strehimi dhe plangu duhej të paguhej, ndërsa Samsuni me rrethinë ishte pa pagesë. Njëkohësisht, më pastaj, këtu vijnë sipas informacioneve, miqësisë, të afërmeve që aty ishin të vendosur më parë.

Përkundër të gjitha odisejadave të mundimshme, shqiptarët në Bafra krijojnë oazë relativisht të gjerë dhe e kaluara për ta veçse është e inçizuar si në një celuloid filmik, të cilin e shikojnë më tepër mekanikisht, pa ndonjë thellim të posaçëm. Luftëtarët e denjë, njerëzit e fjalës, tash përmenden, përkujtohen me pietet, ndërsa për kohën e shkuarjes (emigrimit) do të rrëfenin me përjetime të thella, të njëmendëta, vetëm ata të cilët e patën barrën mbi shpinë dhe e ditën sa është ajo e rëndë.

Në Bafra dhe në rrethinë gumëzshin shqipja. Aktualisht nuk thuhet se kemi qenë këtu apo atje. Me mburrje pohojnë se janë shqiptarë, sado që në këtë trung ka depërtuar kombësia vendëse - turke.



Familja Ismajli (atëherë e quajtura Amitoviq) nga Koliqi që u shpërngul në Turqi në vitin 1925, por që pas gjashtë muajsh përsëri kthehet në vendlindje.

- 2 -		- 3 -	
ИМЕТО БОГОРОДНИЦА АЛЕКСАНДРА I ПО МИЛОСТИ БОЖЈЕ И ВОЛИ НАРОДНОЈ КРАЉА СРНА, ХРВАТА И СЛОВЕНАЦА АУ КОМ DE SA MAJESTE ALEXANDRE I PAR LA GRACE DE DIEU ET PAR LA VOLONTE DU PEUPLE ROI DES SERBES, CROATES ET SLOVENES Имајте се поштујући преданост архиепископу Крпачкине Срба, Хрвата и Словенаца La present passeport est obtenu au sujet du Royaume des Serbes, Croates et Slovenes		ЛИЧНИ ОПИС — SIGNALEMENT	
Име	Браим Амитоџић	Година	22
Име	Браим Амитоџић	Ан	
Занимљивост	Браим Амитоџић	Свој	Браим Амитоџић
Profession	Браим Амитоџић	Телес	Браим Амитоџић
Родом	Браим Амитоџић	Лич	Браим Амитоџић
Naif de	Браим Амитоџић	Коса	Браим Амитоџић
Село	Браим Амитоџић	Чело	Браим Амитоџић
Arrondissement	Браим Амитоџић	Уши	Браим Амитоџић
Округ	Браим Амитоџић	Нос	Браим Амитоџић
Département	Браим Амитоџић	Неа	Браим Амитоџић
Својом месном самоуправом	Браим Амитоџић	Бркови	Браим Амитоџић
Domicile légal	Браим Амитоџић	Moustaches	Браим Амитоџић
Округ	Браим Амитоџић	Брво	Браим Амитоџић
Département	Браим Амитоџић	Брво	Браим Амитоџић
		Особени знаци	Браим Амитоџић
		Signes particuliers	Браим Амитоџић
		Својеручни додаци — Signature du porteur	Браим Амитоџић

Тë dhënat e Brahim Amitoviqit
(pjesë e pasaportit të mëparshëm, viti 1925).

6. KUSH U SHPËRNGUL NË BAFRA?

"Kosova
e Manastirit, e Prizrenit, e Plavës dhe e Gucisë
Kosova e legjendave legjendare të Gjergj Elez Alisë
Kosova -
legjenda e mbetur në udhëkryq të historisë."

"Na e tregojnë drejtimin plumbat, që vërshellojnë në
errësirë.
Na e ndriçojnë rrugën flakët që gjithë tokën kanë përpirë
Pas shpinave tona përplasi tufani dyert e shkallmuara
të shtëpive
dhe rrugët zgjaten e zgjaten si veri.
Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi.
Lamtumirë, Çamëri!"

Bilall Xhaferri


Shqiptarët në Bafrë janë vendosur që nga viti 1912/13/14. Kryesisht janë nga Rrafshi i Kosovës, përkatësisht nga komuna e Prishtinës, Vushtrrisë, Podujevës, Lipjanit, Ferizajit, Gjilanit, Kamenicës. Pothuajse në tërësi janë pjesëtarë të ardhur nga Sanxhaku i Nishit në Kosovë. Në rajonin e Samsunit, përkatësisht të Bafrës ka edhe shqiptarë të ardhur nga Çamëria dhe viset tjera shqiptare të okupuara nga Greqia. Ata i quajnë muhaxher mubadil, që e kanë domethënien e këmbimit të grekëve banorë të

Turqisë me shqiptarët, si dhe turqit, që ishin popullatë e Greqisë. Në Bafrä, karvani i shpërnguljeve vazhdon vijimisht. Në dekadën e tretë të shekullit XX shënohet valë e re, sidomos në periudhën e viteve 1925-1930 dhe më pastaj deri në Luftën e Dytë Botërore. Edhe nga shpërnguljet e fundit, të viteve të pesëdhjeta, mund të gjesh numër të caktuar të shpërngulurve. Më fjalë të tjera, gati tërë shekulli XX është periudhë e përndjekjeve dhe e pedatjeve.

Është për t'u shënuar se në të gjitha vendbanimet e Bafrës janë krijuar lidhje të ngushta, miqësore, ose të ndonjë forme tjetër në mes të shqiptarëve. Kompaktësia fillin e ka në radhë të parë nga farefisnia, nga krushqia, nga ndonjë interes i biznesit, e mbi të gjitha veçse kanë mbështetje të njëjtë, janë shqiptarë. Aktualisht ekziston edhe përcaktimi ideologjik sipas partive. Secili pjesëtar i partive e mbështet programin e vet, prandaj, shpeshherë në ndeja, nëpër kafene, dëgjohej zhurmë për programet, për përparësitë që i kanë partitë e tyre.

Në muajin gusht, kur përcëllonte vapa, por edhe biznesi i intensifikuar, i shitblerjes së produkteve sezonale bujqësore, si dhe i atyre industriale, sidomos mobiljeve, të pajave, sepse së shpejti fillonte muaji i martesave, i dasmave, në bisedë, si epiqendër ishte humbja e pushtetit të Nexhmedin Erbakanit, i cili sipas disave, pushtetin, përkatësisht postin e kryeministrit e humbi për shkak të elementeve të fundamentalizmit, që gjithnjë e më dukshëm vëreheshin në programin e tij. Ithtarët e tij ngulnin këmbë se vetëm ai do të mëkëmbte Turqinë. Reformat e tij i shpjegonin si të avancuara, për formimin e shtetit në pikëpamje të doktrinės fetare. Kundërshtarët mendonin ndryshe dhe meritë të veçantë i jepnin të ndjerit Turgut Ozal, të cilin, për

fat të keq, vetëm vdekja e pengoi, ngase personaliteti i tij, hapat e tij reformues Turqinë e vënë në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit. Ç'është karakteristike, një numër, edhe të tillë që kishin shkuar në haxhillëk dhe ishin moshuar nuk i jepnin të drejtë Erbakanit.




Xhamia e mbetur nën ujë, në liqenin artificial (ndihmës) në Arabalik Tesisleri, i ndërtuar në kohën e pushtetit të T.Ozalit. Në liqeni kryesor në afërsi është i ndërtuar hidrocentrali me kapacitet 700 MGW.

Në veçanti debatet, herë-herë të nxehta, posiditët e verës përkufizoheshin me ndryshimin, transformimin e shkollimit, në mënyrë që arsimit fillestar të jetë në kohëzgjatje tetëvjeçare. Mbretëronte frika se me këtë do të mbylleshin shkollat pesëvjeçare nëpër vendbanime (mejtepet fetare). Në Turqi ka shkolla laike dhe fetare, andaj, edhe kahet e bisedave janë të mbështjellura me botëkuptimet e popullsisë dhe me nivelin e emancipimit që e kanë.

Për të gjitha këto, për punët tjera, për biznesin që e planifikonin ta realizojnë në Rusi, ku me kompanjat që kishin, të markave holandeze, me kapacitete të mëdha, t'i korrnin të lashtat nëpër fushat e gjera

atje, biseda kryesisht artikulohej shqip. Kjo nuk bëhej për hir të mysafirëve që ishin të pranishëm nga Kosova (edhe autori i këtij shkrimi), por edhe nga tradita, shprehia, gjuha e paharruar e nënës, e të parëve, e cila ende jehonte kumbueshëm. Nganjëherë, spontanisht kalohej në gjuhën turke, por, pa e zgatur shumë, mbizotëronte shqipja. Në këtë kompleks, për situatën politike të Turqisë, bisedat marginalizoheshin vetëm në episode të caktuara, ndërkaq, te individët dhe grupet e njerëzve vlonte këmbimi i informacioneve për "memleqetin" (atdheun e dikurshëm), ku gati secila familje e kishte ndonjë lidhje farefisnore, ose të miqësisë.



Autori me bashkëshorten Havën në një restaurant të specialiteteve të peshkut në Arabalik Tesisleri (te liqeni artificial, gusht 1997).

Natyrisht, te njerëzit e të gjitha moshave, te ata që kishin hyrë në dekadën e tetë të jetës, por edhe te ata më të rinjtë, ekzistonte përcaktimi i prerë për dashurinë dhe sakrificën që mund të bëjnë për Turqinë, si atdhe të vetin dhe të përhershëm. Çdo gjë që është kundër kësaj etike, nuk i kënaqte të pranishmit, sikur shprehnin xhelozin e pasqyruar për atdheun e tyre - Turqinë. Nuk është as e çuditshme, as simptomatike kur nga goja e tyre me pietet të plotë del ngazëllimi për pasurinë dhe, në kuptim të gjerë edhe për fushat, rrafshlartat, rrugët, objektet industriale, termocentralet, lumenjtë e Turqisë. Për çdo gjë tjetër flitej me ngazëllim. Në mënyrë të padukshme vërehej një brengë e padefinuar, nga njëherë e shfaqur sheshazi, për djemtë që shkojnë ushtarë, të cilët mund t'i gëlltitë fronti i mallkuar me kurdët.

Lufta me kurdët është pikë dhe çështje mjaft neuralgjike. Sipas konceptit të rehatisë dhe të stabilitetit të shtetit, pa dyshim, pjesëtarët kurd janë armiq, të urrejtur nga masa e gjerë. Mirëpo, po të bisedohet në mënyrë të shtruar, gjenden gjëra analogjike, të ngjashme me shqiptarët. Një popull që e do pavarësinë dhe sovranitetin e vet, nuk duhet të jetë i urreyer nga të tjerët. Në këtë temë të ndieshme nuk thellohen bashkëkombësit, përkatësisht bashkëbiseduesit, ndonëse më tepër i kaplon droja për bijtë e tyre. Për autorin e këtij shkrimi ishte simptomatike një bisedë spontane në një shitore të Stambollit. Shitësi, një djalosh i ri, pasi që e kupton përkatësinë kombëtare, thotë: shqiptarët dhe kurdët (ai ishte kurd) e kanë të njëjtin fat. Duke menduar gati njësoj, megjithatë, atij djaloshi simpatik i kthehet përgjegjja: ka ngjashmëri, por edhe dallime. Shqiptarët e kanë një shtet... Ç'është e vërteta, në

Bafra, në Stamboll dhe më gjerë në Turqi e dinin çdo gjë që kishte ndodhë dhe po ndodhë në Shqipëri.

Këto ditë për Shqipërinë dihej pothuaj çdo gjë. Mediat, përkatësisht masmediat dhe shtypi e kishin bërë të vetën. Shqiptarët e rëndomtë, si dhe intelektualët me prejardhje shqiptare shprehnin keqardhje për destabilizimin dhe ngjarjet tragjike të këtij shteti. Ndonëse të përcaktuar pa kurrëfarë dileme për Turqinë, dosido Shqipëria sikur i ngacmonte në çdo mënyrë. Për Kosovën, edhe pse me të i lidhë vatra e dikurshme dhe lidhjet e tashme, pothuaj dinin më pak se për Shqipërinë. Më tepër i mbante lidhshmëria familjare, ose ndonjë nostalgji e zbehur. Përveç situatës tragjike të pranverës së vitit 1997 që u krijua në Shqipëri, për këtë shtet dinin diç më shumë edhe më parë, sidomos për folklorin, koloritin e begatë të tij, spektrin e gjerë të këngëve e valleve, të cilat për çdo vit shfaqeshin në Samsun, por edhe në Bafra, të organizuara në festivalet ndërkom-bëtare. Nëpërmjet këtyre shfaqjeve ishte zhvilluar një lloj propagandimi dhe, së këndejmi, krijohej një pasqyrë më e përafërt për këtë shtet. Të thoshte mendja se nuk i kanë të qartë sa duhet lëvizjet në Kosovë, se nuk e dijnë konceptin dhe mundësinë e pavarësisë për trevën e tyre të dikurshme.

Në mënyrë habitore tingllon refreni i prezantimit se: mysafirët janë nga Jugosllavia. Sindromi i ngulitur që nga ikja e tyre, iu ka mbetur gjithnjë në kokë, pa pasur pretendime që të çvlerësohet nocioni i Kosovës dhe atributet e saj. Nëse hulumtuesi ose çdokush tjetër këtë rastësi e mat me kutin e vet, pa dyshim, do t'i vete mendja se në meridiane më të gjera, njohuritë për trevën e Kosovës janë tejet të mangëta. Është kjo një shpërprurje e dukshme në mes trumbetimeve të koluareve politikaneske në Kosovë lid-

hur me internacionlizimin e çështjes së Kosovës dhe realitetit nëpër meridianet tjera, mjediset e huaja.

Dimensioni i dyshimit lidhet me deklaratat shumë pompoze të liderëve dhe të politikanëve tanë, të cilët pa rezervë mburren për internacionalizimin e çështjes së Kosovës. Vërtetë, sa më shumë të bredhësh nëpër vise të botës, gjithnjë e më tepër formësohet bindja se problemi i Kosovës nuk është i internacionalizuar sa duhet dhe për këtë nevojitet punë më e organizuar dhe e gjithanshme, për të realizuar këtë qëllim. Me përjashtim të qeverive dhe të diplomacive të vendeve të ndryshme, popullata vështirë e di ku gjendet Kosova, ndërsa për problemet dhe aspiratat e saj pothuajse nuk di fare. Edhe pse rasti konkret është i marginalizuar, dhe ka një domethënie të caktuar për këtë çështje.

Kjo do të thotë se, megjithatë, mund të shfaq diç për këtë çështje edhe në vendet ku janë të vendosur me miliona shqiptarë, nga të cilët mund të kuptohet më lehtë problemi i bashkëkombasve të dikurshëm, por që nuk iu prezantohet në mënyrë përkatëse realiteti i kësaj treve dhe i popullatës së saj. Duke hyrë në thellësinë e gjenezës së shqiptarëve atje dhe duke iu ofruar të dhëna të shkruara e të argumentuara për vilajetet e tyre të dikurshme, thellohet bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i llojit të vet. Këta njerëz janë të gatshëm të ballafaqohen me realitetin, ndonëse burimet e informacioneve nuk janë të bollshme që të ndikojnë për shumë gjëra në vetëdijen e tyre.

Bisedat zhvilloheshin kudo, në kafene, nëpër shitore, në ndeja të rëndomta. Në qytetin Bafra kishte një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve, të cilët kishin zënë vend nëpër lokacione të volitshme. Në pallatet katër-pesë katëshe, me lokalet për destinime të ndryshme dhe sallonet e mëdha, shitore e punëtori, në të gjitha këndet, që nga qendra deri

në periferi, ndeshesh më shqiptarë, shumica e të cilëve kishin krijuar emër për punën e tyre besnike dhe të ndershme, për qifliqet që i kishin edhe për rreth qytetit, nëpër fshatra.

Pikëtakime të caktuara për shqiptarët ishin kafenetë. Faktikisht, ato ishin të zgjedhura, aty ku më së miri shërbehen dhe bisedat janë të kanalizuara



Shqiptarët rëndom rrijnë bashkë (në mesin e tyre edhe autori) nëpër kafene-çajtoje e gjetiu (foto, gusht 1997).

para se të hyhet në to. Vizitorët e rastit dhe banorët e atyshëm, rëndom shqiptarët, sidomos ata të moshuarit, i gjen në ndeja të përbashkëta, ku nuk mbetet ditë që të mos këmbëhet së paku ndonjë fjalë e shqipes. Në kafenenë afër ndërtesës së komunës (beledisë), ku pronari është me prejardhje shqiptare, porse e ka të harruar gjuhën e të parëve, e kanë pikëtakimin më të shpeshtë, që nuk do të thotë se nuk pushojnë dhe llafozen edhe në lokalet tjera dhe në çajtoje. Dita e hënë dhe e enjte janë ditë takimi, për

shkak se organizohet tregu dhe në qytet arrijnë edhe nga fshatrat e rrethinës. E premtja është ditë kur falet namazi i xhumasë. D.m.th. këto tri ditë sikur janë të destinuara për takimet e bashkëkombasve, të miqëve për t'i këmbyer mendimet dhe informacionet në mes veti.

Bisedën e tyre e ndërpret ezani i hoxhës, në afërsi të drejtpërdrejtë, si dhe anekënd qytetit, ku vetëm në qytetin e Bafrës numri i faltoreve është afërsisht 40. Por, ndërprerja e tillë është vetëm e përkohshme dhe fare nuk e pengon vazhdimësinë, qoftë të bisedave të rëndomta e të nevojshme, qoftë të biznesit të përditshëm. Bashkëbiseduesit më të shpeshtë, të cilët kryesisht janë haxhinjë, në përgjithësi shërbehen me kujtimet dhe bisedat, anekdotat dhe frazeologjizmat e "memleqetit", ato që iu kishin ngelur në kujtesë nga gjyshërit dhe prindërit e tyre.

Në të vërtetë, në Bafra dhe në rrethinë nuk ishte vështirë të ruhet tradita dhe gjuha shqipe, ngase në këtë oazë lidhjet fafeshnore dhe miqësore përbëjnë një gërshetim të dendur, si rrjetë merimange. Në komunat tjera të Samsunit nuk është kështu. Numri më i pakët i shqiptarëve, dispersioni pa koncentrim të veçantë, e kishte rrezikuar më herët gjuhën dhe ruajtjen e traditës. Në ato mjedise martesat e përziera kishin filluar më herët, ndërsa në komunën e Bafrës fillimi i këtij fenomeni tash është i shënuar, por me nismë shumë më të vonshme.

Në Bafra u shpërngulën fise të ndryshme të shqiptarëve. Në këtë qytet jetojnë dhe veprojnë: Sfarçalitë (të fisit Sop), të cilët në Kosovë kishin ardhur nga njëra Sfarçë (nuk dihet cila: e vogla, apo e madhja) dhe atëherë ishin vendosur në fshatin Nedakoc të komunës së Vushtrrisë, madje Bacalitë

(fisi Krasniq), të cilët në vitin 1878 ishin përzënë me dhunë nga Nishi dhe ishin vendosur në fshatin Pomazatin të Fushë Kosovës. Kjo familje konsiderohet ndër të parat të familjeve shqiptare që kanë zënë vend në Bafra. Aty jetojnë edhe familje të Prebrezëve (fisi Gash), të Bellopojëve (fisi Kelmend), të Pllanalive (fisi Thaq dhe Sop), të Llumnicëve (fisi Gash), të Dragushëve (fisi Gash dhe Thaq), të Llozanëve (fisi Kelmend) e tjerë.

Në fshatin Karpuzkëj janë vendosur Sfarçat, Gojnovcët (fisi Kelmend), Marevcët (nga Marevci ku më parë ishin vendosur shumë familje muhaxhere), Shurecët (fisi Krasniq), Zubicët, Pllanat, Prebrezët, Gimicët, Orllanët, Sllakuçanët, Shamallukët, Pasjaçët, Dragushët, Balltiqët, Rukovcit, Burincët, Zhinipotokët, Turgutët, Kordincët, Berilët, Cërno-gorët, Boshnjakët dhe një familje turke e Prishtinës, që tash mbiemrin e ka Jillmaz.

Në Akkunej jetojnë Mollakët, Raçët (fisi Krasniq), Pllanalitë, Makovcit, Zhushët (fisi Krasniq), Konjushët (fisi Krasniq) e tjerë. Ndërsa në Eldaut janë të vendosur Rashicët (fisi Shalë), Podvoricët (fisi Krasniq), Melakët. Bedeshi ka Llumnicë, Mramorë, Zhushë, Sllamellukë, kurse në Azay jetojnë Podvoricët.

Në fshatin Kanaxhak ka Burincë, Vardarë, Topanicë, Majkovcë, Boshnjakë, Podvoricë, Ver-topë, Ivajë (fisi Kelmend) e tjerë. Në Koshikëj elementi shqiptar përbëhet nga Ramiqët, Marevcët, Kryelevët, Butovcitë, Lecët, Podvoricët, Krivaçët, Berjanët, Burincët, Rashicët. Hertova ka Bacali, Berjanë etj., ndërsa në Elypli jetojnë Gubetinët, Krivaçët dhe Zhushët. Në Korolluk ka Spahi e tjerë.

Në fshatin Kajdollap jetojnë Pllanalitë, Shishanët, Trudët, Bacalitë, Makovcit, Tërpezët, Gërgurët, Sogojevët, Berilët, Tërhollët. Në Tur-

bekëj ka Prebrezë, Hergajë dhe Mramorë, ndërsa në Rengelkëj jetojnë Ratkocerët.

Në Evrenushak jetojnë Makovcit. Fshati Osmanbejlilik është i banuar me shqiptarë. Aty jetojnë Bacalitë, Malokët, Çomurët, Majkovcët, Lahinovcët, Paçaradët, Pllanalitë, Pasjaçët, Goranët, Tihovcit dhe Ratkocerët.

Në fshatin Tashkypri jetojnë Sfarçat, Podvoricët, Makovcit dhe Bajçinovcit. Në Yçpunar ka Pasjaçë.

Në Myzmeleki jetojnë këto grupe të familjeve: Pllana, Sfarça, Raça, Grabanica (fisi Kelmend), Byçmetët (fisi Thaq), Bubicët, Simnicët. Fshati Akteke ka Mukulan, Toçanë (fisi Kelmend), Pllanë dhe Zhushë. Në Gërçesu kanë gjetur vendbanim Llozanët, Bublikët, Pllanalitë e tjerë.


Në fshatin Domazay jetojnë Breznicët, Saki-collët, Bullatovcit, Podvoricët, Toçanët. Në Rengeli janë të njohur Gimollët, Podvoricët, Sakicollët.

Nëpër fshatra tjera jetojnë Toçanët, Bërba-tovcit, Bellopojët, Tihovcit, Konjushët, Gimollët, Llozanët e tjerë.

Përveç në Bafra, shqiptarët janë të vendosur edhe në qytetin e Merzifunit, të Sinopit, të Gerzës, të Allaçamit, në Tekekëj, në Samsun, si dhe nëpër disa fshatra që e përbëjnë rrethinën e këtyre qyteteve. Në Samsun jetojnë Zhinipotokët, Ramiqët, Pllanalitë, Zhushët, Zhugollët, Buçincët (fisi Thaq), Gjyshincët (fisi Gash), Shulemajtë, Konjushët e tjerë.

Në Merzifun ka Bacali, Konjushë e tjerë. Në Allaçam është i njohur fshati Tashkelikëj, i banuar me shqiptarë. Edhe në qytet ka shqiptarë, sikurse në Gerze dhe Sinop, porse me numër më të vogël. Në qytetin e Tekekëjyt jetojnë vetëm dhjetë familje shqiptare: Sfarçali, Bellopojë dhe Bërbatovcë (fisi Krasniq).

Në Bafra ende mund të gjenden pleq, ndonëse shumë rrallë, të cilët pak a shumë e mbajnë mend rrugëtimin për në Turqi, qysh në vitin 1913/14 dhe 1919/20. Ata më së miri, në mënyrë autentike rrëfejnë për realitetin e kohës dhe janë në gjendje të lidhin skajoren e atëhershme dhe të sotmen.



Të dhëna për anëtarë të familjes (nga pasaporti i mëparmë).

7. KUJTIMET E TË GJALLËVE PËR SHPËRNGULJET NË TURQI, PËRKATËSISHT PËR NË BAFRA

"O për shqyptar-t-o, haj, medet,
Gjethmon desin-o për gazep,
P'i venit tyne Krali i njek.
Po na i vret, o po na i pret.
O se p'i Nishit, o teri n'Kikë,
Po na i pret dushmani me thikë.
O p'i Surdulli ter'n'Karadak
I vret dushmani, o pa i pas'hak
O p'i Leskovcit, o teri n'Vrajë,
O po na therrin, bre, po na vrajnë!"
Popullore

Meqë koha e bën të veten dhe gjenerata më e hershme ka zënë të harrohet, sadopak mund të gjendet ndonjë i moshuar që di të flasë me besnikëri për periudhën kur ndodhën shpërnguljet për në Turqi. Nga tërësia ku mund të vilen kujtimet, ndahen në dy breza: ata që u shpërngulën nga Kosova dhe ende janë gjallë dhe në ata që u lindën në atdheun e dytë, përkatësisht në Vilajetin e Samsunit, por i kanë të freskëta rrëfimet e prindërve dhe të të afërmeve të tyre, të cilët tash janë në botën tjetër.

Janë raste entuziaste, por edhe prekse, takimet me njerëz, të cilët në fëmijërinë e hershme botën e morën në sy dhe ata më së miri janë në gjendje të ilustronë realitetin, motivet dhe shtytjet e emigrimit të asaj kohe. Fatkeqësisht, nga ky grup i të moshuarëve kanë ngelur pak veta, që kanë pak mundësi të rreken me shpjegimin e argumenteve. Të gjallët, ende vital dhe me kujtesë të mprehtë janë **haxhi Ibrahim Baca** dhe **haxhi Islam Dragusha**. I pari jeton në Bafra, ndërsa vëllezërit i ka nëpër fshatra dhe në qytetin e Merzifunit. I dyti është banor i Karpuskëjy.


Ibrahim Baca, që tash, sikurse të tjerët ka mbiemër tjetër (Ungjy), e mbanë ngapak ndërmend shpërnguljen për në Turqi. Është i lindur në Pomazatin (të Fushë Kosovës) në vitin 1909 dhe në këtë fshat kishin ardhur nga Nishi, kur shqiptarët dëbohen me dhunë në vitin 1878. Pomazatini atëherë kishte 15 shtëpi. Babai i Ibrahimit, Nimani ishte myftar (kryetar) i katundit Pomazatin. Në Prishtinë kishte marrëdhënie të mira me Osman agën dhe me Zenel agën.

Menjëherë pas okupimit të Kosovës nga sllavët në vitin 1912, jepet urdhëri për dorëzimin e armëve. Viti 1913 ishte i përmbushur me krajata dhe skena të shtypjes. Në muajin mars të vitit 1914, babain, kryeplakun e fshatit e ftojnë të paraqitet në karakollin e xhandarmërisë. Ato ditë ishte vrarë zaptia. Në stacionin e xhandarmërisë ftesa përsëritet për dorëzimin e armëve. Në këtë mjegullinë gjithnjë e më tepër depërtonte resignacioni. Ai mendonte: Sot e kërkon armën, kurse nesër çka s'kërkon. Ta kërkon edhe gruan. Ngulfatja psikologjike kushtëzon epilogun për të marrë vendim për shpërngulje në Turqi.

Familjet Baca të Pomazatinit ishin të njohura për tregti me qylima. Blenin në Pejë dhe i shitnin në

Prishtinë e gjetiu. Në këtë mënyrë, kishin krijuar kapital të konsiderueshëm dhe fitimin e shndërronin në lira (dukatë) turke. Në momentin kritik vendosin që të marrin udhën e pakthim. Këtë rrugë e zgjedhin të gjithë së bashku, të gjitha familjet e Pomazatinit.

Xha Ibrahim mbanë diç në kujtesë, për çastet



Haxhi Ibrahim Baca (Ungjy)

e shpërnguljes, për orët tronditëse. Babai i tij e kishte një serb të njohur. Kur ia shfaqti qëllimin, ai me një entuziazëm të fshehur i tha: eja te unë se do të ndihmojë. Edhe kur mëson se tërë katundi e ka të njëjtin qëllim, i njohuri i shtirë "mik" edhe me më ngulm i premtoi se çdo gjë do të jetë në rregull, sa i përket mundësisë së shpërnguljes. Shumë shpejt shitën bagëtinë dhe sendet tjera të shtëpisë, ndërsa tërë pasurinë e patundshme (shtëpinë, ahurijet, tokën), e lanë të shkretë, të pashitur, për t'i marrë më pastaj serbët, pa asnjë metelik.

Bamirësi i myftarit të Pomazatinit, në të njëjtën kohë i realizon tri objektiva: e shpopullzon fshatin Pomazatin nga shqiptarët; iu jep shembull të tjerëve se ç'duhet bërë; dhe pasurinë shumë të vlershme ua falë ardhacakëve jo shqiptarë, kolonëve serbomalazez, për të përmirësuar strukturën e popullsisë në Rrafshin e Kosovës.

Për rrugën e marrur mbanë diçka në kujtim. Kishin udhëtuar me tren për në Selanik. Para se të

niseshin kishin marrë premtimet e shumta për tokën e shenjtë atje, për të marrë çdo gjë gratis. Posa iu afrohen Selanikut, marrin informacionin se kush shkon në Stamboll ose në Izmir duhet të paguajë, të blejë pasurinë. D.m.th. që në hapin e parë dështojnë nga plani për të shkuar në Stamboll ose në Izmir. Shkuarja në Izmir kishte edhe një pengesë tjetër. Ajo pjesë mjaft e gjerë ishte e banuar me grekë, me rum - siç i quanin bashkëbiseduesit. Stambolli ishte i përmbushur me rrëmujë të vërtetë të fluktuimeve. Rrugë e vetme mbetet shkuarja në Samsun.

Gjatë udhëtimit gratë dukatin e lidhin rreth belit. Nëpër kufijë, në Selanik dhe në Stamboll, femrat nuk kontrolloheshin, prandaj, në saje të kësaj teknike, familja e Bacajve kishte para sa për të mbetur gjallë në ato ditë të vështira. Madje së shpejti rifillojnë me ushtrimin e tregtisë.

Në rrugën për në Samsun ndalen në qytetin Merzifun. Aty jetojnë disa vite. Babai i Ibrahimit krijon kapital dhe për të prosperuar më shumë, me të birin Ibrahimin shpërngulen në Bafra, ku familjet e tyre, aktualisht të zgjeruara edhe tash jetojnë. Në Merzifun Ibrahimit i ka mbetur vëllau dhe aty jeton me familjen e vet.

Haxhi Ibrahim, 88 vjeçar, për këto vite që i ka, është mjaft vital. Biseduam në shitoren e tij, në qendër të Bafrës. Në godinën e ngritur disa katëshe, i mbanë lokalet, ku ende e përcjell me saktësi tregtinë e të bijëve. Rrëfen se një herë ka qenë në "memleqet", në Kosovë, në atdheun e të parëve (është nipi i Gërrexhalive të Studimes së Poshtme, Vushtrri). Ka shkuar edhe në Pomazatin, në vendlindjen e tij. Në ato çaste, thot, e përkujtova udhëtimin tonë, pasurinë që e lamë të djerrë. Aspak nuk e di çka ka ndodhur me atë pasuri - shton plaku.

Në një mbrëmje iu afrova pikërisht truallit, ku atëherë ishte e ngritur shtëpia. Nuk pata mundësi të hyjë në oborr. Nuk mund të shihej asgjë brenda. Për ndryshimet e bëra, në një anë iu kishte zvetnuar kujtesa dhe, në anën tjetër nuk iu dha mundësia të dijë diç për ndryshimet. Më thanë - pohon ai - se në atë oborr është një qen i rrezikshëm.

Ibrahim Baca të gjitha këto i rrëfen pa ndonjë përjetim, që mund të diktohet. Në shiritin filmik veçse i radhitë kujtimet, aq sa mund të ruhen nga mosha pesëvjeçare. Si plotësim i shpjegon fjalët e babait, të xhaxhallarëve dhe të të tjerëve, sikur të ishin ngjarje të huaja, pa senzibilizim dhe emocion. Familja e tij tash është e larmishme. Djali i madh, **Mehmeti** e di shqipen, ndërsa i dyti dhe të tjerët e mbajnë vetëm krenarinë se janë me prejardhje shqiptare, janë arnaut. Anëtarët edhe të familjes së gjerë i ka të shkolluar. Djali i madh, Mehmeti, e ka të kryer Fakultetin Juridik, i dyti, Gunen është inxhinier i elektroteknikës. Dy djemë të Mehmetit janë me profesion mjek, përkatësisht me grada të doktorit të shkencave (njëri i gjinekologjisë dhe tjetri i kirurgjisë vaskulare).

Kjo familje nuk ka shkëputje nga Merzifuni, sepse atje e ka tokën, të cilën të tjerëve ia jep përgjysmë për shfrytëzim. E ka edhe vëllaun atje. Është i vetëdijshëm se në Bafra edhe para tyre kishin ardhur shqiptarë, porse e ruajnë gjuhën. Te këto familje gjërat kanë filluar të ndryshojnë shpejt. Shkollimi në gjuhën turke dhe martesat e kanë bërë të veten.

Ramazan Baca, i nipi (djali i vëllait të Ibrahimit), është i interesuar të dijë çdo gjë për vendlindjen e të parëve të tyre. Është i moshës 73 vjeçare, i lindur në Turqi dhe asnjëherë nuk ka qenë në

Kosovë. Në përputhje të plotë me fjalët e të ungjit flet për të kaluarën e familjes së tyre, për rrugëtimin, të mirat dhe të këqijat, që i kanë përjetuar në Turqi. Pohon se i ka të shënuara të gjitha breznitë e familjes Baca, prej që ishin në krahinat e Toplicës, në Kosovë dhe në kohën e pedatjeve në Turqi. Me gjithë premtimin se do t'i prezantojë ato skicime të argumentuara, një sëmurje e ngutshme e pengoi të bëjë këtë. **Mehmeti**, i biri i Ibrahimit, i moshës 67 vjeçare, një mikpritës për respekt, po ashtu, e di fort mirë shqipen dhe të kaluarën e ka inçizuar në kokë dhe rrëfen pa ndërprerje. Kjo do të thotë se, megjithatë, këtë problematikë e trajton shpesh, e përimiton në kujtesën e vet.

Ndër të gjallët, i cili di ngapak të tregojë për shpërnguljen për në Turqi, është edhe **haxhi Islam Dragusha**. E ka shkelur vitin e tetëdhjetë të jetës. Kur u nisën për në Turqi, në vitin 1919, i kishte vetëm pesë vjet, mirëpo, disa gjëra i mbanë mend nga ajo



Haxhi Islam Dragusha

kohë. Ishte nga fshati Sllatinë (komuna e Prishtinës). Të tri familjet, sa ishin atëherë, ia mësynë rrugës së pakthim.

Kishin udhëtuar nëpër Selanik dhe me të hyrë në Stamboll i mbanjtën tre muaj në anije. Pas vendimeve përkatëse u jepet viza për të hyrë në Turqi. Meqë në Bafra i kishin dajët e babait, drejtohen për në atë trevë të largët. Prebrezët, përkatësisht dajët në fjalë, ishin

vendosur më herët, qysh në vitin 1913, prandaj, në saje të tyre, drejtohen në atë rrugë. Atëbotë Bafra me rrethinë ishte si një pyll i pashkelur. Ekzistonte mundësia të zgjedhnin tokë sa të donin, për shkak të popullsisë së rrallë. Në përgjithësi vendosen nëpër fshatra, ngase nuk zotëronin kurrëfarë zeje dhe i vetmi burim për sigurimin e ekzistencës ishte toka. Peripecitë ishin të shumta, si për arsye të ambientit shumë të vështirë për jetesë, ashtu edhe nga shkaku se vendësit nuk i pritën si duhet. Në atë rajon jetonin grekët (rumët - siç i quajnë) si dhe popullata vendëse turke. Banorët autoktonë turq kryesisht ishin të varfër dhe eksploatoheshin nga pasanikët, bejlerët dhe pashallarët. Rumët ishin më të pasurit dhe kishin bashkëpunim të ngushtë me bejlerët e atyshëm. Titullarët që në njëfarë dore mbanin pushtetin në dorë, ditën i nxitnin ardhacakët (muhaxherët) të vërsulen kundër "rumëve", ndërsa natën bashkëpunonin me ta (rumët).

Pas një kohe të caktuar, familjet Dragusha mëkëmben, e zgjerojnë sipërfaqen e tokës së punueshme dhe tash kanë çifligjet në fshatra (në Karpuskëjy e gjetkë) dhe në qytetin e Bafrës. Nga ato tri familjet e atëhershme tash janë bërë 45 familje.



MËRGIMET E PARA (1468)

*"Qysh në atë ditë që jeni larguar
njëmijë të zeza na kanë mbuluar
kthehuni... për të na ndihmuar"*

*Këngë e vjetër
(Gjergj Gashi, Kosova altar
i Arbërisë 1910-1941, III, Tiranë, 1996)*

8. UDHËTIMI ME QERRE TË DRUNJËTA E MË QE


*"Ani ka lonë shpi-e, ka lonë vatan-e,
Nonë mori,
Ani ka ardhur n'ket shkreti-e
Ani ka lonë motra, ka lonë vllazni-e,
Nonë mori,
Ani ka ardhur n'ket Anadoll-e
Ani ka lonë miq-e, ka lonë shoqni-e,
Nonë mori,
Ani ka ardhur, n'ket Turki-e."
Popullore*

Gjenerata e parë, e lindur në Turqi, pjesëtarët e së cilës janë të moshës më se shtatëdhjetë vjeçare, po ashtu, e ka të qartë shpërnguljen në trojet e reja. Nga prindërit e tyre, të cilët viteve të fundit kanë ndërruar jetë, mësonin për Kosovën, për viset nga kanë ardhur, për të gjitha ngjarjet e atjeshme, në ato që i kanë ndeshur rrugës dhe nëpër vendbanimet ku janë vendosur. Këta dijnë më së miri për familjet e Prebrezëve, të Bellopojëve, të Sfarçalive, e të tjerëve. Ndër ata që me saktësi më të plotë janë në gjendje t'i evokojnë kujtimet si dëshmi për atë kohë, janë të shumtë. Me këtë rast mund të përmendim **haxhi Jashar Prebrezën, haxhi Mahmut Prebrezën, haxhi Xhemail Prebrezën** e kështu me radhë. Gjenerata e tyre është e para, e lindur dhe e rritur në Turqi. Me

përkushtim të veçantë ruajnë në kujtesë çastet më të volitshme dhe ato më dramatike për jetën e tyre. Asnjëri nga këta kurrë nuk ka qenë në Kosovë. Mirëpo, dinë shumëçka për Kosovën, janë të interesuar për të dhe sikur rregullisht këmbëjnë informacione me këtë largësi gjeografike.

Treva e paraardhësve iu duket si diçka ekzotike, ku jetohet në kushte të paqarta sa duhet. Një dukuri e tillë është e njëjtë sikurse me ata që jetojnë këndeje dhe që nuk i kanë vizituar viset e largëta të Azisë së Vogël, ku jetojnë shqiptarët, të cilëve çdo gjë iu duket si e pakapshme, e pakuptueshme.

Haxhi Jashar Prebreza i ka mbushur të shtatëdhjetë e dytën. Është njeri i nderuar në rrethin e vet, i mençur dhe me të gjitha tiparet e mikëpritsit të një shqiptari që e përcjellë traditën. Me besnikëri të plotë i rrëfen ngjarjet dhe pedatjet e të parëve të vet. Familja Prebreza, që nga dëbimi i dhunshëm nga viset e Toplicës ishte vendosur në Kosovë, në vend-



Haxhi Jashar Prebreza

banimin Podje (afër Barilevës) të komunës së Prishtinës, në çifligun e Fuad beut. Fuad beu ishte shqiptar nga Kosova, kurse bashkëshorten e kishte nga Stambolli. Sipas thënieve të prindërve, haxhi Jashari thekson: qysh gjatë luftërave çlirimtare (1908-1912), beu i kishte thënë babait që të merrë vendim çka të veprojë. Natyrisht, Fuad beu e kishte të qartë se ushtria turke gjendej para

kapitullimit. Beut i shërbenin mirë, i jepnin 1/10, ose çdo formë tjetër që ishin të obliguar, ndërsa për shkak të lojalitetit kishin mundësi të mbanin bagëti për vete.


Menjëherë pas pushtimit të Kosovës shpërngulen për të Turqi.

Viti 1913 ishte vendimtar që të arrinë atje. Siç rrëfen xha Jashari, me të arritur në Stamboll tre muaj i mbajtën në anije. Pastaj kishin pyetur ku donë të shkojnë. Një ose dy meshkuj nga familja, më herët kishin qenë ushtarë në Samsun dhe aty kishin dëgjuar për një fushë sikur të ishte pyll i pashkelur. Ishte ajo rrethina e Bafrës, një hapësirë e rrafshët, por e mbuluar me drunjtë aq të lartë, sa që mezi shihej qielli. Këto informacione të pakëta bënë të mundur të marrin vendim e të shkojnë në Bafra. Kur shkojnë në atë mjedis, kishin hasur në shumë peripeci. E kishin problem të dinë se ku janë, ku gjenden. Nuk e njihnin gjuhën e vendësve, të cilët edhe ashtu në atë hapësirë ishin të disperseuar tejet rrallë. Mushkonjat e shumta, si të rrufeshme, i shqetësonin dhe i dëmtonin pa masë.

Me të arritur në ambientin e ri, autoritetet e pushtetit i vendosin në një shtëpi dhe më vonë në një tjetër. Pas një kohe i përzënë nëpër kodra. Ishte ky shkak sepse bejlerët nuk i donin ardhacakët, ndërsa edhe rumët (grekët) ishin bashkë me ta (me bejlerët). Bejlerët turq përdornin taktikën e përçarjes dhe të shfarosjes. Arnautët i shtinin të luftojnë kundër "kaurrëve", të pa feve, kurse ata vet i mbronin. Ishte kjo hipokrizi e rëndomtë që shfaqet në kushte dhe rrethana të tilla.

Kësisoj, luftërat më të mëdha, të famshme dhe vendimtare i bëjnë shqiptarët. Për trimërinë e tyre janë thurë rrëfenjëza të ndryshme dhe gati kanë kaluar në legjenda, sidomos për disa raste tepër të

dalluara. Në këtë mënyrë, krenaria e shqiptarit - siç thotë - është e përhapur në mbarë Turqinë.



Haxhi Mahmut Prebreza


Haxhi Mahmut Prebreza i ka mbushur 70 vjet. Edhe ai është në gjendje të rrëfejë detaje nga më të ndryshmet. Është i familjeve të Prebrezëve, që Turqinë e kanë shkelur në vitin 1913. Bashkëfolësin e mëparshëm e ka xhaxha. Ky është i prirë të rrëfejë për emra të shquar, pa marrë parasysh se janë edhe jashtë familjes së tij, por që atyre iu kushton rëndësi të madhe. I zë në

gojë emrat e Malokëve, të Grabanicëve, të Llumnicëve. Nëpërmjet tyre, me ta e ilustron qartë bujarinë, mençurinë, besën, trimërinë, me çka është krijuar imixhi i shqiptarëve në ato vise.


Familja e Prebrezëve, sikurse edhe disa të tjera, është e gjerë. Prandaj, krijohet mundësia të bisedohet me disa syresh. **Haxhi Xhemail Prebreza** është, poashtu, i moshuar (nja 73 vjeç). Edhe këtij i kujtohen fjalët e pleqëve, për jetën e çifçiut që e kishin bërë në fshatin Taraxhë të Vushtrrisë. Të dhënat që dëgjohen nga goja e tij janë identike me të tjerët, me çka kuptohet se rrëfimet e tyre, të secilit janë të sakta. Ata e njohin mirë realitetin e Kosovës, të ditëve të atëhershme, por edhe këto të tashmet. Plaku i tashëm i zëvendëson ata, të cilët ishin bartës të peripecive dhe të krahmatave. Deri tash, as ky, asnjëherë nuk kishte pasur rast të vizitoj Kosovën,

për çka shpreh dëshirë të flakët të jetë në gjirin familjar të nipave të vet (të familjeve të Merovcëve në Vushtrri) dhe të tjerët që i njeh dhe nuk i njeh.


Xha Jashari është në gjendje të detajizon të dhëna për çiftligun e Fuad Beut, për lokalitetin Podje, ku atëherë shtrihej dhe punonte pandërpërje mulliri me nëntë gurë. Saktësinë e këtyre të dhënave mund të verifikohen me të kthyer këtu. Edhe sot e kësaj dite ekzistojnë gjurmët e mullirit të Fuad Beut dhe, një farë mënyre është në interes të dihet më shumë për këtë objekt, ta quajmë industrial të asaj kohe, që përmban një potencial të dukshëm.



Gjendja e mullirit me nëntë gurë në Podje në vitin 1974.



*Mbeturinat e ndërtesës së bujtinës së mullirit të Fuad beut
(foto nëntor 1997).*



*Edhe tash kanë ngelur katër tuba ("butia")
nga të nëntat që ishin dikur (foto nëntor 1997).*

Haxhi Jashar Prebreza e saktëson ditën kur prindërit e tij kanë arritur në Samsun. Sipas tij - familjet Prebreza në Samsun kishin arritur ditën e Shëngjergjit (6 maj) të vitit 1913. Nga Samsuni shpërngulen në Bafra. Ai e di, po ashtu, marshutën e udhëtimit, sa kanë pritur në anije, njërin nga meshkujt e tyre që "e kishte bërë askerllëkun në Samsun". Bashkëbiseduesi i qartëson edhe disa detaje tjera. Ndërkaq, **haxhi Xhemaili** thekson se kur shkojnë në Bafra gjerë e gjatë e shohin rrafshirën e mbuluar me drunjë, me një dendësi që vështirë mund të kalohej nëpër te. Pastaj, duke e parë këtë jetë të vështirë, shpërngulen në Çarsham (përtej Tekekojyt). Aty rrijnë vetëm nja 20-30 ditë dhe përnjëherë i kaplojnë ethet, si pasojë e mushkonjave dhe e moçaleve të shumta. Disa nga anëtarët e familjes vdesin (nuk i kujtohet numri, as emrat) dhe me këtë krahjetë në gji përsëri kthehen në Bafra.

Dy-tri vjet mbesin çifçi (jarenxhi). Xha Xhemajli, që ka hyrë në dekadën e tetë të jetës tregon se sa kanë hequr keq prindërit dhe të afërmit tjerë. Gjuha i pengonte shumë, pra, mjete nuk kishin për të mbetur gjallë. E vetmja mundësi ishte të shesin dru dhe të blejnë ndonjë gomar, si mjet transportues të druve. Ky, madje haxhi Jashar Prebreza dhe të gjithë të tjerët këtë kohë e përkujtojnë me neveri. Tash, të gjithë ata që rrëfyn epizode nga jeta, kujtimet e mbetura nga prindërit dhe farefisi, më të moçmit dhe ato që i kanë përjetuar vet, kanë krijuar mirëqenie materiale të konsiderueshme. Kanë pasuri të patundshme në qytetin Bafra në fshatin Karpuzekëjy e gjetkë.

Me të gjithë bashkëbiseduesit biseda zhvillohet në gjuhën shqipe dhe, me rastin e çfarëdo thellimi, njeriu mendon se gjendet në Kosovë. Klima e komunikimit ndryshon vetëm kur përzihen gjeneratat ose

mjediset, kur bien ndesh mundësitë e kështu çrrënjohet kultivimi i gjuhës mëmë shqipe.


Në mjediset, ku elementi shqiptar ishte më i rrallë, edhe tradita dhe gjuha shqipe ishin zvetënuar dhe tjetërsuar më herët. Në qytetin Tekekojy, që është qendër komunale, jo më larg se 17 km nga Samsuni, në drejtim të perëndimit, jetojnë dhjetë familje me prejardhje shqiptare. Ato i përkasin familjeve të Sfarçave, të Bellopojëve dhe të Bërbatovcëve.

Familjet e Bellopojëve dhe të Sfarçalive kishin ardhur herët, në vitin 1913. Bellopojë, në Kosovë kishin jetuar në fshatin Milloshevë (komuna e Prishtinës). Në vitin e fundit të perëndimit të plotë të qeverimit të Perandorisë Osmane në këto anë, familja Bellopoja, në marrëveshje me autoritetet turke, vendos të shpërngulet në Turqi. Qysh atëherë, pra, ende pa u shpërbërë tërësisht Perandoria - siç mësohet nga disa që i përcjellin fjalët, nga pasardhësit e tyre - pushteti turk kishte filluar të bindë një numër të popullsisë shqiptare, që për çdo eventualitet, në rastë se shkatërrohet Perandoria, këta, shqiptarët të tërhiqen në tokat aziatike. Një fat të tillë e patën familjet e Bellopojëve të Milloshevës.

Rexhep Bellopoja, së bashku me të emën, vëlalin dhe të motrën, si dhe me xhaxhallarët, të gjitha familjet, sa ishin drejtohen në rrugën e gjatë e të pakthim. Sikurse edhe të tjerët, kalojnë nëpër Selanik. Deri në këtë qytet bregdetar bëjnë disa javë udhë, sepse udhëtimi ishte realizuar me qerre të drunjëta me qe. Nga Selaniku deri në Stamboll udhëtohet me anije. Organizimin dhe përcjelljen e udhëtimit e bëjnë osmanlijtë.

Sipas rrëfimit të **Ali Bylbylit** (Bellopojes), inxhinier i kimisë, një djalosh i moshës dyzetvjeçare, udhëheqës i prodhimit në Fabrikën e bakrit pelister në brigjet e Detit

të Zi (në atarin e Tekekojyt), në bazë të fondit të njohurive që i ka të shumta, për të kaluarën e fëmijërisë së tyre - pohon se kur ka luftuar osmanlija, ata që kanë dëshiruar, i pranonte si qytetar, ngase i nevojiteshin për të shumëzuar popullatën e Turqisë.



Ali Bylbyl-Bellopoja (i dyti nga e majta - me mjekër të zezë), një prej udhëheqësve të fabrikës së bakrit në Tekekojy pranë Detit të Zi (pamje e objektit, gusht 1997).

Me ardhjen në Stamboll, ia mësojnë sërish rrugës së gjatë. Në Vilajetin e Samsunit iu japin shtëpi. Shumë shpejt ia fillojnë të merren me ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë. Pas tre vjetëve, Rexhepi vdes dhe i biri i tij, Rifati, kishte vetëm 12 vjet. Me vdekjen e shpejtë edhe të ëmës, Rifati mbetet vetëm me të motrën, e cila ishte më e re se i vëllai.

Në atë kohë shpërthen lufta me Greqinë. Greqia i bombardon depotë e petrolejit (gazit). Kur niset lufta, Rifati me familje shpërngulen në Merzifun, ku jetojnë shtatë vjet dhe merren me tregti.

Kusherinjtë që jetonin në Bafra i informojnë se atje pushteti është duke dhënë tokë gratis. Tërë pasurinë e shesin dhe shkojnë në Bafra, në afërsi të kusherinjëve. Në Bafra jetojnë 20 vjet. Pastaj e shesin pasurinë dhe shpërgulën në Tekekojy. Në këtë qytet vazhdojnë ushtrimin e të njëjtës veprimtari, tregtinë. Në vitin 1994 Rifati vdes, kur i kishte mbushur 96 vjet. Djemtë e tij, Njazi (vjeç 67), Ademi (vjeç 63) dhe nipat e vazhdojnë veprimtarinë e tregtisë. Me pasurinë e krijuar në atë qytet, kanë arritur të jenë ndër më të pasurit. Nga familjet e tyre kanë dalë intelektualë të shquar. Punojnë në arsim, në administratën shtetërore dhe në ekonomi.

Gjëra nga më të ndryshme rrëfejnë edhe të tjerët. **Ibrahim Podvorica** (mbiemri zyrtar: Lekesis, që do të thotë i panjolla) është pronar i dy-tri librarive në Bafra. Ka njohuri të mirëfillta për të parët e tyre që kishin qenë dikur banorë të Obiliqit ose të rrethinës. Meqë posedon një mirësjellje të veçantë, por edhe ka lexuar për "memleqetin" është në gjendje të hyjë në biseda të gjithanshme për problemin e shqiptarëve; ofron të dhëna të argumentuara për vendbanimet e shqiptarëve (hartën e Bafrës etj.).

Musa Konjusha, që jeton në Samsun, sikurse edhe ky i mësipërmi, ndonëse të dytë të lindur në Turqi dhe i kanë shkelur të shtatëdhjetat, pa pengesa komunikojnë në shqipe. Ky ishte i njohur me lokalin e tij të tipit të kuzhinës popullore ("llokanta"), zeje që e kishte ushtruar gjithnjë. Konjushët në Samsun kishin ardhur që në vitin 1912-13. Është i interesuar për Kosovën dhe për shqiptarët në përgjithësi. Ka njohuri lidhur me shpërnguljet (sipas rrëfimeve që i ka dëgjuar nga prindërit), për peripecitë dhe nostalgjinë e shfaqur me vite të tëra. Mbanë lidhje të herëpashershme me Kosovën (nënë e ka bijë të

Gërshalive) dhe, së këndejmi, ka ruajtur diç më shumë nga thesari i gjuhës dhe i traditës.

Në tërë këtë kompleks, nga aspekti i disa specifikave, thuase janë dy botëra. Këta e pranojnë me kënaqësi prejardhjen shqiptare dhe për këtë fakt në çdo mjedis shfaqin mburrje. Mirëpo, vet rrethina e ka bërë të veten. Komunikimi mund të zhvillohet vetëm në gjuhën turke, me përjashtim të Ademit, babait të Aliut, të vetmit person nga të dhjetë familjet të atij ambienti, e jo vetëm të Bellopojëve, i cili është i denjë dhe jo harrestar për gjuhën e të parëve. **Inxhinieri Ali** mund të konsiderohet bashkëbiseduesi më i spikatur e njohës i mirë edhe i historisë së shqiptarëve, i cili me përkushtim dhe ndjenjë të veçantë e shpjegonte rrugëtimin, historinë e të parëve të vet. Ndonëse kurrë nuk kishte qenë në Kosovë, dinte ca gjëra për venbanimin e gjyshit, përkatësisht vendlindjen e tij, Millosheven dhe për Prishtinën. Kishte lexuar edhe literaturë historike, kështu që Grykën e Dardaneleve e lidhte me fisin Dardan të ilirëve. Në veçanti i interesonin dhe e preokuponin faktet historike për origjinën e shqiptarëve, për Konstatin e Madh, themeluesin e Konstantinopojës, kryeqendrës së Perandorisë Bizantine, i cili ishte nga Nishi, me prejardhje ilire. Për Kemal Mustafë - Ataturkun, themeluesin e Turqisë moderne, që ishte me prejardhje shqiptare, për Mehmet Aqifin, poetin e shquar në Turqi, autorin edhe të himnit turk, rrënjët e të cilit ishin nga Peja. Madje edhe për figura të historisë, ushtarakë, personalitete të artit dhe të kulturës, flet me pietet dhe veprat e tyre i njeh gjerësisht. Nëpërmjet këtyre kontakteve mund të dëgjosh dhe gjëra të tjera. Bie fjala, thonë se e ëma e **Tansu Çilerit** është me prejardhje shqiptare, siç flitet edhe për bashkëshorten e Syle-

jman Demirelit, e cila, po ashtu, nënën e ka me origjinë shqiptare. Flitet për emra të shquar në shtetin turk. Ka të tillë që me origjinë shqiptare (pa konfirmim të plotë) radhiten ndër kapitalistët e shquar, pasanikët e mëdhenjë, siç është Vehbi Koçi. Sakup Sabanxhija, me origjinë shqiptare njihet në mbarë Turqinë, si njeri i cili kapitalin e shumtë e ka të destinuar për lëmin e arsimit. Nën firmën e tij funksionojnë shkolla private deri në nivele më të larta universitare (në Stamboll, Ankara, Adana e në disa kryeqendra tjera anekënd Turqisë).



*Pjestarë shqiptarë, të përbashkët e të ndarë nga gjuha
(foto në qendër të qytetit Tekekojy, gusht 1997).*

Në këtë ambient, që mund të quhet i provave të sakta, ndeshesh me shembuj konkret se si fundoset anija e një pjese të kombit.

Mundësia bëhet gjithnjë më e vogël, për të ruajtur së pakut diç. Diferencat sa vijnë e shtohen.

9. FAMILJA SFARÇA E NJOHUR JO VETËM NË RRETHINËN E VET

*"Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, lark atdheut,
viset e ra, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsija e
udhëtimit, e një mijë gjëra që vihen re ndër të
huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën, e të
bëjnë jo t'a harrosh Shqipërinë, po të mos të
vejë te ajo që dëndur mendja..."*

Faik Konica

Në Turqi, nëpër shumë mjedise, përveç familjeve tjera, kishte edhe Sfarçali. Për t'i gjurmuar të gjithë, kur dhe ku kanë shkuar, është vështirë dhe e pamundur. Ndër informacionet e marra, aq sa ekziston mundësia, mund të veçohet familja Sfarça, e cila tash jeton në fshatin Karpuzkëjy, që më parë ishte i emërtuar Herc, si dhe në Baфра. Karpuskëjy është fshat i gjerë, me shtëpi të shpërndara, të shtrira nëpër çifligjet, pronësi e individëve. Kur thuhet se fshati vetëm shtatë kilometra është larg qytetit, më tepër flet për një vendbanim që ka karakteristikat e qytetit dhe gati gati është i bashkangjitur me të. Dikur e kishte këtë largësi, tash sikur është lagje periferike e Bafresë.

Në përgjithësi, fshatrat e kësaj ane, janë të shpërndara dhe përfshijnë hapësirë të dukshme, ngase familjet kanë nga disa hektarë tokë dhe kështu sipër-


faqet janë të gjera. Në këtë fshat njihet veçanërisht familja e **haxhi Adem Sfarçës**, përkatësisht e bijëve të tij, të cilët, ndonëse tash së voni të ndarë, veprojnë dhe jetojnë me mirëkuptim të pashoq.

Kjo familje nuk do të dallohej nga të tjerët, sikur të mos i kishte disa karakteristika, me të cilat sot e kësaj dite mbanë lidhjet e ngushta dhe të pandërprera, mbanë kontakte me Kosovën, me farefisninë që e ka këtu. Ka edhe specifika tjera. Mikpritjen thuase e ka të shtuar, e ka marrë nën sqetull nga vendlindja e të parëve dhe gjithësesi veçse e ka begatuar. Deri sa ishte gjallë haxhi Ademi, dera e tij rrinte e hapur për të njohur e të panjohur. Posa dëgjonte se në Bafra, në rrethinë ka mbërri ndonjë mysafir, shpejt e gjente lidhjen dhe vente bast të jetë mysafir i tij. Kjo traditë nuk është zvetnuar as sot. Në shëpitë e tre vëllezërve Sfarça, sidomos në atë të **haxhi Ahmetit**, por edhe të **haxhi Hasanit**, pa i lënë anash as bijtë e të ndjerit **Salih**, pra, të nipave (djemëve të vëllait të ndjerë **Salihut**), nuk kalon vjet e pa rrjedhë fjalë të gjallë e informacione nga të ardhurit prej viseve të Kosovës, ose të viseve më të gjera shqiptare. Si në shaka thonë: Edhe muret mërzhiten, po të mos dëgjojnë fjalë të gjuhës sonë të "memleqetit" (atdheut). Në të vërtetë, dy gjenerata të lidhura në një mjedis, e mbajnë gjallë shqipen. Në të shumtën e rasteve e flasin gjuhën e mëmës në shtëpi, në rrugë, në kafene. Meritë të veçantë për ruajtjen e këtij thesari, ka i ndjeri **haxhi Adem Sfarça**, përkatësisht **Xhymerti**, siç quhet kjo familje. Rëndom mbiemrat zyrtarizohen sipas ndonjë cilësie që kanë familjet. Nga tiparet e dorëshlirësisë, të dhënieve, këta që nga ardhja në atdheun e ri, pagëzohen me mbiemrin **Xhymerti**.

Xha Ademi kishte pasur rast të vizitojë vendlind-

jen vetëm pas 27 vjetëve jetë në Turqi, d.m.th. në vitin 1952. Që nga ajo vizitë kontaktet veçse intensifikohen, me këmbime të vizitave të ndërsjella gati për çdo vit.

Familja Sfarça ka edhe veti tjera. Para së gjithash i mbanë lidhjet kontinuele, mjaft të shpeshta me



Adem Sfarça përsëri me plis në kokë (ulur në mes) kur për herë të parë në vitin 1952, pas 27 vjetëve e viziton Kosovën.

vendlindjen e gjyshërve dhe stërgjyshërve. Me cilësi tjetër është pasuria me djersë dhe me mund të pandërprerë. Në këtë aspekt ka arritur të jetë i nderuar, jo vetëm për kapitalin që e ka krijuar dhe e ka fituar, por edhe për fjalën e dhënë dhe për mbajtjen e saj me përpikëri. Fjala e haxhi Ahmetit konsiderohet të ketë kuptimin e çekut, apo të kambialit, të një hipoteke të veçantë. Në këtë kontekst, kapitali më i madh, besnikëria, dorëzania, në asnjë mënyrë nuk zvetënohet dhe për këtë nuk ndodhin lajthitje, mosmarrëveshje. Imazhi i tij ka depërtuar edhe jashtë Bafres, mirëpo gëzon fakti se shqiptarët në përgjithësi njihen mjaft korrekt dhe fjala e tyre, edhe kur është e pashkruar, shërben si një lloj kontrate. Besimi nuk është arritur përnjëherë, por ai është sedimentuar me vite të tëra, me dekada, prandaj, provat e dhëna mundësonin prestigjin dhe nivelin e çmuar të sjelljeve, të autoritetit dhe të respektit.

Adem Sfarça ishte i ardhur nga **Toplica** në



*Haxhi Adem Sfarça
(1902-1975)*

fshatin Nedakoc të komunës së Vushtrrisë. Në këtë fshat ka disa familje të kësaj rrënje. Nuk dihet nga cila Sfarçë kanë ardhur (nga e poshtmjia apo e epërmja, e vogla apo e madhja). Me fis janë Sop. Disa nga këto familje që nga viti 1913 e kishin marrë udhën e pakthim të mërgimit për në Turqi. Si vazhdimësi e kësaj, në vitin 1925 edhe familjes Ademi i mbushet mendja që t'ia mësyje

mërgimit, kësaj rruge të pakthim. Ademi, biri i Qerimit, ishte djalë hasreti dhe kishte vetëm të ëmën, Hatixhen dhe bashkëshorten, Havën, ngase më parë i kishte vdekur babai. Nga Kosova udhëtojnë për në Izmir. Në fshatin Turgutli të Manises e blenë një shtëpi dhe një qerre me një kalë. Fillon të punojë në këtë fshat, por e ndien veten të vetmuar. Xhaxhallarët e tij, më herët kishin emigruar në Samsun, përkatësisht në Tekekëjy, qysh në vitet 1913/14, ndërsa babai i bashkëshortes, vjehrri, **Sejdi Gimolli** më vonë ishte shpërngulur në Bafra.

Xhaxhallarët dhe vjehrri me të dëgjuar për arritjen e Ademit në Manisa (Turgutli), një ditë e vizitojnë. Këmbimet e mendimeve dhe të informacioneve kushtëzojnë marrjen e një vendimi tjetër, të ri. Kështu që, brenda një kohe të shkurtër e shet shtëpinë dhe tërë plangun, për të shkuar te xhaxhallarët, te Behrami, Islami dhe Luta në Tekekëjy. Tekekëjy atëherë ishte fshat i vogël, me mundësi shumë të kufizuara për ndonjë zhvillim të hovshëm. Në atë vendbanim jeton 22 vjet rresht. Sado që bënte punë vetëmohuese, megjithatë për të arritur më shumë, gjërat ishin të limituara. Më së shumti kultivohej duhani, porse mundësia për zgjerimin e hapësirës së tokës ishte e kufizuar.

Bafra nga Tekekëjy ishte larg 67 km. Kontaktet bëhen më të shpeshta me këtë mjedis. Informacionet rrjedhin dhe gjithnjë janë më bindëse. Kësisoj, kjo familje perspektivën e sheh pikërisht në Bafra, në rrethinën e saj. Arsyet për të ndërruar truallin dhe vendbanimin ishin dyfarëshe. Së pari, në Tekekëjy elementi shqiptar ishte i paktë, me numër të vogël dhe si pasojë e kësaj gjendje, gjuha, tradita do të tjetërsohej më shpejtë. Dëshmi për këtë tash janë dy familje Sfarça (që jetojnë në këtë vendbanim, i

shndërruar në qendër komunale, sepse aktualisht i ka tiparet e qytetit), të cilat nuk kanë pasur as kushte, as mundësi t'i rezistojnë rrethinës dhe, nga e njëjta familje, që jo fort moti përbënte një vatër të përbashkët të vetme (edhe me atë të babait të Ahmetit), degëzohet me diferenca të theksuara dhe me ta komunikimi mund të bëhet vetëm në gjuhën turke. Të njëjtin epilog e kanë edhe të tetë familjet tjera, të Bellopojëve dhe të Bërbatovcëve, ndonëse i zoti i shtëpisë i kësaj të fundit paksa e flet shqipen. Së dyti, në pikëpamje të zgjerimit të bazës materiale, në truallin tjetër, në rrethinën e Bafres, konditat ishin më të favorshme. Nga këta faktorë është vështirë të peshohen cili ishte vendimtar e në këtë çast nuk është çështje relevante, pasi që edhe po të ishte dominues i pari, që ishte kundër tolerancës për një veprim jetik, me kalimin e kohës po ky vepron në të mirë të tolerancës dhe një element i tillë, për fat të keq, zvetnohet ende pa kaluar as pesë dekada.

Në vitin 1947 rrugëtojnë për Bafra, përkatësisht për në fshatin Herc (Karpuzkëjy). Familja e vogël e dikurshme ishte shtuar dhe numronte shtatë anëtarë. Tash kjo familje është degëzuar në tri sosh dhe duke i përfshirë anëtarët e tyre, djemtë dhe vajzat, nusët dhe të tjerët, madje nipat dhe mbesat, aktualisht i numron 50 frymë.


Në fshatin e ri së pari i blejnë 6 hektarë tokë (60 dylm), ndërsa me punën e palodhshme dhe vetëmohuese, më vonë pasurinë e zgjerojnë në 60 ha., kështu që, të tri familjet e ndara kanë çifligje të dëgjua në këtë anë. Kapitali nuk përbëhet vetëm nga dhjetëfishimi i sipërfaqes së tokës së punueshme, por ai ka potencial tjetër me vlera edhe më të mëdha dhe me strukturë atraktive. Toka është e rrafshtë, me përbërje pedologjike cilësore. Punohet në mënyrë inten-



*Përqafim i zjarrtë në Kosovë (1973):
motra Akilja dhe vëllau Ademi.*

sive, me masa agroteknike, ndërsa rendimentet janë të larta dhe të dyfishuara, pasi që gjatë një viti rëndom vilen dy bereqete. Kësisoj, familja Xhymerti është e njohur shumë më larg Bafres, si kultivuese e të lashtave,

drithërave të bardha, në veçanti grurit, perimeve, orizit, panxharit të sheqerit e tjerë. Kjo familje e begaton hambarin e Bafrës, njëren nga rajonet e njohura për furnizimin e Turqisë me produkte bujqësore.



Haxhi Ahmet Sfarça (Xhymerti)

Turqia do të ishte më e varfër pa hambarin e Bafrës dhe të rrethinës. Bafra me rrethinë do të ishin, gjithësesi, më të varfëra pa sasinë e prodhuar në familjet e Sfarçalive, të Ahmetit, Hasanit dhe të Samiut.

Me këtë që e veçnam nuk do të thotë se nuk ka edhe familje tjera, që kanë kapital të theksuar. Ka pronarë me çifligje edhe më të mëdha, me kapital të strukturës




*Sali Sfarça (Xhymerti)
(1935-1978)*



Haxhi Hasan Sfarça (Xhymerti)

tjetër. Mirëpo, kapitali i familjeve Sfarça viteve të fundit ka marrë cilësi përmbajtësore të reja, strukturë që mundëson kapitalizim më të shpejtë. Në qytet përmasat e tregtisë së tyre gjithnjë zgjerohen. Aktualisht e kanë Sallonin e vet të mobiljeve, ku qarkullimi, vëllimi i shitjes dhe profiti e tejkalojnë mjaft shumë tërë atë që fitohet në fshat. Çifligu në fshat, përveç tjerash, shërben si hipotekë e rëndësishme dhe në transaksionet dhe në biznesin madhor i hap dyer të sigurisë së veprimit. Apartamentet në qytet dhe në fshat ia shtojnë mundësinë e shtimit dhe të përmirësimit të standardit jetësor.

Puna e përditshme e familjes Sfarça, e karakterit mikst të përzier fshat dhe qytet, gumëzhinë ditë e natë. Çifligu i ngjanë ndonjë kooperative të modernizuar, të avancuar bujqësore. Qarkullimi tregtar në qytet përshkohet nga tiparet e modernizimit të jetës dhe të kalimit në rangje të reja të përsossh-



*Salloni i mobiljeve dhe apartamentet e Sfarçave
(Ahmetit dhe Hasanit, të njohur me mbiemrin Xhymerti).*

mërisë së punëve dhe të aktiviteteve. Vëllezërit e Samiut mirren edhe me shitblerjen e veturave, të traktorëve, me çka në mënyrë të planifikuar realizojnë diferenca të kënaqshme në çmim. Kanë provuar edhe veprimtari në lëmin e prodhimit industrial dhe kështu nuk iu mungojnë idetë për zgjerim edhe në këtë fushë.


Në këtë familje punohet shumë, por edhe konsumohet shumë. Rezultatet me efekte të shënuara gjithnjë e mbajnë baraspeshën në mes prodhimit dhe konsumit. Akumulimin, si ekonomistë të mirë, e çmojnë dhe e krijojnë si kategori që shërben për prosperitet, rritje dhe zhvillim të pasurisë.

Një gjë e tillë ka mundësuar të shtohet dukshëm standardi jetësor. Faktikisht, vështirë mund të dallohet jeta në fshat me atë të qytetit. Mobilimi, shërbimi, mënyja, janë të perfeksionuara. Familja Sfarça nuk ka të punësuar, bie fjala, në Gjermani, Holandë e gjetiu. Pothuaj secili prej tyre i moshës madhore kanë pasur rastin të vizitojnë shtete të ndryshme dhe, natyrisht, me sy të mprehtë perceptojnë gjërat, të cilat më pastaj i përvetësojnë në mënyrën e punës dhe të jetës së vet.

Pjesëtarët më të rinj, të moshës madhore të familjes Sfarça, dita më ditë e zgjerojnë biznesin dhe gamën e veprimeve. Përveç tregtisë me mobilie, me vetura, merren edhe me shitblerjen e keramikave të materialit të instalimeve të ujit dhe të kanalizimit e tjerë. Kohëve të fundit kanë pretendime të hyjnë edhe në botën e turizmit. Samiu, i biri i Salihut veçsa ka filluar biznesin turistik në Antali, në qendrën e famshme të turizmit në brigjet e Detit të Bardhë.

Sa i përket ruajtjes së thesarit të gjuhëve, të dokeve dhe të zakoneve shqiptare, familjet Sfarça nuk dallohen shumë nga të tjerat. Falë interesimit të babait të ndjerë, Ademit, shumëçka ruhet. Dy gjen-

erata të lindura në atë mjedis e artikulojnë shqipen, ndërsa gjenerata e tretë veçse tretet në klimën e ambientit. Fundja, është kjo sa për t'u thënë, sepse




Shtëpia e haxhi Ahmetit në Karpuskëjy.



Shtëpia e haxhi Hasanit në Karpuskëjy.

mjedisi konkret, si çdokund tjetër, gëlltitë dhe vetëm gëlltitë. Do të ishte ireale të mendohet për një rezistencë tjetër. Rezistenca është dashur të bëhet para 70-80 vjetëve, me rastin e marrjes së vendimit për t'ia mësyer atyre trevave. S'është e parëndësishme mbajtja e relacioneve, e shkuarjeve dhe arritjeve mbi këmbimin e vizitave me fafëfisninë e gjerë në Kosovë. Pa dyshim, kontaktet e tilla do të ndikojnë, aq sa është e mundur, që vëllazëria, dajallarët, nipat dhe mbesat, miqësia e gjerë, të komunikojnë në gjuhën e të parëve. Në kushte dhe në rrathana të caktuara - shqipja harrohet.



Dokument me të cilin përgjithnjë shlyheshin shqiptarët

10. PERIUDHAT E PEDATJEVE PËR NË TURQI DHE BRENDA SAJ

"Jo sot, por qysh në '13-tën, kur Evropa nënshkruante tragjedinë shqiptare, shqiptarët vetë e kuptonin se nuk mund të ketë Shqipëri, nuk mund të ketë popull të lirë e të lulëzuar shqiptarë, pa bashkim, pa zgjidhje të çështjes gjithëshqiptare në Ballkan".

Fatos Arapi

Në kuptim të gjerë, shekulli XX është periudhë e tërësishme e tronditjeve dhe e pedatjeve të shqiptarëve. Deri në dekadën e fundit, në fillin e viteve të nëntëdhjeta, absorbuesja më e pangopur dhe më e madhja ishte Turqia. Ajo, si çuditërisht, krijoi parakushte dhe kushte që popullata shqiptare, e konfesionit musliman, të gjejë mbështetje te i njëjti përbindësh i pesë shekujve me radhë. Përkundër kthimit të shpinës dhe drejtimit të tytave të ftohta metalike ndaj të "sëmurës së Bosforit", ato në etapat që vijnë sikur i fali, si të mos kishte ndodhur asgjë dhe iu bëhet fole të ikurve dhe të arratisurve nga vatrat e veta autoktone. Sado që është ky fenomen

për studim, nga ky kompleks mund të tërhiqen disa parametra real, me të cilët ilustruhet motivi dhe "zemërgjerësia" për falje dhe pranim.

Perandoria Osmane e njihte natyrën e shqiptarëve, qoftë edhe kur gjendeshin ballë për ballë të acaruar, qoftë në pozicione tjera. Në parallogaritë dhe sheshtimet e bëra, autoritetet përkatëse e kishin të qartë se me këtë gjest gjoja human, arrinë disa qëllime:

1. popullsinë e rivitalizonin me një racë, e cila është vitale, e aftë, trime dhe, mbi të gjitha historikisht është konfirmuar për besnikërinë, shkathtësinë, lojalitetin ndaj sundimtarëve;

2. është në gjendje të bëjë me zot mbrojtjen në çdo mjedis ku mobilizohet;

3. në kushtet e doktrinës dhe të kulturës islame që e ka të parapëlqyer dhe të përqaftuar, nuk shfaqë shenja mospajtimi, sidomos në rrethet kah janë të shpërndarë, e përfshirë në një rreth, përkatësisht rrjet të gjerë të pushtetit të organizuar vendës.

Tërë këtë strategji e realizonte nën pretekstin se ka të drejtë ta bëjë këtë dhe kinse është e interesuar për "popullin e vet", siç pretendonte që shqiptarin ta quante turk. Demarshet e kësaj natyre u konvenonin shteteve të Ballkanit, madje Fuqive të Mëdha dhe, pa marrë parasysh sa ishte penguar dhe mohuar identifikimi i kombit shqiptar, sa ishte i publikuar numri i tyre nëpër buletinet statistikore, shtirëshin të shurdhër dhe mbyllnin sytë para një populli të lashtë, i cili nëpër shekuj sakatosej, syrgjynosej dhe ndërrohej në qenie tjetër kombëtare. Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë i shkonte për shtati gjesti i përkrahjes dhe këtë në çdo mënyrë e stimulonin. Me këtë, pa therrë në këmbë pastrohet toka shqiptare nga populli autokton shqiptarë dhe mbetet djerrinë, me çka do të mundësohej që pa

pengesë të hyhet në pazarllëqe, për t'i pjestuar sferat e interesit siç donin Fuqitë e Mëdha, ku i gjejnë drejtëpërdrejtë ose tërthorazi interesat e koncesioneve të veta dhe Turqinë, të urrejtur aq shumë e mbështesin për muri, bile pa bërë ndonjë zhurmë të madhe. Kështu, viset shqiptare bëhen poligon i lojërave të fqinjëve dhe të Fuqive të Mëdha, bëhen log i pas-trimit etnik, kurse Turqia e merrë rolin e "mbrojtësit" dhe të strehuesit të "jetimëve" të pambrojtur.



Rast nga pritje e përcjellje (1973).

Po kush i bëri jetimë, kush i la të pambrojtur shqiptarët? Historia ofron fakte të shumta, të bollshme dhe shi për këtë ikin nga kjo problematikë. Problemi qëndron në faktin e mosformimit të ndërdijes kombëtare, të klimës tejet të vrazhdë politike, të gjenocidit të formave të ndryshme të pushtuesit sllav, të cilët gjithmonë i patën ëndërruar tokat shqiptare, të pastërta, pa banues shqiptarë në to.

Shqiptarët nuk ishin të pafajshëm as atëherë dhe

nuk janë as sot. Virtytin që e kanë në shërbim të tjerëve, duhet të gjejnë formë dhe metodë që ta kthejnë në favor të vetin. Me ndjenjën e sakrificës për çështjen kombëtare, uji mund të kthehet në jazin e mullirit vetjak. Qasjet dhe zemrimet e çfarëdo lloji nuk sjellin dobi, sado që e vërteta, e përmbushur me të mira dhe të këqia, me një anë janë pozitive, kurse në anën tjetër negative, duhet të bie mbi supet e kolektivitetit përkatës. Lëvdatat nuk sjellin asgjë të mirë, nëse nuk ka gjëra që e përmbushin thesin e tyre. Duke i vënë në shënjestër të metat, lëshimet, veset, mundësohet veprimi i ligjit të korigjimit, të perfeksionimit, të ngritjes dhe të ndërtimit të vetëdijes kombëtare. Vetëdija e fortë dhe e njëmendët kombëtare është domosdoja kryesore për shqiptarët.

Baseni që kapërdinë më së shumti shqiptarë është Turqia. Në të shkuan nëpër etapa të caktuara kohore. Fill pas përfundimit të periudhës shumë të madhe të Perandorisë Osmane dhe të rënies nën pushtetin sllav dhe grek të tokave shqiptare, çelet një kanjellë sa vetëmbrojtëse, aq tragjike, sa mbrojtëse aq jombrojtëse, sa e arsyeshme edhe më shumë e paarsyeshme. Duke kërkuar ndjesë nga të gjithë ata, të cilët në asnjë mënyrë nuk patën rrugë tjetër, një numër i madh janë edhe vet shkaktarë për gumëzhitjen e lumit të të pedaturëve dhe të shpërnguljeve.

Në trevën për të cilën po bëhet fjalë, viti 1913, përkatësisht 1914 i hapi dyert e ftohta, të cilat gjatë tërë shekullit nuk do të mbyllen kurrë.

Brenda këtyre viteve në Vilajetin e Samsunit arrijnë familjet e Prebrezëve, të Bellopojëve, të Toçanëve, të Sfarçalive e tjerë. Aq sa dijnë të tregojnë, anijet ishin përplot me muhaxherë shqiptarë, të cilat në tokat e Turqisë zbarkonin njerëz të moshave të ndryshme, mallin për trojet dhe atdheun e lënë

jnë, anijet ishin përplot me muhaxherë shqiptarë, të cilat në tokat e Turqisë zbarkonin njerëz të moshave të ndryshme, mallin për trojet dhe atdheun e lënë dhe, së bashku me këte, në mënyrë latente edhe ilacin për shkrirje të përgjithmonshme në një komb tjetër. P.sh. bashkëbiseduesit veçojnë se vetëm në anijen ku ishin shtegtarë disa familje të Prebrezëve (në vitin 1913), ishin edhe nja 50-60 familje të Molakëve, Balltiqëve etj. Për fat të keq, askund nuk ekzistojnë të dhëna për kompozicionin e të shpërngulurëve, për njësitë e pashkëputshme, të hallkave të zinxhirit të gjatë të eksodit trishtues. Sipas logjikës së shëndoshë, por edhe të evokimit të kujtimeve, nga ata që mbajnë mend, ose që kanë qenë të privilegjuar në këtë pikëpamje dhe kanë dëgjuar sa e sa herë për prindërit e tyre, ata u ndeshën me peripecitë më të theksuara. Problemet e ballafaquara përbënin spektër të gjerë. Mosnjohja e terrenit, e popullatës vendëse dhe e mentalitetit të tyre, e mbi të gjitha vështirësitë rreth komunikimit, për shkak të mosnjohjes së gjuhës në atdheun e ri; adaptimi me rrethinën që bëhet në kushte të ndërlikuara, ishin pengesë që kaloheshin me vështirësi të mëdha. Baza materiale, mëkëmbja në një mjedis gati shkretinor, në mes të pyjeve gati si të pashkelura, në moçale dhe në klimë përcëlluese, të përmbytur nga mushkonjat dhe nga acari gjatë dimrit, janë vetëm disa pjesë pothuajse cikërrime nga tërësia e rëndë që i molisin supet e shqiptarit. Vet fakti se nëpër qytetet e avancuara dhe të moderuara, ose në rrethinat e tyre, siç është Izmiri, Stambolli, Adapazari e tjerë, duhet të blehej pasuria, ndërsa nëpër disa mjedise tjera mund të ftohej gratis, flet qartë se muhaxherëve, ardhacakëve lehtësia iu ofrua aty ku vështirë mund të jetohej, ose aty ku paraqitet nevoja për pastrimin e viseve nga elementi

joturk. Faktikisht kishin shkuar si argat, për t'u shndërruar më pastaj në çipçi (jarenxhi-siç i thonë ata). Rruga e mëtejme nuk dihej. Shqiptarët e dinin apo nuk e dinin këtë, megjithatë, ishin përcaktuar për këtë fat. Në këtë rast, vetvetiu shfaqet edhe një pyetje e zymtë: Sa qenë të informuar shqiptarët për këto kushte dhe rrethana? Është fjala për informacionet dhe premtimet që i kanë marrë para se të marrin vendim për shpërngulje.

Shpërngulja e përgjithshme nga vatrat stërgjyshore është akti më i guximshëm dhe, njëkohësisht më absurdi në jetë. Pa arsye të pakalueshme në asnjë mënyrë, pa parallogari të sakta dhe relevante, hyrja



Moçalet e gjera (sikur në to bashkohet toka e qielli), mbeturinat e kahmotshme që e dëshmojnë ambientitn e dikurshëm

në tunelin njëkahësh të emigrimit, është gjesti më i rëndë dhe fatal. Ky mesazh vlen për të gjitha periudhat, epokat, gjeneratat, si atëherë, si më vonë në Turqi, sikurse tash, aktualisht për në Gjermani, Zvicër, Suedi, Finlandë, Norvegji e gjetiu.

Madje, në këtë katrahurë famëkeqe, nuk mund të krahasohet assesi, as nuk mund të identifikohet e djeshmja me të sotmen. E djeshmja mund të arsyetohet me nivelin e ulët, ose inekzistent të arsimit, ndërsa të sotmen nuk e justifikon ky element. Shumica, më saktësisht një numër i konsiderueshëm që ia mësyn Perëndimit (Evropës Perëndimore dhe Amerikës) janë të shkolluar. Nga ata fare pak shkuan të perfeksionohen në profesion, të specializohen, të bëhen edhe më të vlefshëm për atdheun e tyre. Më të shumtë janë ata, të cilët gjejnë prehje, duke pritur ndihmë, asistencë sociale nga shtetet ku kërkohet azil, që kjo ndihmë mund të quhet edhe lëmoshë lypsarësh.

Është e udhës t'i kthehemi trajtimit të temës së shtruar. Në Turqi vargu i dyndjeve nuk u ndal gjatë. Në mënyrë të përkufizuar, për çka është fjala, Bafra dhe rrethina, Samsuni si Vilajet, shqiptarë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare i pranojnë në të gjitha periudhat. Në atë mjedis arrijnë familjet e Dragushëve në vitin 1919 e më vonë, si dhe familjet e tjera, që shpërndahen anë e kënd këtij rajoni. S'do mend, në viset, rajonet e tjera të Turqisë, ardhacakët ishin me numër dhe me intensitet më të madh të shpërnguljeve. Secila periudhë karakterizohet edhe me pedatje të brendshme. Bie fjala, familja Sfarça në tokën e Turqisë kishte shkuar në vitin 1925 (duke mos i harruar ata të viteve 1913/14), porse së shpejti shpërngulet për në Tekekëjy dhe pas dy dekadave e luan truallin dhe zë vend në rrethinën e Bafrës, në fshatin Herc. Lëvizje migruese bëjnë edhe familjet tjera, siç janë ato të Bellopojëve, të Prebrezëve, të Konjushëve, të Pllanalive, të Dragushëve e tjerë.

Në vitin 1930 në rrethinën e Bafrës vendosen familjet e Tihovcëve nga njëra Dumnicë (nuk dihet nga cila). Sadik Tihovci, babai i Sahitit, ishte i njohur

si njeri i mençur dhe shpiak i mirë. Haxhi Sahiti, në moshën rreth 70-vjeçare asnjëherë nuk ka pasur rast



*Pjesëtarë të familjes së njejtë, por të ndarë territorialisht
(nga këta dy të ukur nga e majta në të djathtë
janë banorë të Kosovës)*

të shih Kosovën, sado që ka dëshirë të madhe. Afërsinë me trojet e të parëve sikur e sendërton nëpërmjet gjuhës së ruajtur, të një gjuhe të pastër shqipe, të cilën edhe djemtë dhe më gjerë e flasin shumë rrjedhshëm.

Në vitin 1948 arrinë Musë Mukulani, i cili gjatë periudhës 1940-1944 ishte pjesëtar i policisë së atëhershme. Një vjet del në mal (nga tetori i vitit 1944 deri në tetorin e vitit 1945). Në këtë kohë ishin në cilësinë e kaçakëve, ose të radhëve që i bënin rezistencë regjimit të ri, d.m.th. nuk pajtoheshin me regjimin komunist. Pas mbylljes së çdo mundësie për fitore dhe pas sakrificave të shumta që i përjetuan pas arratisjes, nga misioni anglo-amerikan iu mundësohet ikja për në Greqi. Nja 156 veta ikin në grup të organizuar dhe me shumë peripeci e kalojnë

kufirin e Greqisë. Në afërsi të Athinës rrijnë tri vjet. Marshuta e mëtejme për ta ishte Turqia. Në kampin e Greqisë e kishin përjetuar të zitë e ullirit. ndërsa Ismet Ineni i pengonte të hynin në Turqi, nëse atje nuk e kanë ndonjë të afërt dhe nga ata nuk marrin garancion. Pas vuajtjeve trishtuese, Musai i bie në gjurmë një të afërmi, nga i cili e merrë garancionin dhe në vitin 1948 shkon në Turqi, në rrethinën e Samsunit.

Musa Mukulani tash ka 77 vjet. Është i lindur në Babimoc (komuna e Prishtinës). Një kohë jeton në Dobranjë, prej ku angazhohet në polici. I përshkruan vuajtjet që janë të lidhura me vetminë, me bazën e ulët materiale. Me rastin e vrasjes së Emin Durakut, ishte diku aty pranë, por që nuk hynë në detaje për këtë ngjarje. Thotë në mënyrë lakonike: Eminin e kanë vrarë shokët e vet. Për vendlindjen e ka kapluar malli dhe, pothuaj më shumë se të tjerët, e shfaqë nostalgjinë për atdheun e dikurshëm. Në Kosovë nuk ka pasur mundësi të kthehet më kurrë, së paku për ndonjë vizitë të shkurtër. Mirëpo, për Kosovën ka kujtime të freskëta. Njeh shumë njerëz, si Adem Gllavicën, të cilin dikur e kishte epror, si dhe shumë personalitete tjera. Gjendjen materiale tash e ka të mirë, kurse nostalgjinë e ka të thellë për "memleqetin". Djemtë e tij kanë shtëpi në Bafra, në Samsun, në bregdet. Por, mbi të gjitha, sipas reagimeve të tij, ia peshon malli për atdhe. Pas ardhjes në Turqi krijon familje dhe bëhet dhëndër i Toçanëve, familja e të cilëve në Turqi kishin shkuar në vitin 1913.

Nuk janë të fundit Mukulanët që e mbyllin kaptinën e pedatjeve në Turqi. Para tyre, në vitin 1935 u shpërngulën Makovcit, ndërsa pas tij familja e Llozanëve. Llozana nga Rugovci (i Kamenicës), së bashku me një familje tjetër, në vitin 1958 e bekojnë tokën e Bafres. Është e tepërt të shënohet se Ilazi, i cili

në Bafra kishte shkuar në moshën 17 vjeçare, gjuhën turke e flet pa farë pengese, por nuk është e tepërt të thuhet se fëmijë e tij nuk e njohin gjuhën e babait.

Nga viti 1960 konsiderohet, sipas të dhënave nga bashkëbiseduesit të mjedisit të caktuar, nuk ka të ardhur në Vilajetin e Samsunit, pra, as në Bafra. Në kompleksin e pedatjeve, ku u përfshinë vetëm disa familje, me të cilat ilustrohen periudhat e shpërnguljeve, kishte edhe të tillë, të cilët kishin marrë vendime për kthim prapa. Ndonëse këta numërohen në gishtërinjë, megjithatë, pati individë që nuk i gllabëroi rrethina, nuk u pajtuan me rrëfimet si të ishin fantastike me rastin e shkuarjes, nuk gjetën fole më të ngrohtë se sa vendlindjen e vet. P.sh. Nazif Makovci, që ishte shpërngulur në të njejtën kohë me Llozanët, kthehet nga ka ardhur. Edhe më herët gjendeshin emra të rrallë që nuk mundën ta harrojnë e t'ia kthejnë shpinën përgjithmonë Kosovës.

Ilaz Llozana, më parë kishte ushtruar profesionin e marangozit, sepse babai i tij me vete kishte sjellë makina dhe teknologji për përpunimin e drurit. Më vonë ndërroi profesione. Nga ondulisti për femra, përcaktohet në zëjen e rrojtarit, ku në lokalitë e vet e kryen me zell këtë punë.

11. SHQIPTARËT MË NGA DY MBIEMRA

*"Ne njohim dy vetë që puse gërmojnë:
i miri dhe i ligu, por rrugët ndryshojnë:
i pari: që etjen ta shuaj ndër shokë,
i dyti: që bota të bjerë me kokë."*

Saadin

Republika e Turqisë përbëhet nga një popullsi heterogjene, e përzier. Ndonëse e regjistruar në vetëm në një komb - turq, megjithatë, ky komb është i përbërë me një strukturë të kombeve të shumëllojshme. Politika dhe statistika zyrtare e shtetit e njeh vetëm kombin turk, prandaj, si kusht themelor për t'u bërë banor i përhershëm i këtij vendi është pranimi i kësaj kondite. Në Turqi, përveç turqëve, jetojnë çerkezë, llazë, ermeme, arnautë, rumë, tatarë kurdë, gjorgjian, çeçen, boshnjakë, grekër, jahudi, jevgj e tjerë.

Natyrisht, secila kombësi e di prejardhjen e vet, i ka simbolet e veta, mbiemrat e vet. Me të shkelur në tokën e Turqisë, në harmoni me ligjet dhe kanunet e transformimit, ndër çështjet e para është ndërrimi i mbiemrit. Ndërrimi bëhet në saje të bisedës me ardhacakët, me qëllim që t'i përshtatet së paku përafërsisht tipareve, veprimtarisë, men-

talitetit të tyre. Në përgjithësi, ripagëzimi përmbanë mbiemra cilësorë, që simbolizojnë diç nga dëshira e të deklaruarit, ose kur nuk ka këso zgjidhjesh, gjenden mbiemra karakteristikë nga natyra.

Ilaz Niman Pestova shpërngulet në Stamboll në vitet e pesëdhjeta. Nuk e njihte gjuhën turke. Kur e pyesin për profesion ose ndonjë hobi që e ka, ai nuk di të përgjigjet. Ia thojnë qëllimin (për ndërrimin e mbiemrit) mirëpo ky nuk e kupton për çka është fjala. Në këtë rast, e emërtojnë Sylemez (d.m.th. nuk flet). Tash tërë familja e mbanë këtë mbiemër - Sylemez. Është ky vetëm një rast ndër shumë raste tjera.

Te shqiptarët, por edhe te të tjerët janë të pranishëm nga dy mbiemra: mbiemrat e dikurshëm edhe ata të tanishmit. Është karakteristike se në jetën e përditshme, në marrëdhëniet në mes veti, në krijimin e miqësisë, të ndonjë relacioni tjetër, kryesisht shërbehen me mbiemra që e kishin në shqip. Ndërkaq, mbiemrat e ri janë të origjinës turke dhe zbatimin e kanë në jetën zyrtare, në administratë, në ushtri, në jetën e përditshme administrative, mund të thuhet se fjala është për mbiemrat privat dhe për mbiemrat zyrtarë.

Ruajtja e mbiemrave privat e ka rëndësinë e vet, ngase me këtë, në mënyrë autentike ruhet e kaluara, prejardhja e secilës familje.

Është ky një lloj identifikimi për të dëshmuar të kaluarën, njësoj sikurse te ruajtja e mbiemrave, që janë rrjedhojë e makrotoponimeve (të vendbanimeve) të Sanxhakut të Nishit, nga të cilat u dëbuan me dhunë, në shekullin e kaluar. Për muhaxherët e Toplicës, të Kosanicës, të Pusta Rekës, përkatësisht të tërë rajonit të Sanxhakut të Nishit, nuk nevojitet dëshmi më e madhe se sa mbajtja e mbiemrave sipas vendbanimeve nga kanë ardhur (p.sh. Kalludra, Sfarça, Gjyshinca, Buçinca, Merovci e shumë të



Cfardo ndarje, riemërtim, nuk e mbulon dëshminë e lidhjeve familjare: kujtim nga pjesëtarë familjarë (në Kosovë e Turqi)

tjerë). E njëjta gjë reflektohet edhe te shqiptarët në Turqi. Në Vilajetin e Samsunit, në komunën e Bafrës dhe në komunat tjera, shqiptarët faktikisht njihen me mbiemrat me të cilët erdhën, edhe pse secila familje, grupacion i familjeve, banë mbiemër tjetër. Pra, kanë mbiemra të dyfishtë.

Kompleksi në fjalë mund të ilustruhet në çdo mjedis, për të gjithë shqiptarët, me ndonjë përjashtim të vogël, e të padukshëm. Pa patur mundësi të radhitën të gjithë mbiemrat, edhe këta që zihen në gojë e ilustronjë sadopak këtë çështje.

Bie fjala, Prebrezët, emërtohen me mbiemrin e dytë Aifer, që në shqipe do të thotë hëna e ndritshme. Dragushët quhen Güven (Gyven) dhe në përkthim të lirë e ka kuptimin Gëzim. Familjet Sfarça që jetojnë në Karpuzkëjy dhe në Tekekëjy e kanë mbiemrin Xhymert (Cömert), me domethënie dorëlirore. Shylemajtë janë të shndërruar në Jauz, d.m.th. anije. Malokët quhen

Kurnaz, ndërsa Tihovcit e mbajnë mbiemrin Yçëz. Bacalitë që jetojnë në Osmanbejluk, madje në Bafra, me mbiemrin e dytë quhen Bylbyl.

Me mbiemrin Bylbyl ka edhe të tjerë, pavarësisht në cilin vendbanim jetojnë. Për shembull, këtë mbiemër e kanë edhe Bellopojët, të cilët jetojnë në Tekekëjy. Ndërsa, familjet e Bellopojve që banojnë në Kajdollap mbiemrin e kanë Ajdemir (Hëna e hekurt). Familjet e Podvoricëve quhen Kurt (Ujk). Makovcasit e kanë mbiemrin Gjejljan (d.m.th. dreri), Lalinovcit quhen Çetin, Pasjaçët njihen me mbiemrin Erken (Herët), Tihovcit janë shndërruar në Ēz (Zemër), kurse Ratkocerët e kanë mbiemrin Bajrak (Flamur).

Sfarçat që jetojnë në Tashkëpri (Ura e gurit) janë të emërtuar me mbiemrin Duman (Tymi), familjet e Simnicëve e kanë mbiemrin Sari (Verdhë), Mukulanët quhen Asllan (Luan), ndërsa Llozanët, ata që jetojnë në Gërçësar e kanë mbiemrin Sezigin dhe një familje në Bafra e ka mbiemrin Ozan.

Ndërkaq, Zubicët njihen me mbiemrin Bajrak, familjet Pllana e kanë mbiemrin Orman (Mal), Marevcit quhen Ungju dhe po këtë mbiemër e kanë edhe Bacalitë që jetojnë në Bafra. Gojnovcit quhen Shener, kurse Gimnicët e kanë të pranuar mbiemërin Yrmok, Shurecët njihen me mbiemrin Shahin. Llumniceët e kanë mbiemrin Ēzturk (Zemër turku), ndërsa Podvoricët që jetojnë në Azay quhen Ilhan, ndërsa ata të Bafrës quhen Lekesis (pa njolla).

Familja e Boshnjakëve e mbanë mbiemrin Shahin, ajo e Orllanëve e ka përqafuar mbiemrin Yrmak. Një familje që quhej Turqeli i Prishtinës, tash e ka mbiemrin Jilmaz. Balltiqët quhen Ballta (d.m.th. Sopata), Rukovcit e kanë mbiemrin Allatash (Guri i larëm), ndërkaq, Sllakuçanët dhe Burincët e kanë të

njëtin mbiemër, Kurt, sikurse disa familje të Podvoricëve. Familjet Černogora njihen me mbiemrin Ustah (Mjeshtër), Zhinipotokët quhen Gun (Dita), ndërsa Berilët janë shndërruar në Gyndyz. Mbiemrat Vardar, u shndërruan në Prishtinali, Podvoricët që jetojnë në Kanaxhëk quhen Pazu, kurse Vërtopët e kanë marrë mbiemrin Top, sikurse Ivanjët në administratën turke njihen me mbiemrin Shen (duke qeshur, gëzuar). Lecët në fshatin Koshikëjy e kanë mbiemrin Tepedalen (Kodrën e çpon) e tjerë.

Siç shihet, shqiptarët e shpërngulur në Turqi i mbajnë nga dy mbiemra, por edhe dy kombësi. Prejardhja nga kombi shqiptarë, nga arnautët, aspak nuk i bën inferior pjesëtarët e dikurshëm të shqiptarizmes e që tash, të gjithë si një i përkasin kombit turk. Si shenjë identifikimi, në asnjë mënyrë nuk tentojnë të mohojnë këtë fakt, sepse vërtetë, për të ruajtur këtë gjurmë, që me kalimin e kohës, do të transformohet në diçka të qenë dikur, kanë dhënë prova pozitive me punën dhe veprimtarinë e vet. Edhe me rastin e lidhjes së miqësisë, të bashkëpunimit dhe të bashkëjetesës, kanë pasur nevojë që të dijnë nga kanë ardhur, nga cili fis, ku e kanë burimin mbiemrat e tyre dhe nga çfarë dëre kanë dalë. Një gjë e tillë nuk është zvetënuar në mesin e shqiptarëve. Forca e mos harresës së mbiemrave të mëparshëm gjithësesi është më e pranishme te pjesa e shqiptarëve, të cilët ende e kanë ruajtur shqipen. Te ata të cilët janë pëshëndetur me gjuhën e të parëve, si në jetën e përditshme, atë private apo edhe herë herë edhe në jetën zyrtare, tingllon dhe përdoret fund e krye mbiemri i shtetit që e ka atdhe dhe të gjuhës që e flet. Elementi joshqiptarë, me rastin e martesave, të krushqve, që tashmë dita më ditë janë intensifikuar, nuk i jep rëndësi mbiemrave

paraprakë dhe as që mund të dijnë ndonjë gjë për ta, porse e ka të qartë se ka të bëjë me një grupacion të veçantë të lidhur me diç të përbashkët, të ardhur nga Ballkani, përkatësisht Arnautlluku e që quhen shqiptarë. Sa i përket rejtingut, trashëgimisë, reputacionit, nuk i pengon asgjë që me këtë kombësi të afrohen edhe më shumë.

Kur shkruhen gjëra të tilla, nuk është e mjaftueshme të bëhen vetëm përshkrime stereotipe, por që nga gjendja faktike është e nevojshme të nxirren premisa dhe të jepen mesazhe përkatëse. Ndër të tjera, është domosdoshmëri, pa u bërë shumë vonë, të krijohen disa relacione analogjike të trajtimit të temave të kësaj natyre. Po të vihen paralelizmat të të njëjtit problem: të shqiptarëve që për disa dekada, gati për një shekull rresht shpërngulen në Turqi dhe të shqiptarëve, të cilët aktualisht nuk dijnë të ndalur në vazhden e shpërnguljeve për në shtetet evropiane (Gjermani, Zvicër, shtetet Skandinave, të Beneluksit e tjerë) dhe përtej oqeanëve, në Amerikë, Australi e tjerë, mund të vërehen dimensione të shumta. Është e qartë se koha, periudha kohore nuk përputhet, kahet, po ashtu nuk përputhen, ambienti, temperamenti, niveli kulturor ndryshojnë racionalisht nga mjedisi, nga ai i djeshmi dhe i sotmi. Ndërrimi i bombësisë, përqaftimi i kombit tjetër, ndërrimi i mbiemrave, që janë akte të pamohushme, sa mund të shërbejnë si alarm, sinjal për t'i vetëdijësuar shqiptarët e sotëm, të cilët, shumica syresh, pa kurrëfarë kriteresh shkelin mbi ate çka është qenësore në jetë: kombin. Kush mund të garantojë se në të ardhmen, paksa më të largët, nuk do të zhduken si në Oqeanin e Pafund, ku kultura, sjellja, niveli i zhvillimit i të tjerëve, i gëlltisin, i gëlltisin dhe vetëm i gëlltisin.

12. MALLI PËR ATDHE ZVETËNOHET GRADUALISHT

*"Kqyra bjeshkët ishin bleru,
plotë me pyje e me landri.
Na t'mjertë gjith tye vajtu,
Kosovë me Çamëri*

*Po vajtojnë gjith pa pushu,
gra e vajza pleq e tri
Kur vjen koha me u lirue,
me u bashkue me vllazni!"*

Rizah Strellci

Dhëmbi i kohës kafshon pa ndërprerje. Përmbyllja e etapave të periudhave kohore, zëvendësimi i të vjetrave me të renë, harresa, janë elemente të një procesi të natyrshëm, i cili nuk shuhet asnjëherë. Harresa është e dëmshme, aq është edhe e mirë. Por, jo për të gjitha situatat, tematikat. Nga aspekti i personalitetit, i kapacitetit të sistemit nervor të njeriut, kur harresa i shlyen sidomos anët e llahtarshme, krajatat, peripecitë, kanë domethënie pozitive, sepse në këtë mënyrë të këqijat mund të stimulohen me ngjarje pozitive, të kënaqësisë. Kjo mund të jetë dukuri e natyrës së individit. Ndërkaq, në kuptim të gjerë, struktura e

problemit është e ndërtuar ndryshe. Në rast se koha, harresa e fshinë atë që është esenciale, vitale dhe e



*Mordja nuk puishon: nga këta vetëm dy janë të gjallë
(foto 1965)*

patjetërsueshme për kolektivin, tragjika për atë popull është e pashmangshme.

Shqiptarët kanë një përvojë tejet të hidhur në këtë drejtim. Analitikët dhe secili që merret qoftë edhe me diç të pjesërishëm, periferike, sa herë që i evidencojnë, i shqyrtojnë dyndjet e mëdha të kësaj popullate, shpërnguljet masive e të pakthim, thuase e lajnë borxhin ndaj këtij problemi. Është kjo vetëm e çarë, përmbetje në pellgun e gjerë, që i sakatosi, i zvogëloi me numër e në ndjenja. Këto që zihen në gojë duhet të jenë sintagmë qortuese: nga pësimet duhet të nxirren mësim. Për të mos ndodhur gjërat prekëse, tronditëse, të shkrirjes dhe të asimilimit, është e nevojshme të gjendet formula me kohë, të zbatohet dhe të përfundojë me efekte.

Malli për atdhe mund të mirret si çështje relative. Gjeneratat e para që ikin nga vendlindja, pa marrë parasysh cilës kategori i përkasin, me çka janë të motivuar, mallin e mbajnë gjallë, pikërisht individët e pjekur, të cilët e mbajnë përgjegjësinë për të justifikuar hapin e mërgimit. Të tjerët, fëmijët, adoleshentët, assesi nuk e kanë këtë përgjegjësi. Të miturit nuk kanë nga t'ia mbajnë përveç se në rrugën pas prindërve, ndërsa adoleshentët jetojnë në botën e ëndërrave. Gjeneratat që lindin në mjediset tjera, që për prindërit e tyre janë të huaja, për ta nuk kanë ndonjë dallim, ngase mjedisin përkatës e konsiderojnë vendlindje, sepse realisht ashtu është, nuk kanë vendlindje tjetër. Së këndejmi, malli i tyre për atdheun e prindërve është vetëm një perceptim i cektë në trurin e pafajshëm, i ngulitur shkarazi nga fjalët e dëgjuara nga më të vjetrit, prindërit, xhaxhallarët, farefisi i gjerë...

Në këtë kontekst, objektivisht, zvetënimi, zvogëlimi deri në minimum i mallit për atdhe, për

atdheun e të parëve bëhet proces i rëndomtë, pa ndonjë dramatizim dhe tejdimensionim të çështjes. Arbreshët e Italisë brez pas brezi ruajnë diç nga origjina e tyre e mëhershme.

Arnautët në Turqi, që janë të datës më të re, janë më të kapshëm, më të lidhur me mallin për atdhe, ngase ka ende të gjallë, bile me numër jo të vogël, të cilët i mbajnë mend mirë vatrat nga janë shpërngulur. Shqiptarët në vendet e Evropës dhe gjetkë përbëjnë një nivel edhe më të freskët, më të përafërt me vatrat e tyre të lindjes, sepse pjesa dërrmuese e tyre aktualisht janë me një këmbë brenda dhe me një këmbë jashtë, pa e rregulluar ende statusin e azilantit, të refugjatit, me çka e fiton "rehatinë", që disave iu duket rehati. Rehatia dhe mjerimi në të shumtën e rasteve janë elemente kongruente dhe përputhen si të ishin një. Ikja nga sakrifica për çështjen e kombit dhe gjetja e rehatisë në kuartet e lypësisë është çështje më e shëmtuar se sa mjerimi më i papresedencë. Malli që theksohet në këtë kontekst, nuk është mallë për atdhe. Është fundosje e anijes së ekzistencës. Jo në pikëpamje të fundosjes fizike, por në aspektin e humbjes së qenësorës, të asaj me çka dallohen dhe krenohen njerëzit, popujt në mes veti.

Nga ky shkallëzim i shkurtër mund të konkludohet lehtë në ç'gjendje është malli për atdhe. Në Turqi, por edhe në enklavat e mëhershme, si në Itali, në Greqi, etj., është bërë çka është bërë dhe në interes është të bëhet përshkrimi autentik i asaj çka është bërë dhe i asaj që ka mbetur rreth kujtesës, nostalgjisë, ndjenjave për periudhat që nuk mund të kthehen.

Pa farë ekzagjerimi, problemi duhet të kuptohet drejtë. Përkundër çfarëdo peripecie, apo

dëshire, vet akti i emigrimit paraqet gërvishje të një tërësie, ose grishje për harresë. Motivi më i madh, më i thellë, gjithmonë e gllabëron motivin më të vogël. Së paku kjo është një rregull i pashkruar. Nisma e aksionit për atdhe tjetër e përbaltë dhe e injoron atë të ekzistuarin. Mirëpo, në tërë këtë problematikë ka gjëra që mund të diferencohen.


Shqiptarët në rrethinën e Vilajetit të Samsunit dhe veçanërisht në komunën e Bafres, në heterogjenitetin që e kanë, mund të bëjnë diferencimin në dy pjesë, grupe të mëdha. Në grupin e parë bëjnë pjesë ata të cilët kanë pasur mundësi ta ruajnë traditën dhe gjuhën e të parëve, si dhe ata të cilët posaçërisht mbajnë lidhje të pandërprera me "memleqetin". Grupi i dytë i përket pjesëtarëve, të cilët më herët janë shkëputur nga trugu i përbashkët kombëtar, nuk iu kanë mbetur farefis e të afërt që t'i mbajnë kontaktet, si dhe në ambientin ku jetojnë janë të penetruar më tepër me kombësi tjera, prandaj, logjikisht më të mundshme, më të tolerueshme janë krushqit, bashkëjetesa e përbashkët në mjedisin përkatës.

Grupi i parë, pa dyshim, është më i ngazëllyer, më i bashkangjitur me atë që është e tyre, e pararendësve dhe lidhur me këtë kultivojnë konsideratë më të lartë. Ndarja dhe malli për atdhe mbijeton edhe për shkak të kontakteve të shpeshta që realizohen në të dy drejtimet. Atyre parimisht u interesojnë ngjarjet, rastet dhe dukuritë që ndodhin në atdheun e të parëve. Janë kureshtarë që të zhvillohen procese pozitive, ndonëse nuk mund të kuptohet se janë të gatshëm për ndonjë sakrificë të mundshme. Fundja, sakrifica është varrosur që në hapin e parë, në ditën e marrjes së vendimit të boshatisjes së vendlindjes.

Sido që të jetë, malli për atdheun e dikurshëm pikon, buron padukshëm dhe nuk është plotësisht i shterrur. Me të hyrë më thellë në esencën e problemit, korrelacioni më i fortë shfaqet nga sensi i përkatësisë fetare, se sa i çështjes kombëtare. Edhe kjo lidhje e ka domethënien e vet, që do të thotë se gjërat mund të zhvillohen në kahe kah është gravitacioni më i madh.

Te pjesëtarët e grupit të dytë, të atyre që realisht nuk kanë mundësi t'i mbajnë kontaktet me mjedisin që e kanë lënë dhe se e kanë parapëlqyer gjuhën dhe sjelljen tjetër, malli për atdhe as që ekziston. Nëpërmjet gjurmimit mund të vërehet se edhe te ata ka mbetur e ngulitur forca e pranimit, e pohimit dhe jo e mohimit. Pa farë dileme dhe hezitimi, që në fjalën e parë dëshmojnë për prejardhjen e tyre, për një lloj krenarie latente, ose të shfaqur botërisht të ndjenjës që e kanë. Mirëpo, në të kundërtën, nuk mund të akuzohen për tërë atë që e artikulojnë, ngase një gjë e tillë duhet të jetë normale, e sensibilizuar nga vetja, nga kushtet, variabellet e rrethit. Në këtë rrafsh nuk shfaqin as më të voglin simptom të pendimit, as të mallkimit për ndokë tjetër. Mund të vërehen gjëra të diferencuara, kryesisht të dalluara në të njëjtën përmbajtje dhe brum të përbashkët. Po nga e njëjta rrënjë degëzimet kanë kahe të ndryshme. Edhe moshatarët, breznitë, anëtarët që janë të të njëjtit gjak, të së njëjtës vatrë, janë diferencuar me gjuhë, me sjellje, me përcaktime. Bie fjala, pjesëtarë të familjes Xhymerti (lexo: Sfarça), të cilët janë përcaktuar të jetojnë në mjedise të ndryshme, nga një trung i përbashkët që janë krijuar dy botëra, dy mentalitete. Xhafer Xhymerti, i moshës 66 vjeçare, po ashtu i lindur në të njëjtin vendbanim, pra, në Tekekëjy, familje e shpërngulur

nga Nedakoci komuna e Vushtrrisë dhe Ahmet Xhymerti, i lindur në të njëjtën vatrë, por që familja e tij në vitin 1947 shpërngulet në Karpuzkëjy, paraqesin dy kaptina të ndara. I pari, thuase nuk di fare për Kosovën dhe në te nuk ka qenë asnjëherë, ndërsa i dyti është njohës i mirë i vendlindjes së prindërve të tij dhe se dinë shumë detaje nga të gjitha fushat e kësaj treve. Natyrisht, kontaktet e shpeshta në të dy drejtimet (ka nipërit dhe mbesat te Gerxhalitë e Studimës së Poshtme - komuna e Vushtrrisë, në Mitrovicë, në Prishtinë), ia kanë mundësuar një gjë të tillë, sa që nganjëherë të thotë mendja se këtë ambient e njeh më mirë se sa vet vendasit. I pari ka prejardhje shqiptare, porse e ka të huaj gjuhën shqipe, kurse i dyti shqipen e ka aq të gjallë sikur të ishte i lindur në Kosovë. Të njëjtën gjë e gjen edhe te i vëllai i Ahmetit, Hasani, por edhe në familjen e gjerë të tij, si antipod i plotë i familjes Xhaferi.



Xhafer Xhymerti dhe Ahmet Xhymerti (të një vatre, por që i dallon gjuha): i pari e ka të harruar tërësisht, ndërsa i dyti e artikulon si të ishte i lindur dhe i rritur në Kosovë

Rastet e tilla janë të shumta dhe aktualisht paraqesin dukuri të përditshme dhe brendapërbrenda familjeve të ngushta, ku dy gjenerata, të lindura në Turqi, e ruajnë dhe flasin shqipen, ndërsa e treta ka hyrë në një tërësi tjetër, në atë që nuk e kupton dhe nuk e flet shqipen. Nga ky aspekt mund të kundrohet edhe problemi rreth përvlimit, apo të mosekzistimit fare të mallit për atdheun e baballarëve, të gjyshërve dhe të stërgjyshërve të tyre.

Kur flitet për çështjen shqiptare, është e udhës të mbizotërojë tehu kritik dhe realiteti në përgjithësi. Shpeshëherë qasjet kanë qenë të marginalizuara, duke i veçuar anët pozitive, duke u thelluar dhe zgjeruar në elementet vetëm pozitiviste. Ndërkaq, ato që janë të disfavorshme për afirmimin e cilës do teme të shtruar, që paraqesin një gradacion të ulët, lihen pasdore, sikur të jenë të huaja.

Për shqiptarët në përgjithësi ekziston një fenomen i çuditshëm, asnjëherë i pazbërthyer sa duhet. Te ky komb, në një anë, ekziston vitaliteti i njëmendët, me çka është ruajtur një tërësi, sado e vogël, por shumë e rëndësishme. Në anën tjetër, nga ky komb janë shkëputur pjesë aq të mëdha, sa që është çudi si sfidoi kjo pjesë e mbetur. Sado që flitet me të madhe për patriotizëm, për atdhedashuri, në këtë aspekt nuk jemi aq të dëshmuar. Është shumë më mirë këtë mangësi ta shohim vet, me dioptri reale, me qëllim të caktuar që të zmbrapset, të tjetërsohet dhe, pa teprime, duhet theksuar se kudo, këtu, por edhe në ekzil, për këtë komb është i domosdoshëm një katarzë e pandërprerë, derisa të dirigjohet me vetveten, deri në marrjen e vendimeve nga thellësia dhe bindjet individuale për sakrificat më të ndjeshme.

Është simptomatike një rast, ku në një dasmë,

autori bisedon me një vendës të fshatit Karpuzkëj, që kishte origjinë të kombësisë muslimane. Fjala është për **haxhi Vehbi Boshnjakun**, i cili në vitin 1929 kishte shkelur në Baфра dhe ishte i shpërngulur nga Mazgiti (komuna e Prishtinës). Të parët e tij në Mazgit kishin qenë të ardhur nga rrethina e Nikshiqit (Mali i Zi).

Me rastin e emigrimit i përmenduri kishte moshë 13 vjeçare. E mbanë mend mirë udhëtimin dhe peripecitë gjatë rrugës, ballafaqimin me një ambient gjysmë të lënë, ku nuk njihte askë. Babai i tij me familje mbesin në pikë të rrugës, derisa takohen rastësisht me të zotin e shtëpisë së familjeve të Prebrezëve, i cili i orienton, iu bën strehim në shtëpinë e tij në kohëzgjatje prej një viti e më tepër. Në moshën madhore, pas krijimit të plangut dhe të pasurisë tjetër, Vehbiu martohet me një vajzë shqiptare. Gjuhët i flet mirë, shqipen dhe turqishten. Si me shpoti, bashkëbiseduesit i drejtohem me pyetjen se nëse e di boshnjakishten, ka mundësi të komunikojë edhe me këtë gjuhë. Pa një pa dy, me një entuziazëm të veçantë, ia fillon bisedës. Dhe, ç'të dëgjohet: gjuhën serbe (boshnjakishten) e fliste aq rrjedhshëm, sikur ta fliste çdo ditë. Një rast i tillë nuk do të ishte i jashtëzakonshëm, po që se nuk i shtohet fakti se xha Vehbiu tash 68 vjet jeton në një mjedis, ku gjuha e tij amtare fare pak flitet, ku mbizotëron natyrshëm turqishtja, e pas saj edhe shqipja, ku ka familje të përzier dhe është gati i vetmuar. Komunikimi në këtë gjuhë të pranishmëve nuk iu ra në sy për të keq, ngase në këtë pikëpamje në ato mjedise ishte e pranishme fryma e tolerancës, përse i përket komunikimit në çfarëdo gjuhe që njihet, por, megjithatë, mund të bëhet çështje për

meditim të gjithanshëm. Ç'mund të thonë shqiptarët për këtë rast? Sidomos ata që e kanë harruar plotësisht shqipen, edhe për shkak të rrethanave të pavoritshme.

Lavdërimi i Vehbiut përfundon me kaq, sepse fëmijë e tij flasin vetëm gjuhën turqishte.

13. NË VILAJETIN E SAMSUNIT (DHE NË TURQI PËRGJITHËSISHT) SHQIPTARËT KANË KRIJUAR EMËR

*"Mos thuaj krejt atë që di,
por dije atë që thua"*
Mathias Claudius

Nuk është e tepërt të thuhet për përparësitë e shqiptarëve në Turqi, përkatësisht në Vilajetin e Samsunit, duke u bazuar veçanërisht në Bafra dhe në rrethinën e saj. Shqiptarët sikur të jenë të sojit të dyfishtë. Brendapërbrenda territorit të vet autokton, të asaj pjese të mbetur, të rrudhur e të ngushtuar, njëzet e më tepër shekuj kanë mbetur, ngelur të robëruar. Me përjashtime të caktuara, të dimensioneve tepër brilante, siç janë luftërat e Skënderbeut e tjerë, nuk iu shkoi përdore që ta flakin njëherë e përgjithmonë zgjedhën e huaj. Ndërkaq, të gjitha perandorive tjera iu shërbyen me devotshmëri, duke iu sjellë dobi dhe famë të pashlyeshme.

Në këtë rrafsh shqiptarët e Vilajetit të Samsunit, duke e veçuar Bafrën me rrethinën e saj, kanë lënë gjurmë, e cila vështirë se mund të shlyhet.

Faktikisht, që nga penetrimi me atë mjedis, u dalluan për shumëçka. Ndër virtytet me madhështi të veçantë janë puna, mikëpritja, fjala e dhënë, mençuria, aftësia për ruajtjen e vatrave e tjerë.

Sa i përket punës vetmohuese, atë e kishin kultivuar edhe sa ishin në rajonin e Nishit dhe në Kosovë. Të dëbuar me dhunë nga Sanxhaku i Nishit, pa plang e shtëpi, punuan ditë e natë dhe me mund të madh për një kohë relativisht të shkurtër arritën të pasurohen dhe disa prej tyre krijuan kapital të dukshëm. I njëjti avaz i ndoqi edhe në tokat e reja në Turqi. Djersa veçse rridhte rrëke. Shumë më keq seç e kishin pasur më parë. Në toka plotësisht të huaja, pa ia ditur "hujin", pa kuptuar shumë gjëra që ngjajnë përreth. Regjimi u gjente toka të pabanuara, të pyllëzuara, ose gjysmëshkretëtire, moçalike ose të rrezikuara për ndonjë gjë. Në këtë drejtim, shqiptarët refugjatë nuk rrijnë duarkryq. Ata gjurmojnë, merren vesh në mes veti dhe, ku janë e ku s'janë, i gjejnë lidhjet dhe afrohen pranë njëri tjetrit, në ambientet ku kushtet janë më të mira për jetesë. Për në atë kohë, aty ku vendoseshin nuk ishin kushtet e favorshme për të jetuar. Për shembull, tërë rajoni i Bafrës ishte i pyllëzuar me drunj të lartë dhe ishte vështirë të kalohej nëpër atë pyll. E njëjta panoramë ishte e pranishme edhe në komunat tjera, për çka sot e kësaj dite dëshmojnë aty këtu lisat shumëvjeçarë. Mushkonjat ishin armiqtë më të mëdhenj. Nga "ekspeditat" e tyre të çdoditshme, të çdo kohe, lajmëroheshin sëmundjet e etheve dhe të tjera, shpeshëherë me epilogun vdekjeprurës. vendësit autokton (jerlitë) largoheshin nga këto mjedise, nga këto kushte të vështira dhe zgjidhnin lartësitë për banim, me ajër dhe kullosa për bagëti. Muhaxherët shqiptarë,

përveç imponimit, megjithatë, kishin sens të mendonin edhe për nesër. Kështu, tash i kanë lokacionet më të favorshme dhe më të begata për jetesë. Zaten edhe në Kosovë mund të vërehet një dallim i dukshëm. Muhaxherët në përgjithësi kanë vendbanimet më të mira se sa vendësit e mëhershëm.

Edhe për këtë që e kanë arritur në pikëpamje ekonomike, materiale, nuk janë gjithnjë të kënaqur. Vërejnë mangësi të strategjive, të taktikave. Mirëpo, koha ecën dhe e bën të veten. E kaluara është e zhdukur. Ekzistojnë antagonizma në mes të gjeneratave. Natyrisht, gjenerata e re ka koncepte bashkëkohore të jetesës dhe të veprimit. Xhevdeti, Samiu, Sahiti, Bekiri, Erkeni... kanë vizione tjera kundrejt më të vjetërve. Tash secili dëshiron të ushtrojë punë më produktive, racionale dhe dobiprurëse. Këta janë të përcaktuar për tregti, turizëm dhe prodhim. Xhevdet Prebreza thekson dallimet që janë bërë në 15-20 vjetët e fundit në sjellje dhe në standardin jetësor. Ndonëse nuk e thot, porse faji thuaja u mbetet pleqëve, më të moshuarve, pa e pasur parasysh faktorin kohor dhe zhvillimin e tërësishëm të shtetit në këto dekadat e fundit. Megjithkëtë, ka edhe të moshuar që e urrejnë mosdijen e mëhershme. Xha Ibrahim, si në shaka pohon: "leshi i deleve rrinte në tavan, kurse ne flenim në çergë". Ose: koha kur patën mundësi të marrin tokë e pasuri, të zgjerohen në qytet, aktualisht ka perënduar. Abdullah Erken, një shitës i mobileve i ka konceptet e veta dhe shumë gjëra i mbarështron sipas kutit të vet, siç është rasti edhe me Mustafa Güven, i cili jeton në Tiranë dhe di shumë gjëra edhe për realitetin shqiptar.



*Mbeturina të pyllit në Tekeköjy
(pikërisht këtu ishte oborri i dikurshëm i familjes Sfarça)*

Puna për ta ishte parësore, prandaj, me kalimin e kohës, te popullata me prejardhje shqiptare dalin në shesh emra që kanë krijuar pasuri të lakmueshme. Madje, jo vetëm në këtë trevë për të cilën bëhet fjalë, por në mbarë Turqinë përmenden me pietet emra të shquar për kapital që dallohet nga shumëkush. Për këtë të arritur ka shërbyer edhe fjala e dhënë, besa, sa që në të shumtën e rasteve fjala e shqiptarit e zëvendësonte nënshkrimin e kontratës.

Shqiptarët lanë nam dhe krijuan emër që s'harrohet dot për trimëritë e treguara. Çetat luftarake më të shquara, më të njohura, përbëheshin nga këta pjesëtarë dhe prijësit e çetave, siç i quajmë çetobashët, kanë mbetur të paharruar sot e kësaj dite. Vërtet çfarëdo fronti që ia mësynin, ishin në gjendje të depërtojnë dhe të arrijnë deri te qëllimi. Edhe

individët dhe grupacionet më të rrepta, më tmeruese, thyheshin dhe zbrapseshin nga ata.



Pjesë moçalike të sotme në territorin e komunës së Bafrës

Emër i paharruar është **Islam Grabanica**, i cili ishte prijës i çetave ("çetobash") për shumë kohë. Shkathtësitë, trimëritë, taktikat dhe caqet e tij gati ishin shndërruar në legjendë. Për te gjeneratat flasin me epitete. Shumëçka dijnë për trimërinë e tij. Edhe në rastet më dramatike, kur gjendej në pozitë më të padepërtueshme, në tradhtitë që ua bëjnë të tjerët, disi gjenë ndonjë rrugë dhe mbetet gjallë. Tregohet një rast tejet i koklavitur, kur njëri me origjinë hungareze e tradhton dhe e qet në pusi, diku në afërsi të Merzifunit. Aty i vritet kali, ndërsa ai me mjeshturinë dhe mençurinë e pashoqe shtrihet si i vrarë, derisa kalon rreziku dhe kështu mbetet gjallë për sa kohë. Po ashtu kishte lënë vepra strategjike dhe të guximshme edhe në likuidimin e



Luftëtarë të njohur: Hasan Llumnica, Mehmet Çausi dhe Sherif Makovci (nga e majta në të djathtë)

kundërshtarëve të tërbuar, të cilëve nuk kishte askush mundësi t'iu dalë përpara. Me metoda të përpunuara mirë, **Sejdi Grabanica** e bënte të veten. Çeta e tij ishte bërë tmerr për çfarëdo kundërshtari.

Hasan Llumnica, që ishte gjallë deri para disa vitesh, njihej për trimëri të pashoqe. Ndër beteja dhe ndër luftime individuale ishte i pamposhtur. Pas

vetes kishte lënë djemtë (Shabanin, Rrahimin e ndjerë, Ramizin dhe Ibrahimin), të cilët jetojnë ende nën hijen e famës së babait. **Mehmet Çausi** ka lënë emër të pashlyer. Nga frontet që ia mësyente, përherë dilte fitues. Atë e quanin "Toskë", që mund të kuptohet se kishte ardhur diku nga Maqedonia ose nga Shqipëria. Më saktë është ardhja e tij nga rrethina e Dojranit, sepse njihej edhe me këtë mbiemër. Po ashtu, **Sherif Makovci** nuk ishte aspak prapa tyre. Krah për krah me shokët e vet ishte i depërtueshëm dhe i pathyeshëm edhe në rastet më të rënda, më të ndërlikuar.

Përveç të sipërpërmendurëve, vargu i emrave të këtij lloji është i gjatë. Përmenden dhe përkujtohen me respekt **Hamit Ratkoceri**, **Islam Preskoshi**, **Halil Maloku**, **Ramë Burinca** e të tjerë. Meshkujt e **Konjuhëve** me trimëritë e tyre nuk harrohen kurrë.


Trimëritë e dalluara të individëve dhe të bashkëluftëtarëve të shumtë, patën jehonë të rëndësishme në nivelet më të larta të hierarkisë turke. Pushteti turk kishte nevojë për këta trima të denjë, sepse pikërisht këta ishin në vijën e parë të frontit, për t'i pastruar elementet kundërshtare të pushtetit dhe të shtetit të Turqisë. Natyrisht, një shquarje e tillë e shqiptarëve, që janë në shërbim të shteteve tjera, nuk është e rastit, as e para. Historia na mëson për veprat madhore të shqiptarëve, të famshme dhe të dobishme për të tjerët. Është kjo një dukuri e çuditshme dhe e neveritshme në kuptimin e mosdhënies së sakrificës për atdheun e vet. Është kjo temë e gjerë, që imponon shtjellim të gjithanshëm. Megjithkëtë, pa u thelluar më tepër, shkaqet mund të veçohen në dy grupe: e para, robëria e kahershme implikohet edhe në sjelljet dhe besnikërinë ndaj sunduesit dhe, e dyta, shqiptarëve në

truallin e vet, si duket, u mungoi udhëheqja karizmë, ajo që me strategji, njohuri dhe dinjitet të lartë do t'i udhëhiqte masat e popullit.

Dosido, epitete pozitive, edhe këto të trimërisë janë më të rëndësishme se sa të tregoheshin qyqarë. Fundja, ata e kanë zgjedhur këtë përcaktim: nga bindjet, motivet e patrajtuara sa duhet, nga ndonjë shtypje, shtytje spontane e tjerë. Cilado qoftë më e peshuara, s'ka pse të dyshohet, e ka bërë të veten. Andaj, është shumë më mirë që në mjediset e huaja, të pambrojtur, pa informacione të bollshme për të ditur se në çfarë ambienti jetojnë, të tregohen vital, të vendosur dhe të mos lejojnë kurrëfarë cënimi të vatrave të tyre. Po kështu, pushteti sado që nuk i kishte të adhuruar, për shkaqe të veprave dhe të zotësive të dalluara që i posedonin, ishte i detyruar t'i favorizonte, ose së paku të mos u përzihej shumë në punët e tyre.

Kishte raste që organizoheshin rrjeta të fshehura për t'i nënshtruar këto çeta, mirëpo, disfatat ishin të sigurta dhe, shi për këtë nga këto aksione hiqnin dorë, sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Reputacioni i trimërisë shndërrohet në traditë, prandaj, edhe pse kanë kaluar ato kohë dhe ato kondita, në gjeneratat e pastajme përcillet kryelartësia e shqiptarit, që dallohet nga të gjithë të tjerët, nga kombësitë që jetojnë në ato mjedise.

Rajoni i Samsunit në përgjithësi dhe Bafra me rrethinë në veçanti, patën dhe kanë edhe sot njerëz të mençur. **Sejdi Gimolli** njihet si njeri fisnik dhe i mençur, të cilit fjala i peshohej rëndë. Ai në rrethinë e Bafrës kishte ardhur nga Raskova (komuna e Prishtinës) dhe për shkak të mprehtësisë së mendjes dhe të sinqeritetit, kishte afruar shumë miq rreth vetes. Ai me vete kishte dy gjëra: trimërinë dhe



*Sejdi Gimolli (në këmbë në mes)
me nipat dhe dhëndërrin Adem*

mençurinë. Mirëpo, trimërinë thuase e kishte lënë në Kosovë, ku kishte luftuar kundër pushtuesve të çfarëdo lloji, të turqve dhe të sllavëve. Nga ky aspekt sikur nuk dëshironte këtë forcë t'ia falë dikujt tjetër, përveç atje ku e kishte shfrytëzuar. Në ambientin e ri këtij burri i mbetet virtyti tjetër - mençuria, që pa dyshim, ishte dimension i rëndësishëm për të formësuar emër të shquar.

Ndër shumë të tjerë, familje të shquara, me kryeparë të mençur, njihen Malokët. Malokët janë Bllacali dhe sot e kësaj dite mbijeton autoriteti i pleqve. Siç rrëfejnë ata që i njihnin (p.sh. Mahmut Prebreza), **Halil Maloku** s'kishte burrë që guxon t'i dal përpara. Ishte shtatëllartë, i zoti për çdo gjë dhe shumë i pashëm. Përveç këtyretributeve kishte edhe një veti tjetër: mençurinë. Në këtë kontekst, si njeri i dalluar me zotësi dhe mençuri përmendet me respekt **Sejdi Maloku**, nën hijen e të cilit nuk mbetet aspak as **Mehmet Maloku**, i cili jetonte shumë larg këtyre, territorialisht, në Kytahije. Familjet e tyre njiheshin atëherë me veçori të theksuara, porse edhe tash janë të dalluara, sidomos me pasuri të gjerë.

Edhe ndër gjeneratat tjera, të tashmet kanë njerëz të shquar, që luajnë rol në ndërmjetësimet, në pajtime, të mbështetur në peshën e fjalës së tyre. Janë të dalluar **haxhi Jashar Prebreza**, **haxhi Ahmet Sfarça**, **haxhi Ibrahim Baca** e të tjerë e të tjerë. Këta janë vazhdues të traditës së ndritshme dhe emrat e tyre nuk janë të njohur vetëm në rrethinën e ngushtë, por shumë më gjerë.

Shqiptarët e Bafrës dhe si duket në mbarë Turqinë e kanë krijuar një imazh të rëndësishëm, të lakmueshëm. Për trevën që trajtohet, tregojnë se kanë pasur shansë t'i kenë punët edhe më mirë. Atëherë kur kishin ardhur, në ato kushte tejet të

pavolitshme, kur shtëpitë ndërtoheshin në malet e pakalueshme dhe gjithnjë ishin të rrezikuara nga derrat e egër dhe llojet e tjera të bishave, ku shumë vështirë e gjenin njëri tjetrin, patën mundësi të përvetësojnë hapësira sa të dëshirojnë. Patën mundësi të marrin shtëpi të zbrazura, të cilat kishin mbetur djerrinë përgjithnjë nga të ikurit nga luftërat dhe llahtaritë tjera. Kishin mundësi të vendoseshin në qytetin e Bafrës, ku - siç thonë bashkëbiseduesit - ky qytet do të ishte kryesisht i shqiptarëve. Mirëpo, ç'është e vërteta, atëherë nuk kishin levërdi të vendosen në qytet. Qyteti në fjalë ishte i vogël dhe për atë kohë nuk ishte qendër e rëndësishme, me tipare të tregtisë, të zejtarisë e tjerë. Njëkohësisht, shqiptarëve u mungonte njohuria për ushtrimin e ndonjë zeje. Dhe, rrëfejnë pleqtë e tashëm, mendonin: ç'na duhen muret. Toka ishte për ta bazament, ku sigurohej kafshata e gojës.

Faktikisht, pushteti turk shqiptarët nuk i favorizoi për t'iu gjetur toka, vendbanime të mira. Ata i vendosën në vise të largëta, ku ishte i pranishëm elementi i huaj, nga i cili Turqia pretendonte të lirohej. I vendosi nëpër vende moçalike, mjedise këto ku pushtetin e kishin mushkonjat dhe mizat e zezë. I vendosën në shkretëtirat dhe në gjysmëshkretëtirat e Anadollit, për t'i vënë si mbrojtje, si digë ndaj kurdëve e të tjerëve. Mirëpo, shqiptarët ishin syçelë. Përvoja e hidhur i kishte mësuar që të dijnë pak më tepër për vete. Kështu, dalëngadalë gjurmonin metoda dhe mënyra që të gjejnë mjedise më të përshtatshme. Në mjediset përkatëse, ku mund të bëheshin transformime, ndryshime të ambientit, në të mirë të përmirësimit të standardit jetësor, të përmirësimit të kushteve të jetesës nuk iu mungonte angazhimi dhe puna vetëmohuese. Ndërkaq, nga

mjediset që ishin të papërshtatshme dhe në to numri i varreve zgjerohej shumë shpejt, tërhiqeshin, duke gjetur bashkëkombasit e vet dhe, në këtë mënyrë arrin edhe bashkëjetesën më të qëndrueshme, si dhe bazën ekonomike më të mirë.

Nga mençuria dhe syçeltësia e tillë, shqiptarëve shpeshëherë iu kanë lakmi të tjerët. Ata nuk ishin të zotët sikurse shqiptarët të luftonin me nënën natyrë. Përtacia e tyre duket shumë vonë, kur raportet në shoqëri kishin ndryshuar. Shqiptarët patën mundësi të detyrojnë veten të rreken me punë në çdo front, t'i arrijnë vendësit, madje edhe t'i tejkalojnë. Edhe marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore më të avancuara mundësuan një gjë të tillë. Ata me punën e vet u mëkëmbën. Ndërkaq, e tashmja, për diasporën flet ndryshe. Shqiptarët në ekzil kryesisht shkojnë për të jetuar, për të jetuar pa punuar. Çfarë emri mund të kenë këta, përveç të parazitëve, të lypsarëve.

14. TRADITAT QË ENDE MBRETËROJNË

"... Disa prej tyre i kanë bërë dëm vetvetes, disa prej tyre janë mesatarë, e disa prej tyre, me ndihmën e All-llahut, prijnë për punë të mira..."

Suretu Fatir: 32

Për të thënë diç zulumëmadhe, për ruajtjen e autetitit dhe të traditës, është barazi si të shtrembërohet realiteti me qëllim të caktuar. Në Turqi ka laryshi të shumta, në mënyrën e jetesës, në sjellje, në ruajtjen e vlerave të traditës. Sa i përket ndonjë pengese të natyrës administrative, gati nuk mund të gjesh. Shqiptarët, kudo që janë, mund të flasin edhe shqipen. Në Bafra shqipja dëgjohej në rrugë, në kafene, në ndeja të rëndomta. Kjo gjuhë nuk ia prish veshin as policit, as intelektualit dhe as qytetarit të zakonshtëm. Edhe kur është fjala për organizimin e dasmave, të ahengjeve, nuk paraqitet kurrëfarë pengese për mënyrën e organizimit, për këngët që do të këndohen, për vallet e tjera.

Të gjitha këto shkojnë me një ritëm të rëndomtë. Pushteti turk nuk e pengon këtë gjë. As fqinjët që mund të jenë me prejardhje të kombeve tjera. As nuk shfaqen urrejtjet e hapura, por që në

mënyrë kohezive, vetvetiu shkrihen në një, në një të vetme, në vetëm një kulturë. Së këndejmi, për të folur për kultivimin dhe ruajtjen e traditave shqiptare, më tepër është çështje absurde se sa realitet. Megjithatë, kultura dhe tradita e popullit shqiptar në Vilajetin e Samsunit dhe në Bafra me rrethinë në veçanti, nuk është tretur plotësisht. Ekzistojnë elemente të traditës, të cilat sot e kësaj dite frymojnë dhe gjejnë zbatim në jetën e përditshme. Nga tradita, te ata ku flitet shqipja, kanë mbetur frazeologjizmat, anekdotat, përrallat, bujaria, mikëpritja, besa, pleqëria e burrave, diç nga folklori, ngushëllimet e tjerë.

Nga të gjitha dallohet **mikëpritja dhe bujaria**. Mikëpritja shqiptare edhe atje çmohet nga rrethina. Mënyra e pritjes së mysafirëve, shtruarja e tryezës, mënyja, kanë ruajtur gjëra origjinale shqiptare. Sofra e shqiptarit është ndër më të pastërtat dhe më e begata. Në këtë kontekst, siç thonë edhe ata vet, nuk mbetet prapa as sofra e Çerkezëve. Mirëpo, nga aspekti i bujarisë dhe mikëpritjes, megjithatë, shqiptarët janë prijtarë.

Natyrisht, çdo sofër nuk mund të jetë njësoj e begatshme. Kjo, në radhë të parë varet nga baza materiale që e kanë familjet, por që nga prizma e bujarisë ka pak dallime. Edhe aty është e pranishme sintagma: bukë, kripë dhe zemër.

Turqit vendës nuk kanë pasur mundësi t'ua tejkalojnë shqiptarëve. Në të kundërtën ata kanë marrë diç nga shqiptarët, kanë përfutur shumëçka. Është karakteristike se në sofrat e shqiptarëve, si dhe në viset nga kanë shkuar servohet lëngu (shllinë dhe xhizë me kripë) dhe si me shpoti ky quhet "reçeli i arnautëve". Këtë specialitet të thjeshtë, por mjaft të përhapur te shqiptarët, e pëlqejnë edhe të tjerët.

Produktet nga brumi, siç është pitja, pothuajse janë të origjinës së shqiptarëve. Përveç gjellërave të disallojshme, pitja dhe pilafi janë ushqime të standardizuara dhe janë të pranishme veçanërisht në sofrat e begata.

Besa te shqiptarët ka qenë një institucion në vete dhe i qëndrueshëm për shumë kohë. Tash, natyrisht, sjellja ka ndryshuar dhe nuk mund të flitet për tërë atë spektër të virtyteve të saj. Megjithatë, diç nga ajo është shndërruar në traditë. Në Turqi fjalës së shqiptarit, gati, gjithkush i beson.

Dasma e ka humbur koloritin shqiptar. Deri para njëzet-tridhjetë vjetëve, nga brezi në brez është bartur si njësi e pandryshuar. Aktiviteti i dasmës mbante disa veprime të përbashkëta. I zoti i dasmës tubonte farefisnin dhe fqinjët. U shpjegonte qëllimin e vetë dhe iu bënte të ditur për dasmën dhe terminin e saj. Që nga ky çast, mjedisi imediat dhe nga fshatrat e afërta, në cilësinë e afërsisë së gjakut apo të shoqërisë e miqësisë, deklaroheshin se nga sa secili do të merrte mysafirë dhe dasmorë në konaqet e veta. Më pastaj dërgoheshin njerëzit për t'i ftuar dasmorët. Nga çdo katund ftoheshin një numër i caktuar në dasëm, edhe pse në disa sosh nuk kishte lidhje farefisnore.

Dasma, sikurse edhe këtu, në Kosovë, nisët të enjten në mëngjes, kur gatuhet kulaçi. Riti fillon me këngë. Krismat e pushkëve jehojnë pasi të falet namazi i mëngjesit (sabahu), me çka deklarohet fillimi i dasmës. Të shtunën deri në mbrëmje vijnë krushqit. Të dielën pas dreke shkojnë dhe e marrin nusen. Pasi të sillet nusja në shtëpi shtrohet dreka. Të shtunën dasmorët ndahen nëpër konaqe. Ndërsa dreka e së dielës është e përbashkët, e zotit të das-

mës. Pas ngrënies së drekës bëhet shpërndarja e krushqëve nëpër shtëpitë e tyre.

Ditën e hënë gatuhet kulaçi i nusës. Thirren të afërmit, e shohin nusen dhe kur shtrohet sofra lënë para në kulaç.

Para disa dekadave, gjatë kohës së dasmës është gjuajtur në shenjë. Organizohet "ygdyli", vrapimi, kush do të dalë i pari. Edhe kur merrej nusja, krismat ushtojnë. Breshëria dëgjohet posa të merret leja nga të afërmit e nuses. Shkuarja e "janx-hive", bullave, d.m.th., e grave dhe vajzave është çështje e rëndomtë. Pra, çdo gjë ishte e njëjtë me dasmën, të cilat doke i kishin marrë dhe kultivuar me vete, me të gjitha ceremonitë që organizoheshin në vendlindje.

Tash këto elemente përmbajtësore veçse mbahen në kujtesën e më të moshuarëve. Tërë përmbajtja e dasmës është shndërruar në cilësinë vendëse. Aktualisht dasmat organizohen nëpër shtëpia, por edhe nëpër sallone në qytet. Muzika, vallëzimi, mënyra e organizimit, është plotësisht e natyrës turke. Në Bafra, bie fjala, kalohej këmbë nëpër urën e lumit Kizyl Yrmak (krushqia, dhëndërrin dhe nusja), në mënyrë rituale për gjoja flakjen e magjive (bestytini).

Në dasmën e **Mustafa Güven-it**, nga familja e Dragushëve, i cili martohet me një vajzë nga Tirana (sepse dhëndërrin ishte duke punuar atje në kolegjin turk "**Turgut Ozal**"), autori pati rastin të jetë i ftuar dhe i pranishëm. Në të dominonte koloriti i përzier. Vërtetë vallëzimi, muzika me daulle ishte turke, porse ishte e pamundur që të mos mbretërojë edhe shqipja. Që nga ardhja, urimi, gjatë dasmës në biseda depërtonte shqipja gati e kulluar. Do të thotë tërë ajo e përvetësuar ende nuk ishte në gjendje të


gëlltisë në tërësi gjuhën e mëhershme e nëpërmjet saj edhe disa finesa jo aq të dukshme të dasmës shqiptare.

Pleqëria (pleqnimet) e burrave vazhdojnë edhe sot e gjithë ditën. Me rastin e ngatrrësive, të konflikteve, të vrasjeve, apo ndonjë ngjarje tjetër, tubohen burrat me autoritet dhe me influencë për rrethin, dhe shpeshherë i zvogëlojnë zgjerimet e konflikteve. Është interesant se tërë filozofia, qasjet, procedura, meselet, janë të bartura nga Kosova. Në ndërmjetësime të tilla, edhe të tjerët që nuk e kanë prejardhjen arnaut kryesisht ftohen shqiptarët. Në mjedisin e gjerë të Bafres për këto çështje ishin të njohur **haxhi Jashar Prebreza, haxhi Ahmet Sfarça** e të tjerë.

Elementet e folklorit ishin të mbetura vetëm në kujtesë. Më herët, disa dekada më radhë, këngët këndoheshin me çifteli. Përafërsisht deri në vitin 1960 nëpër dasma kumbonin këngët epike dhe lirike kosovare, përkatësisht të viseve shqiptare. Këtu përmenden këngëtarë të spikatur e në zë, siç ishin: **Ahmet Grabanica** (i biri i kryetrimt **Islam Grabanica**), i cili pati mundësi t'i këndojë edhe vargjet e rapsodit popullor për trimëritë e babait të vet e për të tjerët, madje me çifteli kënduan, po ashtu, **Rexhë Balltiqi, Emin Cernogori** (i cili këndon me kavall, përkatësisht i binte kavallit), **Bajram Seniku, Emin** dhe **Shukri Obrazhda** dhe **Hasan Dragobuzhda**. Këngëtarë të njohur ishin edhe **Shaban Babushi, Bajram Babushi, Emërllah Momçila, Vesel Berila** e të tjerë.

Mënyra e ceremonialit të **ngushëllimeve** po thuaj është e pandryshuar te shqiptarët. Koha e zgjatjes së ngushëllimeve për vdekje zgjatë afro 15 ditë. Në të njëjtën mënyrë, sikurse në Kosovë, bëhen pikëpjekje

dhe këmbehen fjalë, me qëllim të zvogëlimit të hidhërimit... Kjo mënyrë ngushëlluese dallon nga kombet e tjera që frymojnë në këtë Vilajet e më gjerë. Karriga para dere, si shenjë ku mbahen ngushëllimet, nuk vihet. Bie fjala, te turqit adetet, doket nuk janë si të shqiptarëve. Turqit nëse janë pjesëmarrës në funeral, nuk shkojnë më në ngushëllime. Lidhur me këtë tregohen raste karakteristike. Në një rast, kur shqiptarët shkojnë në ngushëllime te një turk, i zoti i shtëpisë i pyet: mos e keni ndonjë porosi (amanet) që keni ardhur, pasi që ju më parë ishit në përcjelljen e kufomës? Turku quhej Shani dhe i kishte vdekur djali. Shaniu shton dhe decidivisht iu thot: meqë keni qenë në funeral, nuk ka nevojë të vini më.



*Çast nga një përcjellje në Prishtinë (tetor, 1996).
Nipat: Hasani, Shabani, Enveri dhe stërmbesa Fitorja,
duke i dëshiruar rrugë të mbarë dajës Ahmet
për në vatrën e tij në Bafra.*

Dosido, në familjet shqiptare, **mikëpritja** ka mbetur si një virtyt i shenjtë. Kjo është bërë si doktrinë që nuk mund të shporret lehtë. Edhe të tjerët e dijnë këtë dimension të shqiptarëve kaq të rëndësishëm. Vështirë mund të konstatohet se në ç'mënyrë ka depërtuar te kombësitë joshqiptare, apo nuk ka depërtuar fare. Por, në këtë rrafsh, diç është e vërtetë: turqit nuk i duan shqiptarët, porse as nuk i urrejnë haptazi. Kjo sjellje mund të jetë kushtimisht një prej shkaqeve, që në mënyrë të ndërsjellë të përvetsohen gjërat nga njëri tjetri.

Për raportet në mes të kombeve, përkundër asaj se të gjithë së bashku e përbëjnë një komb të vetëm të përbashkët, për ndikimet reciproke e për ndikimet tjera janë në gjendje të dëshmojnë mjaft objektivisht të gjallët e moshuar. Hollë e hollë, turqit nuk u besojnë shqiptarëve, nuk i duan, ndonëse, faktikisht në mënyrë të dukshme as nuk i urrejnë. Së këndejmi, shqiptarët mund të kenë tretman të caktuar, por që në ato mjedise ku dominojnë të tjerët, shqiptarët e kanë vështirë të fitojnë votën, përkundër çfarëdo merite që mund ta kenë. Në përgjithësi, nuk ekziston ndonjë ndasi, edhe pse nuk mund të pajtohen me sjellje, ngase secili komb i ka specifikat e veta. Edhe po t'i zgjedhin, t'iu besojnë, t'i afrojnë, e kanë vështirë t'u bashkangjiten në doke dhe në disa karakteristika të tyre.

Nga ky aspekt edhe reciprociteti i kulturave dhe i trashëgimisë ndeshen dhe nuk e kanë forcën e shprehur. Secili komb, pra, edhe shqiptarët, ruajnë diçka të veten, pa marrë parasysh çfarë ndikimi ka mjedisi i afërt dhe rrethina e gjerë.

Në Bafra, në Samsun dhe në kuptim të gjerë, në të gjitha enklavat shqiptare në Turqi, tradita është e pranishme, varësisht nga intensiteti i kontakteve

që mbahen me "memleqetin", si dhe nga numri i pjesëtarëve shqiptarë, që jetojnë në afërsi të drejtpërdrejtë. Shihet qartë se ata që i mbajnë lidhjet dhe kontinuitetin e këmbimin e vizitave më të afërmit në Kosovë, traditën e kanë më të sforcuar dhe pa droje mund të thuhet se ende dominon, mbizotëron me rrethinën. Mirëpo, për ato familje që nuk kanë mundësi të kenë këtë privilegjë, ekzistojnë dy gradacione: një, nëse rrethina është e banuar kryesisht me shqiptarë, martesat janë bërë në mes veti, pa dyshim edhe tradita nuk e humbasë tretmanin e vet dhe, dy, kur nuk e kanë rrethinën me bashkëkombës të vet, gradacioni i traditës ka rënë në zero.

Kësisoj, tradita është e harruar. Këtë e kushtëzon në mënyrë të prerë gjuha dhe sjellja e përvetësuar ngutshëm nga ambienti që e rrethon. Me këtë mund të konkludohet se aq sa mbizotëron gjuha shqipe, aq do të mbizotërojë edhe tradita. Për një kohë të caktuar, edhe pas humbjes së gjuhës, tradita së paku në mënyrë latente do të jetë me pak gjë e pranishme, porse duke mos i dhënë rëndësi gjeneratat që ta ruajnë si diçka të të parëve të tyre.

15. EDHE ANEKDOTAT KANË DOMETHËNIE SHQIPTARE

*"Kam një lëmsh në zemër
S'kam kujt t'i rënkohem,
T'u rënkohem maleve,
Malet po largohen.
T'u rënkohem fushave,
Fushat zbukurohen.
T'u rënkohem çupave,
Çupat po martohen."*

Populllore

Shqiptarët kudo që janë, derisa komunikojnë shqip, me vete e kanë edhe bagazhin e përmbushur përplot me kallëzime, anekdota, përralla, frazeologjizma, këngë e tjerë, të sjella nga vendlindja e të parëve. Nëpërmjet bisedave pak më të gjata, nga goja e atyre që flasin shqip, ndonëse të moshuar, dëgjohen fjalë, mesele, anekdota, të njëjta, sikurse ato në Kosovë, apo në viset tjera shqiptare.

Është interesante se shumë elemente nga tradita kultivohen në mënyrë gati autentike. Frazeologjizmat janë të bartura kryesisht nga Kosova. Shtegtari i rastit që ndeshet në këtë mjedis, para se ta thotë ndonjë kallëzim, ndonjë mendim nga këndeja, atë e gjen atje. Prandaj, nuk është aspak e

çuditshme se thëni, tregimet paraprijnë dhe, si për çudi, thesari është i gjallë dhe i përmbushur nga "memleqeti".

Anekdotat sikur janë marrë me vete. Në të shumtën e rasteve ato shpjegohen nga vendlindja e të parëve, ose janë të natyrës shqiptare. Mirëpo, disa janë krijuar edhe në atë mjedis. Trimëria e shqiptarëve ka kushtëzuar thurje të anekdotave të ndryshme. Nëpër ato vise qarkullon, përveç tjerash edhe kjo anekdotë: Shqiptari shkon në xhami ditën e premtë për falje të namazit të xhumasë. Hoxha del në hytbe (foltore) dhe iu drejtohet të pranishmëve me predikim të caktuar. Numron pejgamberë të ndryshëm dhe i shpjegon disa nga veprat e tyre dhe cilës kombësi i përkasin. Përmend hazreti Musanë, hazreti Jakupin, hazreti Sulejmanin, hazreti Muhamedin a. s. e të tjerë, duke ua thënë edhe prejardhjen e tyre. Shqiptari në këtë spektër të emrave asgjekundi nuk gjen diç të vetin dhe mendohet se duhet të përfshihet herën tjetër. Me të dalë nga xhamia, i drejtohet imami: Hoxhë - thot, - pse nuk është asnjë pejgamber nga arnautët (shqiptarët)? Nuk përmende asgjë për farën e arnautit. Hoxha ia kthen: Nuk kanë pasur pejgamber shqiptarët. Shqiptari i drejtohet: Herën tjetër, të gjes diçka dhe të predikosh para xhematit.

Pas një jave ndodh e njëjta skenë. Hoxha e kryen ritualin, por pa i përmendur shqiptarët. Personi i njëjtë i drejtohet me të njëjtat fjalë dhe kërkesë, si para një jave. Dhe, me kërcënim pak më të theksuar e lë që për javën e tretë, të premtën të gjej dëshmi për këtë komb.

Të premtën që vjen qytetari shqiptar e merr mauzeren me vete dhe e vë në një qoshe të xhamisë. Fillon predikimi i "hydbes" dhe hoxha në radhitjen e rëndomtë të shenjtorëve dhe të pejgamberëve, e

gjen edhe një shqiptar, e emërton me një emër të caktuar dhe tregon se i përket kombit shqiptar.

Përnjëherë dikush nga publiku reagon zëshëm: Hoxhë, - i thot, - e ke gabim. Përmirësoje gabimin. Hoxha i përgjigjet: Gabimin e korrigjoj kur nga qoshja (këndi) të hiqet mauzerja, që po më mëson.

Këtë anekdotë, përveç shqiptarëve, e shpjegojnë edhe të tjerët. Ka të thurura edhe të tjera, herë herë të shndërruara gati në mite për trimërinë e shqiptarëve.

Në një rast tjetër, tubohen pjesëtarë të kombeve të ndryshme. Shqiptari gëzon një reputacion të dukshëm. Për të fliten fjalët më të zgjedhura, duke e quajtur njeri të besës, të drejtë dhe punëtor. Secili në njëfarë mënyre shpreh fjalë miradije. më në fund njëri thot: Unë ia di një të metë. Për këtë të gjithë mendojnë, ku do të dalë problemi. Folësi përfundon: ndër të gjitha të metat më e keqja është se i përket rrënjës së shqiptarit.

Ja edhe një anekdotë tjetër. Dy turq bien në konflikt për ndarjen e tokës. Njëri që ishte më i vjetër (65 vjeç) e kishte tapinë e tokës. Ndërsa, tjetri, më i riu (30 vjeç), i cili lakmonte t'ia merrte një pjesë të tokës në mezhde, ngulte këmbë për të drejtën që i takonte. Deklaronte me forcë se e ka tapinë edhe ai. Caktohet seanca gjyqësore dhe për dëshmitarë ftohet Hasan Dragobuzhda, shqiptar. Në seancën gjyqësore të dy palët në konflikt e mbanin nga një tapi në dorë. Si duket ky më i riu kishte gjetur ndonjë lidhje për të siguruar një lloj dokumenti. Dëshmitari, duke iu drejtuar të riut ia bën vetëm këtë pyetje: "Tapia sa vjeçe është? T'i 30 vjeçe tapia e kujt është?" Turku lakmitar bie në kurth dhe thot: Hm! ja shejtan, ja evlija! S'e ku po e din!... dhe kështu, zgjidhet konflikti në të mirë të poseduesit të tapisë.

Mund të dëgjohen shaka episodike të mbar-tura, por edhe të lindura atje. Xha Ibrahim, edhe pse nuk i favorizon duhanxhinjtë, e përfolë sentencën e të parëve, duke pasur kujdes që të mos merret ndryshe përveç si një e folme e moçme e që e ka këtë përmbajtje: "burri pa kamish si qeni pa bisht". Ka edhe aforizma të ndryshme, të cilat e mbulojnë tërë spektrin e fushave të jetës. Treguesit e aforizmave dhe të barcoletave nuk ia sheh kush për të madhe, porse ndiejnë kënaqësi me spirituizitetin e tij në atë moshë (88 vjeçare).

Duke u mbështetur në interesimin për punë, ngacmohen përtacët. Për ta është e thurur anekdota, për "të tri mëngjeset". Thonë se ekzistojnë tri mëngjese: 1. mëngjesi i parë është për ata që zgjohen për të falur namazin e sabahit; 2. mëngjesi i dytë ka të bëjë për shtresën që zgjohet për të ngrënë dhe, 3. mëngjesi i tretë është i njerëzve që zgjohen vonë, në ora 9-10 e tutje. Sipas këtij klasifikimi rangohen njerëzit e punës, të punës dhe të fesë dhe përtacët, që këta të fundit nuk janë aq konsekuent për asnjërin grup.

Shpjegohen, përfolën edhe shumë anekdota. Shqiptarët gjatë rrugëtimit për në Turqi, hasin në peripeci të shumëllojshme, duke mbetur nga tre muaj rresht në anije, derisa iu lejohej hyrja në tokat turke. Në një moment, në pritje e sipër, njëri del për të blerë ndonjë gjë. Sheh leblebia në treg, porse nuk i di ç'janë ato dhe i blenë një gjysmë thesi në vend të misrit. Emrin e kishte dëgjuar leblebia, por që më shumë mendonte në kokrra të misrit. Kur anëtarët e familjes në anije e pyesin çka ka blerë, ai iu përgjigjet: leblebija-kollomboq, leblebija-kollomboq.

Një tjetër gjen purri dhe i blenë një sasi të konsiderueshme, për të gatuar purrinik (pite me

purri). Kur i çon në anije e kupton se aty nuk ka ku të gatuhet dhe ku të piqet pitja.

Realitetet tashmë janë shndërruar në përralla, anekdota. Natyrisht, është e kuptueshme për ndodhitë e natyrave të ndryshme. Këso ndodhish kanë të bëjnë me llojet e ushqimeve, përgatitjen, konsumin e tjerë. Logjika e nivelit të zhvillimit sjellë qasje dhe momente që shpeshëherë janë në harmoni, ose përkundrazi, bien ndesh me kohën.

Për t'u veçuar janë edhe ruajtja e disa vargjeve të këngëve folklorike, të cilat nuk janë të zhdukura krejtësisht. Mund të dëgjohen dhe të shënohen vargje të "Çanakalasë", si bie fjala: **"Në Çanakala mbrenda/ Topi po kërset/ Gjylja bie në det/ Zallin po ia qet/ Për t'ritë tonë medet..."**

Janë ruajtur në kujtesë vargje edhe të Oso Kukës. **Haxhi Hashim Dragusha**, hoxhë, i moshës 70-vjeçare, i lindur në Turqi, është në gjendje t'i recitojë këto vargje:

"Po ta jap besën e Zotit

Pa u djeg unë n'flakë t'barutit

S'ka me u djeg për t'gjallë Vranina

S'ka me u djeg për t'gjallë Shipnija..." etj.

Njëkohësisht, këngët e dasmave kanë ngelur aty këtu si raritete të rralla. Nga individët ka mundësi të dëgjohet kënga **"Dy lule i ka vasha"** e përcjellur nga pleqtë. A. Sfarça 65 vjeçar, i lindur në Turqi (në Tekekojy), i reciton fund e krye vargjet: **"Ke nja u ban dy/ Dy lule i ka vasha/Ken dy u ban tri/ Tri kambë perushlia** (stoli, shkëmbi trekëndësh) **/Dy lule i ka vasha/Vasha ka bylbylin/ Që këndon malit/. Ken tri u ban katër/ Katër kambë i ka dhija/ Tri kam perushlija**, pastaj refreni; **Dy lule i ka vasha...** Madje vazhdohet: **Ken pesë u ban gjashtë/**

Gjashtë muej gjysë motmoti/ Pesë gishta i ka dora... deri te refreni i njëjtë (**dy lule i ka vasha**). Vazhdohet: **Ken gjashtë u ban shtatë/ Gjashtë muaj delmja kingjin/ Ken shtatë u ban tetë/ Tetë muaj lopa viçin...** e tjerë. I përmenduri e reciton deri në fund, deri në radhitjen e dymbëdhjetë dhe tregon se këtë këngë e kishte mësuar nga i ati, i cili ishte i lindur në Kosovë dhe këtë e këndonte shpeshëherë.

Arsenali në fjalë, në spektrin e shtrirjes së gjerë, është gjithnjë në reduktim e sipër. Anekdotat, këngët, frazeologjizmat, sjelljet rreth rregullave të pleqnarëve, të burrërisë, janë kolorit origjinal, të gjuhës së të parëve dhe të atyre që atë e artikulojnë sot e kësaj dite. Mirëpo, sikurse edhe në mjediset tjera, madje edhe te ne, në ambientin kosovar, moda, gjërat bashkëkohore, inovacionet në të gjitha fushat, fitojnë dimensione të reja, i zëvendësojnë ato që kanë qenë. Formohet një fond tjetër i sjelljeve dhe i reagimeve bashkëkohore në çdo mjedis. Në mjedisin që është temë trajtimi, thërmiat e ambientit depërtojnë dhe shpërndahen me intensitete më të mëdha. Kësisoj, gjeneratat e reja, ato të cilat ende e flasin shqipen dhe ato më të rejat, të cilat kësaj gjuhe ia kanë dhënë lamtumirën, nuk pikëpjekën fare me traditën. Për ta është çështje e rëndomtë dhe jo interesante, kur i dëgjojnë nga më të vjetrit, prindërit apo nga të tjerët. Faktikisht nuk ngjallin asociacione, as kurreshtje. Fundja, edhe këto finesa duhet të mirren plotësisht të kuptueshme, ngase ambienti ku janë lindur dhe jetojnë është shumë më aktiv, depërtues dhe gjërat burimore nga ato mjedise janë më të kapshme dhe më tërheqëse.


Edhe ato që tash artikulojnë gjenden në cepin e perëndimit. Deri në vitet e gjashtëdhjeta nëpër vatrën e këtyre familjeve jehonte melosi epik shqip-



Në brigjet e Detit të Zi (Gezle, gusht 1997)

tar, instrumenti i çiftelisë, bile edhe veshja kombëtare. Këto elemente gjatë dekadave të fundit i përkasin lashtësisë.

Prandaj, një gurrë e përhapur, shterret dita më ditë. Po të mos i gjendet ndonjë zgjedhje konzervante, e që është shumë vështirë të gjendet, së paku sa për t'u shënuar dhe vënë në spikamë një pjesë e së vërtetës sonë, të gjitha këto, gjithë ky thesar shumë shpejtë mund të quhet i pa besueshëm, i paqenë. Kur bëhet fjalë për një enklavë, kuptohet se ilustrimi ka pjesëmarrje më të vogël në madhësinë e enklavave të tërësishme. Realiteti fitohet nëse përfshihen të gjitha enklavat në Turqi, por jo vetëm në këtë shtet. E tërë kjo mund të përfundohet me pyetjen: për kë bie këmbana? Shqiptarët, kudo që janë, i pret po ky fat. Çdokush që mund të vendos, le të vendos vet për ardhmërinë.



Detaje nga pasaporti i vitit 1925

16. ÇKA KA MBETUR NGA SHQIPTARËT E VILAJETIT TË SAMSUNIT

"Posa të pajtohen për shpërngulje duhet për çdo gjë t'iu dilet në ndihmë. T'i tërhiqet vërejtja administratës, të paguhet shpejt pasuria, të jepet dokumentacioni i udhëtimit pa kurrëfarë formalitetesh, të ndihmohen deri sa të arrijnë te stacioni i parë hekurudhor, t'iu lehen në dispozicion mjetet transportuese deri në Selanik prej ku me anije të dërgohen në Azi. Është me rëndësi të madhe që shkuarja të jetë e lehtë, e përshtatshme dhe e lirë (me shpenzime sa më të vogla - v. AJ). Brenda mundësive udhëtimi me tren të jetë gratis, të ndihmohen po ashtu me ushqim, sepse nga kjo varet shumë a do të shpërngulen masovikisht apo jo. Frika nga vështirësitë e rrugëtimit do të jetë pengesë kryesore në lëvizjen e tyre dhe për këtë shkak duhet ajo të flakët, duke zgjidhur në mënyrë energjike tërë çështjen rreth transportimit të tyre. Posaçërisht duhet të kihet parasysh që ata të kenë sa më pak punë rreth udhëtimit, sepse njeriu i thjeshtë e ka vështirë të gjendet dhe shi për këtë duhet që çështja e sistemit dhe e punëtorëve të transportit të analizohet mirë nëpërmjet argjenturave të mëdha dhe të zbatohet. I shëprnguluri duhet të shkojë nga dora në dorë, pa e hetuar peshën e ecurisë së vet.

Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet lumi i shpërnguljes së arnautëve, i cili do të zbrazë këtë jug nga arnautët (shqiptarët - v. AJ).

*Vasa Çubrilloviq
(pjesë nga referati për
shpërnguljen e shqiptarëve, 1937)*

Shqiptarët që jetojnë në Vilajetin e Samsunit janë vetëm një pjesë e popullsisë me këtë origjinë kundrejt numrit të tërësishëm të arnautëve. Sa është ky numër, nuk dihet saktë. Saktësia është relative për Vilajetin në fjalë, por edhe për mbarë shtetin. Shifrat më tepër mund të jenë supozime, se sa realitet. Regjistrimi i popullsisë nuk shënon prejardhjen e popujve, përveç, të gjithë si një e përbëjnë kombin turk. Shënohet në rubrikë të veçantë gjuha që e njohin dhe e flasin, ose ndonjë gjuhë tjetër përveç turqishtes. Edhe me këtë nuk mund të identifikohet tërë madhësia e numrit të shqiptarëve, pasi që dihet se pjesa dërrmuese më nuk e flasin këtë gjuhë, pra, gjuhën shqipe.

Nga thesari që shqiptarët dikur e patën pronësi të veten, thuajse janë tjetërsuar. Kjo pronësi është zëvendësuar me diçka tjetër, me tiparet, sjelljet, karakteristikat, që i imponon mjedisi. Vërtetë, mjedisi vepron në mënyrë memece, pa ndonjë imponim, por që vetvetiu gravitacioni i tij është më i madh dhe sikurse planetet më të vogla që sillen rreth planeteve më të mëdha në gjithësi, në kosmos, edhe këtu mjedisi e bën të veten: gërmon, gërmon dhe vetëm gërmon.

Te shqiptarët e Vilajetit të Samsunit kanë ngelur ende gjëra nga e kaluara. Një prej simboleve që e identifikon këtë komb është gjuha. Ajo, pak a shumë, flitet në të gjitha vendbanimet ku gjenden

shqiptarët. Gjeneratat e lindura nga prindërit që kanë shkuar nga Kosova e shijojnë ëmbël gjuhën e prindërve të tyre, pa marrë parasysh a i kanë të gjallë ata, apo që herët u kanë vdekur. Pra, dy gjenerata të lindura në Turqi e artikulojnë gjuhën e prindërve, përkatësisht të gjyshërve të tyre. Ndërkaq, gjenerata e tretë, e të lindurve atje, në Turqi, stërnipat dhe stërmbesat, sa i përket gjuhës nuk ecin në të njëjtit binarë, d.m.th., nuk hapërojnë sikurse prindërit dhe gjyshërit e tyre. Plotësisht e kanë të përvetësuar gjuhën e shtetit, gjuhën turke. Ndryshe nuk mund ta kuptojnë atë, përveç si të veten. Kjo është, pra, një realitet që shijohet dhe vërehet sot në këto mjedise.

Me këtë nënkuptohet se ajo që ka mbetur, gjithnjë e më tepër zvetënohet, që së shpejti mund të quhet e harruar, e huaj. Në ato mjedise ku janë shqiptarët, por rrethinën e kanë më indikative, ose më herët kanë pranuar t'i përziejnë martesat, situata ka evoluar më shpejtë. Në këtë bilanc të humbjes dhe të mbetjes kanë ndikuar shumë faktorë, të cilët e kanë emruesin e përbashkët të emërtuar rrethina e vendit ku janë përcaktuar të jetojnë.

Edhe në këto kushte nuk është gjithkund njësoj. Ka raste dhe dukuri të tëra, të ndjekura me keqardhje dhe me indinjatë. njerëzit më të moshuar tregojnë me fakte se deri në vitet e gjashtëdhjeta e kanë ruajtur me dinjitet gjuhën dhe traditën, çdo gjë shqiptare, sepse ishte më e afërta dhe më e për-qafuara për ta. Ndërrimi i vendbanimeve bëhej, përveç motiveve tjera të natyrës materiale, edhe për shkak të gjetjes së oazave më të gjera të përmbushura me shqiptarë, ku do t'i bënin martesat në mes veti. Këto rrëfime, vërtetë, janë të argumentuara, sepse nuk ka pothuaj fshat apo qytet ku gjenden shqiptarët e në mes tyre të mos ketë ndonjë lidhje, qoftë të

farefisnisë apo të krushqisë. Mirëpo, rrethi vjen e ngushtohet. Shtimi i popullsisë dhe adaptimi gradual bëhen dy pengesa kryesore për të ruajtur atë që duhet ruajtur. Me shtimin e të rinjëve, të femrave dhe të meshkujve, vështirësohet fejesa dhe martesat e tyre. Prandaj kur nuk ka zgjidhje, drejtohen edhe te kombet tjera, miqësohen me ta, marrin dhe japin. Është ky një proces, i cili ndikon në zhdukjen dhe shpërbërjen e asaj që me dekada të tëra ishte qenësore. Këtij fakti i ndihmon edhe elementi i adaptimit, që do të thotë se gjeneratat e reja nuk lodhen shumë, ose aspak të bëjnë diferencime në këtë drejtim.

Në suazat e realitetit të hidhur gjenden raste që mund të quhen edhe kuriozitete. Ka pasur, por ka edhe sot individë që ende nuk e kanë mësuar gjuhën turke. Kjo ngjanë më tepër te bota femërore. Për shkaqe të caktuara, siç është kalimi i kohës më të gjatë brenda oborrit të shtëpisë, mosinteresi, e mund të mendohet çkado tjetër, sikur ishin pengesë e përvetësimit të gjuhës turke. Në këtë kontekst, mund të haset në emra të sotit, tek plakat e moshës 60-70-vjeçare të lindura e të rritura nëpër katundet e Bafres, ose në Bafër, por që e dijnë dhe e flasin vetëm shqipen. Bie fjala, **Bahtije Buçinca - Gimolli** (70-vjeçare) nuk e flet gjuhën turke. Madje këtij vargu i rreshtohen **Hamide Mavriqi-Zhinipotoku**, **Naxhije Reçica-Zhinipotoku**, **Emine Zhinipotoku**, e reja e **Imer Dragushës**, **Fatime Orllani-Reçica** e tjerë. Ka edhe të tjera që e dijnë vetëm shqipen. Disa kanë qenë në haxhillëk dhe e kishin vështirë të kuptoheshin, ngase nuk e njihnin gjuhën e shtetit. Kishte raste që derisa janë bërë nuse, nuk e kanë njohur fare gjuhën turke, porse në shtëpinë e burrit janë detyruar ta mësojnë.

Te gjinia mashkullore gjendja është pak më ndryshe. Për shkak të lëvizjeve më të shpeshta, nevojave për të kryer punë, kontaktet e shpeshta me rrethin e gjerë, u kanë mundur njohjen dhe komunikimin në gjuhën turke. Rastet e mësipërme, ose më mirë të thuhet, ruajtja e deritashme e gjuhës shqipe vështirë se do të ketë jetë të gjatë. Një bashkëfolës, **Ramazan Baca - Ungju**, (73 vjeç) sqaron shumë detaje për përzierjet gjithnjë më intensive dhe më të theksuara. Jemi përzier me jerlitë - thotë. Kështu e kemi humbur gjuhën e nënës. Ai mendon se shqipja edhe pësëdhjetë vjet do të shuhet. Pa dyshim, ka të drejtë. Kur të krahasohet mosha dhe shekulli i jetesës, të atyre që e kanë gjuhë amëtare, ose të njohur shqipen, gjithësesi edhe kaq mund të pritët. Ndoshta edhe më pak.

Nëpërmjet gjurmimeve, sado shkarazi, mund të venerohet një dukuri, që është çdokund e pranishme. Me përjashtime të vogla, njerëzit e shkolluar nuk dijnë të flasin shqip. Ata prezantohen se janë arnaut dhe këtë fakt aspak nuk e mohojnë. Mirëpo, sa i përket çështjes së harrimit, përkatësisht të mos mësuarjes së gjuhës shqipe, as që i fërkon ndonjë brerje e ndërgjegjes. Mësimi në shkollë në gjuhën turke, leksiku, historia, arti, profesioni përkatës ia kanë vënë velin e ndasisë ndaj gjuhës, të cilën ende e flasin prindërit e tyre. Natyrisht, dominimi i shkollës është më i madh se sa i familjes. Fundja, edhe familjet aktualisht nuk shprehin shqetësim për zhdukjen e shqipes. Janë të orientuar fillimisht që të jetojnë, me të gjitha konditat e rrethinës, të ambientit të cilin e kanë parapëlqyer.

Bota intelektuale, me një fond të vogël të anëtarëve, kundrejt masës së popullsisë shqiptare, megjihatë është e formësuar. Në këtë rrafsh ka emra

të njohur nëpër lëmenj të ndryshëm. Të bijtë e **haxhi Ibrahim Ungju** janë të shkolluar. Nipi i tij **Hakan Ungju** është kirurg vaskular, i njohur edhe në institucionet amerikane. Është docent në Fakultetin e Mjekësisë në Manisa. Njëkohësisht, i vëllai i Hakanit **Gurkan Ungju** është mjek, doktor i shkencave të mjekësisë së gjinekologjisë dhe docent në fakultetin e Mjekësisë në Bursë. Djali tjetër i **Ibrahimit, Günen** është inxhinier i elektroteknikës. Këta të tre nuk e njohin shqipen, ndërsa **Mehmeti**, me profesion jurist (70-vjeçar) e flet gjuhën shqipe pa farë pengese.

Të shkolluar me origjinë shqiptare ka emra të njohur. **Ali Bylbyli** (i familjes Bellopoja) në Tekekëjy është inxhinier i kimisë dhe punon në fabrikën e bakrit pelister në Tekekëjy, në brigjet e Detit të Zi. **Mustafa Güven** (i familjes Dragusha) gjendet zëvendës drejtor në kolegjin "**Turgut Ozal**" në Tiranë. Nga radhët e shqiptarëve ka emra që janë gjykatës, oftamologë, hoxhallarë të njohur, prijës të fesë islame e tjerë. Sidoqoftë, në krahasim me numrin simbolik, sikur një numër i intelektualëve kanë nxituar në harresën e gjuhës shqipe.

Sipas përshtypjeve të përcipta, vrojtimeve më tepër të rastësishme, mund të thuhet se Turqia në përgjithësi është duke lënguar nga niveli i ulët i shkollimit. Si duket pengesë për këtë çështje ka qenë edhe bindja e popullatës, për të zhvilluar çfarëdo biznesi sa për të siguruar së paku ekzistencën elementare. Nuk kanë përcaktime për shkollim, aq sa kanë angazhime për të punuar tokën dhe ushtrimin e biznesit të vogël, deri te ato më të mëdhatë. Mirëpo, përkundër hapave të dukshëm të zhvillimit ekonomik të Turqisë, një ngecje e tillë do të jetë bumerang për shtetin që do t'i kushtojë shtrenjtë. Këtë realitet tash edhe shqiptarët e kanë gjithnjë e

më të qartë, por pa pritur ndonjë kthesë të madhe në drejtim të kthimit të ndjenjës kombëtare për kombësinë që e patën dikur. Natyrisht, për kombin e natyralizuar janë plotësisht të devotshëm dhe, pa dyshim mbrojtësit më të denjë (sipas participimit që e kanë në tërë vendin). Me këto premisa për çdo eventualitet, arnautët kanë për të qenë më të daluarit.

Shqiptarët gjenden para sinjalit të kuq. Sa i përket ruajtjes së thesarit kombëtar, udhëkryqi është tejkaluar. Mund të ndodhë që te një numër shumë i kufizuar të jetë e pranishme ndjenja dhe interesimi për një të qenë, për një realitet të dikurshëm. Realiteti i tashëm është më i fortë se i djeshmi. Në njëfarë dore edhe atëherë ishte më i fortë, më i fuqishëm, më tërheqës. Dhe, gravitacioni i tillë e bëri të veten. Në këtë punim nuk vlen pretendimi për vlerësimin e mbrojtjes, as të sulmit. Gjërat kanë ngjarë dhe aktualisht çdo gjë është e vonë.

Është e udhës të vrojtohen momentet e reja dhe ato të vihen në peshojë. Gjendja e një popullate të tërë është provë e patjetërsueshme, që shpjegon qartë se çka mund të ngjajë në mjedise e vende të huaja. Kjo që flitet këtyre ditëve, për numrin e azilkërkuesëve në shtetet e Perëndimit, që si duket, ka arritur në 500-600 mijë (të dhëna më tepër paushalle se sa të verifikuara), trumpetojnë dhëmbshëm dhe si të tilla duhet të kumbojnë aq zëshëm, deri në hapjen e veshëve, për çka imponohet nevoja për shërim të mundshëm. Shërim në kohë dhe në hapësirë. Shumë shpejtë për shumëçka mund të jetë vonë. Enklavat që tashmë janë provat më relevante mund të shërbejnë si pasqyrë, nga e cila duhet të meditohet kthjellët se ç'po ngjanë me ne.

Nga tërë ky arsenal i koklavitjeve dhe i

tragjedive specifike, të një zhdukjeje fizike, pa luftë, mund të shtrohet një, apo shumë pyetje anakronike, që dëgjohen nga ndokush për gjoja ku do të jetonte gjithë kjo popullatë. Këtë mund ta meditojë ndokush vetëm nga shkaku se e ka të harruar faktin se: mosikja e kontigjenteve kaq të mëdha, do të bënte të mundshme ruajtjen e asaj që është tash, si dhe zgjerimin në ato pjesë të humbura dje. Trojet tona mund të ruhen nga ne dhe, nga askush tjetër.

17. Ç'KA TË PËRBASHKËT TURQIA ME SHETETET E EVROPËS PËR FATIN E SHQIPTARËVE

*"Gjermani, maj, kjo sh mallku',
Djelt e ri naj ke paku',
Ti pej nesh, maj, na i ke da,
Po na merr malli, m'u pa!
Po harrojnë, maj, pleq e t'ri,
Po harrojnë, maj, gra e fmi!
U kanë hy veç markat n'kry',
Gjermaneshat' u rrinë përbri.
Rrallë na vinë, por fart zotni;
Markat s't'bajnë insan njimend,
Xhepin plot, por kryet pa mend."*

Popullore

Është kjo temë e gjerë, e karakterit analitiko-analogjik, krahasues në mes dy ambienteve në kupimin e kaheve të kundërta: Orient-Perëndim. Mbase për shkaqe të pozitës, apo të ndonjë arsyeje tjetër, këto dy tërësi mjedisin e kanë me diçka të përbashkët: forcën absorbuese të shqiptarëve (por edhe të të tjerëve). S'do të ketë vend thellimi dhe zgjerimi i analitikës, në cilësinë e dhënies së përgjegjës në pyetjet: a janë shqiptarët të interesuar të konsolidojnë vendin e vet, të realizojnë bashkimin

ose ribashkimin kombëtar, të qeverisin vet, të jenë sovran dhe të zhvilluar, të barabartë së paku sa të tjerët, apo, në të kundërtën, të jenë të prirur e të prejnë degën, në të cilën qëndrojnë vertikalisht dhe në çfarëdo pozite tjetër.

Pa dhënë përgjigje, për çka nevojiten përpjekje dhe mund i madh, mund të sillen vërdallë arsyetimet sofistike, pacifike, aso që të shtijnë në gjynah, duke i vënë nën akcent, sidomos pushtuesit, sunduesit, njerëzit e armiqësuar e gllabërues të rrethinës. Dhe, në këtë kontekst, çka sjellin ajmet, lypësia? Natyrisht, asgjë, përveç mjerimit, nënshtrimit të mendjes, të ruajtur në kafkë, në një mbrojtje që s' duket e që në atë fole zihet gjithëçka.

Eklatante dhe e paskrupullt është çështja e shqiptarëve. Kudo që janë, në atdheun e formuar e të përgjysmuar, në viset e okupuara dhe në diasporë. Shteti shqiptar i 1912 më tepër është i shënuar për kriza dhe konflikte të brendshme, se sa për ndonjë zhvillim tjetër. Ky shtet më tepër ishte grindavec i vetvetes, se sa forcë motorike, fuqi propullzive për ndihmë prijtare për çlirimin e tokave të veta, popullin e vet, të mbetur nën zgjedhën e huaj, përreth të gjithë kufijve, anekënd gjatësisë së tyre. Rrallëkund mund të ngjajë që shteti të mos i kërkojë edhe viset tjera, të humbura, të okupuara nga tjetër kush. Humbja nuk është e karakterit të shitjes, apo e ndonjë koncesioni të nënshkruar. Ajo është bërë me dhunë kur janë copëtuar tokat dhe kombi dhe më pastaj janë shkapërderdhur në masë të madhe nëpër botë. Shteti shqiptar, për fat të keq, prej themelimit e kënde, në të gjitha periudhat merret me vetveten dhe, si shtet skamnor, i prapambetur, i pazhvilluar, nuk është në gjendje të ngrit zërin, të

implementohet, të bëjë gjithë atë që duhet bërë, siç veprojnë shtetet e tjera dhe popujt e civilizuar.

Me një impotencë shurdhëmemece sikur janë të kënaqur me atë rriskë, rrip toke dhe nuk çajnë kokën për atë që është vitale, me rëndësi shumëdimensionale. Në vend që të gjejë modele, strategji të zhvillimit të shpejtuar, për çka ekzistojnë disa resurse të natyrës, hyhet nëpër labirinte sistimore, ideore, të paqëlluara, me koncepte të degraduara dhe anakronike. Periudha e pasformimit, deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, ishte skenë e përmbushur me sulme nga jashtë, por edhe arenë e konflikteve të brendshme, të krahinarizmave, të formimit të qeverive krahinore, të klikave, fisnore e tjerë.

Në vitet e njëzeta e deri në okupimin nga Italia fashiste (1939) orvatjet për stabilizimin e shtetit, të një shteti modern e të zhvilluar, shpiejnë vetëm deri në nivelin e shteteve më të pazhvilluara të Evropës.

Epoka e komunizmit dhe e autarkisë krijon oazë të re mjerimi, me një përmbyllje hermetike e të çuditshme, me ngecje në zhvillimin ekonomik e shoqëror, me shtresim të prapshtë ideologjik. Edhe kur hapet kjo guacë, kur shkapërderdhet, sikur mbetet sërish një hapësirë e qërimit të hesapeve ndërmjet rivaliteteve të krijuara dekada me radhë, me attribute sërish të krahinarizmave, të veriut e të jugut, të botëkuptimeve të tejkaluara të tipit toskë e gegë e të ngjashme.

Në këtë lojë kolovajze marramendëse, jo vetëm që nuk krijohen kushtet për forcimin dhe avancimin e shtetit, por, përkundrazi, bëhen gabim pas gabimi dhe popullata e një trangu, e ndarë administrativisht, në mënyrë arbitrare, nëpërmjet forcës së tytave të zjarra, të barotit, përballet me barriera gjithnjë e më të thella. Me këtë nuk do të thotë që

popullata jashtë kufirit të rrijë duarkryq dhe të presë ndihmë ekskluzivisht nga shteti i përgjysmuar e nga të tjerët, por veçanërisht kjo duhet të jetë e gatshme dhe të gjejë metoda të çfarëdo forme, të mundësojë shpurjen e lëvizjes përpara të çështjes jetike.

Konceptet e të dy segmenteve janë të gabuara. Një prej gabimeve është se nuk ndërtohet strategji e njëmendët, e përbashkët. Më tepër kalohet nëpër disa qasje parciais, me shfaqje të aspiratave në mënyrë orale. Madje as ky aspekt nuk përpunohet sa duhet, nuk përmbushet me literaturë përkatëse, me argumente të përpunuara, të thelluara, asosh që e përbëjnë realitetin, realitetin faktik dhe asgjë tjetër.

Shqiptarët, dje edhe sot, sikur e kanë zgjedhur rrugën më të lehtë dhe, njëkohësisht, rrugën më tragjike. E lehta, përveç me attribute tjera, kurorëzohet me ikje të paskrupulltë nga vatrata e veta shekullore, ndërsa tragjikja shihet më vonë, në fazën e passhkuarjes, përkatësisht të asimilimit të pjesërishtëm, apo të plotë kombëtar. Në këtë rast, formula e lehtë, nuk mund ta ketë kuptimin e lehtësisë, por të tragjikës, prandaj, sintagma e ashtuquajtur e lehtë, faktikisht e ka domethënien e parahyrjes në tragjikën totale, të përgjithmonshme.

Në observimet e kësaj teme, sa të ndërlikuar dhe të dhimbshme, aq pikante në kahun e zhdukjes graduale të këtij populli, mund të vëhen në paralelizma shumë e shumë mjedise, ndonëse për shkak të pamundësisë, mund të ndahen në dy tërësi të veçuara e të theksuara me karakteristika të caktuara. Është fjala për Turqinë dhe shtetet e Evropës Perëndimore, shtete këto, në të cilat shqiptarët më së shumti ia mësyen dhe gjetën strehim. Do të ishte e logjikshme të vëhen përballë njëra tjetrës, bie fjala

Turqia dhe Gjermania dhe të gjendet përgjegjja e mundshme në pyetjen: Ç'kanë të përbashkët këto dy shtete, në zgjidhjen e çështjes, të fatit të shqiptarëve. Përgjegjja nuk është e lidhur me autoritetet, forcën politike e diplomatike, ushtarake, që i kanë këto, por ajo ka të bëjë me cilësinë e strehuesit për këtë popull të përndjekur.

Në këtë kontekst, është i natyrshëm kthimi prapa, për të vënë në kontakt të përbashkët të djeshmen dhe të sotmen. Dje e deri sot Turqia iu gjeti strehim më se pesë milion shqiptarëve, ose përafërsisht kaq, më pak apo më tepër. Gjermania dhe shtetet tjera Perëndimore aktualisht janë të përmbushur me numrin më të madh të pjesëtarëve të këtij kombi. Duke i njohur karakteristikat zhvillimore, kulturore dhe specifika tjera të secilit shtet, mund të tërhiqen tangjente të shumta, por që gjithnjë nuk pikëtakohen në mes veti. Megjithatë, para se të zërthehet problemi, duhet të kihet parasysh se përfundimi është i njëjtë dhe emërtohet me një term të përbashkët, që quhet asimilim. Natyrisht, të ikurve nga vendi i vet, muhaxherëve, Turqia nuk iu krijoi kushte strehuese, që ata atje të formojnë shtet të shqiptarëve. Këtë më së paku e bën Gjermania ose çfarëdo shteti tjetër, sikundër nuk do ta bënte asnjë shtet në botë. Turqia me të gjitha kushtet që i kishte, me vlimit politike, me konceptet afatgjata, i gllabëron jo vetëm në pikëpamje numerike, por edhe në atë shpirtërore, të lojalitetit dhe të besnikërisë, të nivelit më të lartë. Feja e njëjtë (islame) me popullatën e pranuar në gjirin e vet, pa dyshim, ishte katalizator i përbashkimit dhe i shkrirjes më të shpejtë. Edhe rrethanat tjera, kulturore, të modeleve, mënyrave të jetesës të tipit oriental, të cilat ishin kultivuar më se pesë shekuj në mjedisin

prej nga kishte ardhur kjo popullatë, e bëjnë të veten. Dosido, problemin duhet shtruar në mënyrë eksplicite: Shkuarja nuk është bërë të mbijetohet kombi, të begatohet mirëqenia autentike materiale, kulturore dhe kombëtare, por më tepër të ruhet tërësia fizike, religjioni, ekzistenca dhe perspektiva, e shndërruar në një qenie tjetër kombëtare.

Sa i përket ndonjë shteti tjetër, p.sh. Gjermanisë, me kushte dhe specifika plotësisht tjera kundrejt Turqisë, çfarë konkluzionesh mund të priten. Kur është fjala për Gjermaninë, duhet kuptuar edhe shtetet tjera të Evropës Perëndimore, ku shqiptarët, një pjesë e dukshme e tyre, natë e ditë kërkojnë strehim. Dhe, para se të shtrohet problemi rreth kësaj çështjeje, është e nevojshme të bëhen disa krahasime, të cilat e ilustrjnë, e vejnë në spikamë realitetin. Gjermania, shtetet Skandinave, ato të Beneluksit, Zvicra, Anglia e Austria e të tjera, dihet kanë arritur nivel të lartë të zhvillimit ekonomik dhe kulturor. Mirëqenia e tyre jetësore, shoqërore, është fascinuese jo vetëm për shqiptarët, por edhe për kombet tjera. Aty shqiptarët ndeshen me gjëra, të cilat nuk kanë pasur mundësi as t'i ëndërrojnë. Derisa në Turqi, shkuarja e tyre mund të quhet e rëndomtë, sepse pak gjëra ose fare mund t'i ndeshin si spektakulare, në shtetet e Perëndimit është ky fenomen i pranishëm në çdo hap. Derisa në Turqi, për t'u zhveshur nga elementi kombëtar, ka ndikuar feja, a është e mundur që "fusha magnetike" kaq e fortë e të arriturave të mos ndikojë në jetën e përditshme të shqiptarëve në vendet e Perëndimit.

Refugjatët në vendet e Perëndimit, që në start kanë tretman tjetër. Ata shkojnë për arsye të caktuara. Shkojnë për shkaqe politike, të sigurisë dhe ekonomike. Po ashtu, një numër jo i vogël shkojnë

për të jetuar më mirë, për t'i ikur klimës së përditshme të nderë, të rëndë nga reprezaliet e pushtetmbajtësve të tërbuar. Ata me njëfarë elani euforik të çuditshëm, përshëndeten me shprehjen: Mirë u pafshim në Kosovën e lirë!

Me një parafrzim të kalkuluar, mund të thuhet se të gjithë ata kanë shkuar për strehim të përkohshëm. Të ndjekurit politik mbështesin satisfaksionin në gjetjen e veprimit politik edhe në ato mjedise, me pretendime të qarta që të kthehen në vendlindje. Skamnorët e sigurojnë kafshatën e bukës për familje dhe për të tjerët që kanë ngelur në vendlindje. Atyre sikur u ka mbetur e vetmja shtegdalje. Kur të analizohet problemi politik dhe ai ekonomik, pothuajse kanë thellësi dhe dimensione të njëjta. Përcaktimi i aktiviteteve politike në horizonte të gjera të mundësive dhe ballafaqimit dhe të pranimi të çfarëdo sakrifice nga çfarëdo kundërshtari ka qëllimin e vet. Të nënshtruarit ekonomikisht janë gati në pozitë edhe më të vështirë. Ky është dimension i më makabër që e nënshtron individin, nderin, familjen. Zaten, pushtuesit serb gjithmonë përpiqen të luajnë në këto karta. Një pjesë të lojalitetit mundohen ta gjejnë nëpërmjet kësaj forme. Edhe kjo shtresë, e krijuar pas dëbimit masiv me dhunë të shqiptarëve nga vendet e veta të punës, shpreson në stabilizim dhe kthim më të shpejtë në Kosovë. Shtresa tjetër që konsiderohet se numerikisht është më e madhja, e që për qëllim e ka gjetjen e rehatisë ose të ndonjë përfitimi, e mendon gjithësesi kthimin, por para së gjithash "rregullimin e letrave" - siç komunikojnë mes veti, me çka nënkuptohet sigurimi i statusit të azilantit.

Të gjithë këta, natyrisht, me përjashtime të theksuara, në çastin e nisjes për në ato mjedise, nuk

kanë pasur qëllime të jetojnë në ekzil për një kohë të gjatë dhe përfundimi është gjithësesi i ndërlidhur me kthim sa më të shpejtë. Mirëpo, praktika i demanton këto përcaktime. Edhe ata që derdhën lot si lumi pas një kohe u ballafaquan me formësimin e një tabllaje tjetër të jetës, të një imagjinate tjetër, shkatërruese për shqiptarët.

Realisht, në këto çaste nuk janë në gjendje të shohin këtë shkatërrim, ngase ky është si një erozion i padukshëm, i cili kur del në shesh, edhe atëherë përcillet me arsye time, "fakte", me ngushëllime të cilësisë së gjërave të perënduara. Do të ishte anakronike dhe vetëvrasëse të mendohet se shqiptarët duhet të ngelin hermetikisht të mbyllur e të mos e shijojnë botën, të mirat e të këqijat e saj, sikurse kishte ndodhur pesëdhjetë vjet nën kthetrat e sistemit totalitar komunist, ndonëse është po aq e pakuptimtë që një numër jo i vogël të joshet për atë që nuk është fare e vetja e që assesi nuk mund të jetë, por që në mënyrë dhe mendje të turbulluar e "shohin si parajsë të kësaj bote". Gjithësesi vlerat e arritura në të gjitha fushat duhet të çmohen realisht, t'u kihet lakmi, por me një vetëdije të fortë, të mbështetur në orientimin e gjetjes së mundësive graduale që ato t'i arrijnë, në vendin e vet, në vatrën tonë, në mënyrë që të jemi të barabartë me të civilizuarit nëpër botë. E kaluara e largët nuk na mungon në këtë drejtim. Të tashmen nuk e kemi as afër. Por, që nuk duhet të jemi të pashpresë dhe këto ambiente të huaja vetëm të na shërbejnë si udhërrëfim, mësim për përvetësime të së mirës për avancim, me qëllim që t'u afrohem sa më afër të zhvilluarëve, atyre që tash na fascinojnë me të arriturat dhe perspektivën që i kanë.

Në tërësinë e çështjes së shtruar është e nevo-

jshme të gjidhen edhe relacione të tjera. Sjellja e të shkuarëve në Turqi, përgjithësisht ishte tjetërfare në krahasim me të mërguarit në shtetet e Perëndimit. Ata që shkuan në Turqi, para se të niseshin, detyroheshin të shlyhen nga regjistrat e kadastrit, për t'iu humbur çdo e drejtë dhe gjurmë me vendin e vet dhe, kështu fati i tyre që në nisje ishte i vulosur. Prandaj, në çdo mjedis që u vendosën bënë përpjekje për të gjallëruar, ishin lojal me punë e veprime, me djersë e mund siguruan bazamentin e ardhmërisë. Në këto specifika rrallëkush u gjend që të bëjë ndonjë bishtërim, sepse një gjë e tillë do t'u hakmerrej. Kësisoj, bëhen të devotshëm në punë, nëpër luftëra, për ekzistencë, si dhe në jetën e përditshme.

Edhe nga ata që derdhen lot si lumi, me rastin e përqafimit me vatrën e ngrohtë, me rrethinën e gjerë, thuajse ngjanë diçka e papritur. Por, diçka i tërhiqte në këtë tokë të largët: fëmijët kishin mundësi t'i shkollonin, nëse dëshironin, të moshuarit disa nisin të gjejnë punë, një pjesë tjetër kënaqet nga parazitizmi. Në këtë dezorientim që zgjatë me vite të tëra, rrallëherë gjenden vendime të prera. Shi për këtë, ka edhe të rinj, por edhe të tjerë, që këtë periudhë kalimtare e shfrytëzojnë të bëjnë edhe vepra të ndryshme, të pahijshme, asosh që e degradojnë këtë popull para syve të opinionit më të gjerë dhe autoriteteve, nga të cilët kërkohet mëshirë dhe ndihmë. Imixhi i tillë, i padëshiruar, reflektohet keq edhe te ata që kanë sjellje të mira dhe shfaqin edukatë dhe sjellje të mirëfillta. "Veprimtarët e skandaleve" nuk veprojnë vetëm kalimthi, por zgjerohen, sa që epilogu nganjëherë është tragjik. Në këtë mënyrë shqiptarët në shtetet e Perëndimit, bëhen të pa dëshiruar. Kështu, drejtpërdrejtë apo në forma të tërthorta, si qytetarë non grata, përndiqen nga

pushtetet e atjeshme, kuptohet nga të këtushmit dhe kështu mund të fitojnë epitetin e një populli të guditshëm, të pa civilizuar. Ky epitet ndërtohet shumë lehtë edhe nga fakti i lëkundjeve në Shqipëri, lëkundje këto që e kanë vënë në dilemë edhe tërë botën: të meditojë dhe të analizojë këtë shtet dhe këtë popull. Këta me sjellje të pakuptimta, frapante, nuk janë dobiprurës as për familjet e veta. Prandaj, humbjet janë të shumëfishta.

Krahasimet janë të mundimshme. Në Turqi shqiptarët shkonin me vendim të prerë: që të jetojnë atje përgjithmonë dhe të mos kthehen kurrë në vendlindjen e tyre. Atje bënë ç'mundën për interesin e shtetit të parapëlqyer, madje nganjëherë u treguan edhe më të devotshëm se sa vendësit. Lojaliteti u krijoi një imixh pozitiv dhe të qëndrueshëm. Kjo gjendje në një mënyrë i ndoqi pa përjashtime të gjitha gjeneratat.

Në shtetet e Perëndimit (në Gjermani e tjerë) ngjanë e kundërta. Shkojnë përkohësisht, dhe një numër i vogël, një numër i caktuar nuk zgjedhin mjete dhe metoda të veprimit. Vërtetë, veprimtaria e tyre tejdimensionohet shumë më tepër se sa është realiteti, sepse këtë e mundëson fushata propagandistike, e një makinerie tejet të organizuar e qëllimkeqe e sllavëve, të cilët me kohë i kanë locuar filialat e veta dhe me programe të definuara më parë veprojnë në këtë drejtim. Mirëpo, kjo le të mbetet çështje në vete. Sado që deklarativisht janë me gjithë mendje të lidhur me vendlindjen, nuk mbesin të liruar edhe nga etja që të qëndrojnë sa më gjatë në ato mjedise. Gjatësia e kohës së qëndrimit dhe dymendësia janë gjëra shumë të rrezikshme, ngase mjediset në fjalë kanë gravitacione më të forta. Ata veprojnë në kahe të përvetësimit, të shkrirjes, të adaptimit për kohë relativisht të shkurtër.

Implementimi i shumë çështjeve bëhet rreth shqiptarëve. Në njëfarë dore, politika aktuale e autoriteteve të Kosovës, e partive politike, madje as e familjeve nuk është e formës së prerë, e një dëshire që kthimi të bëhet menjëherë. Mirëpo, çfarëdo kohëzgjatje, shpie në drejtim të rrezikimit të qenies kombëtare. Me të kaluar të dy-tri gjeneratave, ose më pak, fundi përmbillet me asimilim të plotë. Pa dyshim, asimilimi në shtetet e perëndimit do të jetë shumë më i ngutshëm se në Turqi. Një prej arsyeve është niveli më i lartë i zhvillimit ekonomik, kulturor dhe civilizues. Asimilimi do të jetë imediat për fëmijë që rriten dhe edukohen nëpër ato ambiente.

Për refugjatët në vendet e perëndimit është i pranishëm edhe një rrezik tjetër. Me përjashtime të vogla, shqiptarët janë të kyçur dhe të avancuar në profesione të veta (mjek, inxhinier, ekonomist). Pra, edhe intelektualët e profileve të ndryshme që kanë shkuar prej këndej, veçse amortizohen, sepse distanca nga informacionet dhe nga inovimi i diturisë gjithnjë thellohet. Pjesa tjetër, sidomos shtresa e pashkolluar ngelin në gjysmë të rrugës. Ata janë të dënuar të mirren me çkado, të kryejnë punë nga më të rëndat, më të papërshtatshmet, të nivelit më inferior. Dhe, si të tillë, ekziston droja se do të mbesin atje edhe në periudhat e ardhshme. Kështu statusi i tyre do të jetë i huaj dhe i nënçmuar.

Së këndejmi, për të gjitha vendet, për të gjitha kohët, funksionon një formulë e përbashkët, me nuanca të padukshme të dallimeve, që kanë tendencën e ndihmës në çastet e caktuara, por që përfundimet janë fatale. Për këtë nuk janë fajtorë shtetet. Shqiptarët fajn duhet ta kërkojnë dhe ta gjejnë në vete. Ndihma duhet të matet në dy kahe: sa është ndihmë e përnjëmendët, sa dobiprurëse

dhe, sa është bumerang, fatkeqësi e llojit të vet. Me bredhje të pandërprera nëpër botë, populli shqiptarë do të shndërrohet në endacak, në hiçgjë, në qenie tjetër, në një pozicionim tjetër. Roli i shteteve të ndryshme, me peshë të përkushtimeve të veçanta për zgjidhjen e çështjes shqiptare, sipas këtyre recetave, më shumë është negative se sa pozitive. Shqiptarët rrugdaljen për prosperitet mund ta gjejnë, para së gjithash, në flakjen e lypësisë, në forcimin e vetëdijes për t'i vënë në spikamë virtytet parësore dhe të rangjeve tjera, si dhe për kthimin e tërë energjisë aty ku duhet, në vendin e vet. Këtu, në follenë që quhet atdhe, është ardhmëria, e jo në vendet e huaja. Vendet e huaja mund të respektohen dhe ndaj tyre të ekzistojë dozë e mirëfilltë e konsideratës, e bashkëpunimit dhe e mirëkuptimit. Ndërkaq, fati gjendet në duart vetjake, e jo jashtë, pra, çdokush fatin e ka në duar të veta, e jo në duar të tjerëve. Në këtë rrafsh po të mos gjendet zgjidhje fatlume, lumi i tragjikës veçse do të bymehet.

18. SUBLIMIME TË PREMISAVE TË TRAGJIKAVE ME PËRMASA KOMBËTARE

18.1. Motivi për hartimin e eseut

"...Që nga shekulli XI, kishte filluar të krijohet kombi shqiptar, nga ilirët jo të hebrejizuar, jo të arabizuar, jo të greqizuar, jo të romanizuar, jo të armenizuar, jo të turqizuar-osmanizuar dhe jo të sllavizuar. Kombi shqiptar, anipse ishte vazhdim i kombit ilir, duke ruajtur gjuhën, doket e zakonet si dhe territorin apo djepin ilir, tek shqiptarët identiteti kombëtar shqiptar ende mbeti në nivel të ultë. Shqiptarët, në pikëpamje të identitetit kombëtar, marrë në përgjithësi, janë të luhatshëm, dhe lehtë asimilohen në kombe të reja."

Skënder Rizaj

Kombet nuk janë vetëm realitet i privilegjuar, por një dhunti e natyrshme, krijesë kolektive, që dallohen me diçka nga të tjerët. Diferencimi është parakusht i identifikimit, i definimit të kombit të

caktuar. Sociologët mund të thonë se kombi është tërësi etnike, e një grupi të madh, që është formuar në sajë të kushteve të krijuara shoqërore, historike, që ka disa tipare të përbashkëta të gjenezës, ashtu edhe të madhësisë referente, të dalluar me thesarin e kulturës nga të tjerët. Ekonomistët nga këndi i tyre më tepër njohin mënyrat e prodhimit, zhvillimin ekonomik dhe madhësinë e faktorit demografik në rolin e prodhuesit dhe të konsumatorit. Dashtë e padashtë, përkufizohen në popuj dhe kombe, të cilat janë të diferencuara për nga niveli i zhvillimit, për nga subkultura (kultura kombëtare) dhe ajo që është e ndërlidhur me faktorë ndikues të rrethinës në sjelljet e tyre.

Kombi është një grup i veçuar, i pjesës së përgjithshme të njerëzimit, i cili rrënjët i ka të hershme, që është dalluar me emër (ndonëse gjatë periudhave emërtimet në përgjithësi kanë pësuar metamorfozë), me attribute të sjelljeve, të veçorive etnike, të gjuhës dhe të mënyrës së jetës. Me të kaluar të kohës, disa janë definuar më herët pikërisht nga shkaku i dominimit, jo për tjetër, por për nga aspekti i forcës. Kur bëhet fjalë për forcën, duke kërkuar, në rend të parë, bazamentin material, ekonomik, me çka mund të arrihet mirëqenia më e mirë, mbrojtja dhe forca ushtarake. Disa popuj arritën që nëpër disa etapa të caktuara kohore, nëpër periudha jo aq të gjata, përkatësisht relativisht të shkurtëra, të forcohen në pikëpamje ekonomike dhe ushtarake, të dominimit dhe të espansionimit nëpër territore të huaja. Të tjerët, që nuk ishin si ata, rrudhen, zvogëlohen, involvohen në diç të pakëndshme, të nënshtruar. Natyrisht, në dualizëm është vështirë të fitojnë të dy anët kundërshtarë. Edhe po të ngjanë ndonjë presedencë, pa dyshim, baraspesha do të jetë e rrallë ose nuk do të ekzistojë fare.

Mund të ndodhë që në një anë të jetë vetëm një forcë (lexo:komb), i cili, pa marrë parasysh veçoritë që i ka, është vështirë t'i përballojë rrëmujës në cilësinë multi, të përbërë nga disa kundërshtarë. Në këtë rrafsh bëjnë pjesë shqiptarët. Ata sikur gjenden në mes të gjindëve, në mes të përbindëshve, të mëdhenj e të vegjël, të locuar në rrethinën imediate. Këta, sado që një nga një nuk kanë potencial të jashtëzakonshëm, me të bashkuar në front të përbashkët, formojnë koalicion të rrezikshëm dhe të fortë kundrejt një populli të vetmuar, i cili specifikë e ka lashtësinë, kulturën e moçme, autoktoninë dhe një jetë të bujshme nëpër disa periudha. Ç'është më e rëndësishmja, përkundër rrethit të dendur të grabitçarëve, rezistenca e pjesërishme nuk shuhet asnjëherë. E pjesërishme mund të jetë në kuptimin e një pjese të mbetur të popullatës dhe të territorit, por që edhe kështu e mbajnë gjallë të vërtetën e pamohueshme të territorit, por që edhe kështu e mbajnë gjallë të vërtetën e pamohueshme të gjenezës, të ekzistimit dhe, po ashtu, të perspektivës së këtij populli.

Epokat historike ishin të disfavorshme për shqiptarët. Kryqëzatat pushtuese të trojeve ilirike e në vazhdimësi të shqiptarëve nuk kanë të ndalur nëpër shekuj dhe milienume. Lakmitë greko-romake bënë hendekun më të thellë, për të krijuar rrënoja nëpër territorin e gjerë ilir, në zvogëlimin e popullsisë të njohur me potencial të madh për kohën e atëhershme.

Në botë, dihet, kurrnjëherë nuk janë zhdukur konfliktet, aspiratat për të sunduar dhe nënshtruar. Në këtë prizëm, në antikë edhe Ilirët lanë prova të shumta, të cilët me luftërat e organizuara mirë, me ushtri të dalluar, me flotën detare ndër më të fortat,

depërtuan në toka tjera dhe pushtuan rajone të gjera në Siujdhesën Ballkanike dhe në Apenine. Me thyerjen nga ushtria romake, ky popull e merrë tatëpjetzën e përhershme, një lëngim të paparë nën zgjedhën e të huajve. Kësisoj, rezistenca bëhet gati e pamundshme, pikërisht nga shkaku se sa herë që u ndërruan pushtuesit, këta ishin të pushtuar, të rraskapitur dhe të pafuqishëm për ndonjë organizim të mirëfilltë. Më e keqja qëndron në faktin se perandoritë pushtuese mbi këtë popull ushtruan sundime shumëvjeçare, prej dy, pesë e më shumë shekujve (Romakët dhe Turqia nga pesë shekuj, Bizanti më se dhjetë shekuj, Serbia më se dy shekuj, me kohën e tashme që është duke e vazhduar regjimin kolonialist dhe okupues).

Koha kaq e gjatë, nën thundrën e pushtuesve të përбетuar, e bënë deri diku të veten. Me të gjitha metodat, deri te ato më barbaret, bëhen përpjekje për zhdukjen e këtij populli që ta kthejë në diç tjetër dhe për te të flitet vetëm për një raritet të harruar.

Perandoritë Romako-Bizantine, luftojnë si në garë për shndërrimin e famës së këtij populli në një harresë të plotë. Në çdo kohë të pamundshmën e bëjnë të mundshme, duke i rrënuar thesarët arkeologjik dhe duke i kthyer në të vet, nën stilin e mohimit të çdo gjëje të cilësisë iliro-shqiptare, duke i asimiluar në një substancë tjetër. Ndërrimi i perandorive, i pushtuesve, popullin shqiptar e gjejnë të pakrah, pa pasur mundësi të gjejnë rrugë kah të fluturojë. Bizantizimi në të gjitha dimensionet, gjerësisht e thellësisht depërton në të gjithë popujt e robëruar dhe të nënshtruar, pra, edhe te shqiptarët. Romanizimi aspiratat e veta i gërsheton dhe i shkrinë edhe me pushtues të mëvonshëm në tokat veri-perëndimore iliro-shqiptare, ku lëshon rrënjë të

thella, aq sa për t'i çrrënjësuar në tërësi ato të mëparshmet. Ardhasakët sllav zbatojnë metoda edhe më vandale, në planin e tjetërsimit dhe të mohimit të popullsisë, madje dhe të territoreve, që ishin pronë e shqiptarëve. Turqizimi paraqet epokë tjetër, e cila karakterizohet me tipare nënshtruese, okupuese, si çdo pushtues që vepron në rajonet e pushtuara.

Në këtë kronologji fatkeqe, të zgjatur për shumë shekuj, ç'është e vërteta, shqiptarët u pushtuan vetëm njëherë, përkatësisht pjesërisht dy herë, ndërsa u nënshtruan gjithëherë. Pushtimi i tyre ngjau vetëm pas disfatës së luftërave të gjata romako-ilire, kur Iliria bie nën sundimin romak. Më pastaj, shqiptarët nënshtrohen vazhdimisht, ndonëse pushtimi bëhet te Prandoritë e regjimeve ekzistuese. Kështu, nuk mund të thuhet se shqiptarët u pushtuan nga Serbia në Mesjetë, as nga Turqia më vonë. Serbia e then dhe e mund regjimin bizantin, ndërsa Turqia e then regjimin serb. Populli shqiptar ishte i robëruar më herët dhe kështu veçse i ndërrohen padronët. Prandaj, është vështirë dhe e pamundshme në kushte të tilla të ndryshojë pozicionimin, sepse kokën e kishte nën zgjedhë të huaj, e cila sërish i vihet nën zgjedhë tjetër, të huaj. D.m.th., mobilizimi, vetëmbrojtja janë dimensione të pandashme, por të pamundshme në kushte specifike, kur popullata është dërrmuar, e gëlltitur nga ideologjizmat, religjionet e ushtruara gjatë mbi punën dhe shpirtin e saj.

Shqiptarët, edhe si të këtillë, dhanë prova për çlirim. Luftërat e Skënderbeut, të disa personaliteteve të tjera, të Lëvizjes dhe Lidhjes së Prizrenit, luftërat për çlirim të viteve 1908-1912, dhanë rezultate. Sado që ato qenë afatshkurtëra konfirmojnë

mbetjen e vetëdijes së diferencuar të një populli diferent, të veçuar, që ka për aspiratë çlirimin e vet dhe uljen në fron të vetin, siç dëshmon historia për të parët e tyre.

Kronika shqiptare është dramatike. Mangësitë e saj janë të shumta. Para së gjithash, për këtë popull nuk u shkrua sa duhet, çdo gjë që ishte e mundur u përvetësua nga të tjerët, iu tjetërsua, iu emërtua si e tjetërkujt. Beteja ekzistenciale u zhvillua në tri dimensione:

1. në rrafshin e ekzistencës faktike, të rrudhur dhe të reduktuar shumë,
2. në emigrimet e pakthim dhe në tjetërsim të përhershëm dhe,
3. në asimilimin vendor, nga pushtuesit e ndryshëm.

Këto tërësi përmbajnë tragjikën kombëtare. Përrjashtim bën dimensionin faktik ekzistencial, i cili sadokudo mbanë vulën e domethënies së faktorit relevant, rreth të cilit lidhen dhe zvarriten problemet dhe tërë këtë rropatje e vë në korniza të caktuara, nga të cilat nuk dilet lehtë, pa vënie në spikamë edhe të dimensioneve tjera, të tjetërsimit, qoftë në trojet autoktone etnike, apo në hapësirat jashtë tyre.

Gjurma e mbetur, jo në kuptimin e raritetit hartografik, por si një mundësi e resursit të pashuar, përafërsisht e barabartë me të tjerët që e rrethojnë (si me numër dhe me disa veçori tjera) e përmbanë esencën e anëve pozitive dhe negative të tërë temës bosht. Është pozitive e pashmangshme mosshuarja e plotë e këtij populli, sado që jeton i rrethuar dhe në kushte të vështira nga grabitqarët e paskrupulltë. Ndërkaq, negativja mund të kërkohet në substancën e formuar të vetëdijes se në ç'mënyrë është dashur të ruhet edhe më shumë, në të gjitha periudhat

kohore: dje dhe sot, për të dhënë përgjigje edhe për kohën që vjen, për të nesërmen.

Nuk do të sjellë dobi vetëm narracioni, si nga aspekti i të metave dhe i anëve tjera pozitive. Është i domosdoshëm sublimi racional dhe objektiv i faktografisë, pa u zbrapsur nga e vërteta historike, shoqërore, psikologjike, politika e robit, vetëdijes, ndërdijes së padefinuar sa duhet, e formësimit të platformës për ardhmërinë e motiveve për ruajtjen e asaj që ka mbetur, për thadrimin në kokë të rikrijimit të qenies së re, si kompensim i vakuumeve, të zbrastësive, të prapësive të imponuara nga pushtuesit. Njeriu i ri, i mbështetur mbi të gjitha në konceptin kombëtar, nuk mund të ketë themelin e vetëm të së sotmes. Ai e ka më herët, por tash duhet të plotësohet vetëdijësimi, zbrastësitat e mbetura, të përfituara nëpër etapa të caktuara kohore.

18.2. Mbijetesa e shqiptarëve - veçori madhore

*"Shqiptarët janë të zgjuar. Për
mbrojtjen e vendit të vet bashkohen.
Janë të aftë dhe të talentuar."
Shejhylislami Xhemalledalin*

Shqiptarët, në kontekstin e përgjithshëm mund të vështrohen nda dy kënde: si humbës të mëdhenj dhe si fitues të vegjël. Humbja ka të bëjë me zvogëlimin e popullsisë deri në minimum, me territoret e zvogëluara më se dhjetë herë, me përvetësimin nga të tjerët të një pjese të rëndësishme të kulturës, të krijimtarisë së begatë. Ndërkaq, si fitim i vogël konsiderohet mbetja e popullsisë dhe e

territorit kështu siç është, sado të rrudhur, por që e ruajnë kontinuitetin e mbijetesës.

Mbetja e një numri të vogël të shqiptarëve (në kompaktësinë territoriale nja shtatë milionë, ndërsa së bashku me diasporën më tepër se 10 milionë, përafërsisht 12 milionë), në territorin e reduktuar në sipërfaqe prej nja 60 mijë kilometra katrorë të banuar me shqiptarë, paraqesin dëshmi, prova relevante për mbijetesën e këtij populli të lashtë. Vërtetë, mbijetesë e shqiptarëve është çështje në vete: sa e çuditshme aq edhe madhështore. Gjithnjë përballë furtunave asimiluese, nënshtrimeve brutale, megjithatë, mbetën aq sa mbetën, me çka nuk u humbas prejardhja, tiparet që i kanë kombet moderne. Dimensioni i mbijetesës është tejet i çuditshëm, kur merret parasysh fakti se afro 22 shekuj (nga viti 168 p.e.r.) bie nën kthetrat e të huajve, nën regjimet me norma dhe sjellje drakonike dhe represive, me të cilat, pushtetmbajtësit pa ndërprerje tentojnë shkrirjen e plotë të këtij etniteti, humbjen e gjuhës dhe çfarëdo mëvetësie e veçorie tjetër. Nivelet e zhvillimeve të atyre kohëve, dalja në skenë e religjioneve, kalimi në monoteizëm, mënyra e jetesës, zhvillimi ekonomik, shtresimi struktural i popullsisë, bëjnë të mundur hapje të dialogjeve dhe të meditimeve, për t'i vënë në pah, së paku sqaruar këtë element, pa dyshim fenomenal. Në dëm të transversales ekzistenciale vepronin dy faktorë: koha, që rëndom është e pamëshirshme në transformimet dhe në metamorfozat e popujve dhe, shtypja, okupimi, imponimi i pushtetit të huaj me të gjitha normat keqbërëse, sa për të krijuar popullësi lojale, të dëgjueshme dhe harrestare për vetveten. Pushtimet shumëshekullore kanë të njëjtën valë: okupimin. Vetëm firmosjet ndryshojnë, varësisht

nga pushtetet që e marrin fronin. Pushtetet e reja mbi popullin e dërrmuar nga pushteti tjetër, gjejnë diç të përshtatshme, të trasuar për veprime të mëtejshme. Merret për bazë vazhdimësia kontinuele, e diferencuar vetëm me nuanca të metodave të veprimit.

Për shqiptarët rëndom krijohet një jetë e mbyllur, e rrethuar, e stërshtypur, si në një vorbull që vlon në të gjitha anët dhe kapaku i rëndë nuk mundëson dalje. Perandorët, mbretërit e sulltanët e shihnin këtu një element që duhet tjetërsuar, shtypur deri në shfarosjen fizike. Në këtë plan arritën shumëgjë: asimilimin dhe shndërrimin e një numri të madh në popuj me emra dhe me veçori tjera. Synimet për t'i shlyer emrat e tyre edhe nga hartat e vjetra, mbetën iluzione të copëtuara. Në rrethin e përmbytjeve mbetën pak, ndonëse në kuptimin e mbijetesës edhe një mbetje e tillë ka peshë specifike mjaft të rëndë.

Pushtetet famëkeqe mbetën të pambrojtura plotësisht nga një grusht i formuar herët, me rrënjë të lëshuara thellë, me degë të prera e të thyera, disa syresh përgjithnjë, por edhe me degë që përgjithmonë mbetën me sytha dhe gjethe të pavyshekura.

Po të bëhet analogji me shumë popuj, të cilët njerëzimit i lanë thesar të kulturës, ngase në Antikën e hershme patën të gjitha prerrogativat e superioritetit (bie fjala babilonasit, e tjerë) shihet se më në fund mbetën vetëm gjurmë e asgjë tjetër. Shqiptarët nuk u pajtuan të regjistroheshin në librin e të humburëve plotësisht. Lidhur me këtë veçori të daluar të mbijetesës nevojiten trajtime të gjithanshme, për të ndriçuar të vërtetën e hidhur, por krenare, të thyerjes sadopak të përpjekjes të ndërmarrësive vandale të pushtuesve për të shndërruar tërë këtë popull në rrënojë të përherëshme.

Natyrisht, ngritja e krenarisë në ndonjë pedestal të lartë, nuk ka vend meritore, duke e marrë parasysh përpjesëtimin në mes të humbjes dhe të mbetjes. Ndërkaq mbetja, edhe kështu siç është paraqet simbolikën e vlerës së pashembur të mbijetesës. Në trajtimin e kësaj teme duhet përkufizuar disa argumente, me të cilat fitohen prova bindëse për të ndriçuar diç që mund të quhet fenomenale, e rrallë dhe karakteristike për popujt e robëruar dhe të nënshtruar. Të gjithë pushtuesit e tokave shqiptare, njëri pas tjetrit, nuk patën për qëllim ngritjen, konsolidimin e shqiptarëve, por ngritjen e vetes. Ata nuk folën shqip, veçse latinisht, greqisht, italisht, serbisht, sllavisht, turqisht... Ata nuk sollën receta për ruajtjen e traditës kulturore të krijuar me shekuj të tërë, por në programet e tyre kishin të definuara shpërbërjet e plota, madje edhe me metoda vandale, për fshirjen e gjurmëve të kulturës materiale dhe shpirtërore.

Ata nuk erdhën t'i ruajnë toponimet e përgjithshme të gjetura këtu, autoktone, burimore, por si detyrë të parë patën ndërrimin e onomastikës dhe përshtatjen në gjuhën e vet.

Ata nuk erdhën të zhvillojnë ekonominë shqiptare, por, përkundrazi, ardhja e tyre kishte për qëllim shkatërrimin e saj të plotë, faktikisht eksploatimin e paskrupullt të resurseve natyrore, të të gjitha llojeve të dhuntive që i gjetën në këto troje. Pushtimi i tyre kishte mbështetje në politikën afatgjate të shpopullzimit të tokave shqiptare nga elementi shqiptar, duke i shkrirë ata në etnitete tjera ose duke i larguar nga tokat e të parëve të tyre. Këto katrahura, të përsëritura dhe të zgjeruara shekuj me radhë, e tëhollojnë perin e këtij populli të robëruar, gati deri në këputjen e plotë. Megjithatë, falë

vitalitetit të njëmendët, të veçorive të popujve të rrallë, të cilët përkundër përballjeve trishtuese, të rrëpihshme, afatgjate, ruajtën aq sa mundën të ruajnë, atë më të rëndësishmen në këto kushte. Gjuhën shqipe nuk e rifilloi ta mësojë përsëri, ngase këtë e pati pronë të patjetërsuar, me burimin e fakteve për të identifikuar lashtësinë dhe kontinuitetin ekzistencial dhe të mbijetesës. Përpjekjet e pushtuesve nuk patën mundësi të kurorëzohen me zëvendësimin e kësaj gjuhe me fonetikën dhe gramatikën e tyre. Kjo ishte më e fortë, më e lashtë dhe më e ëmbël. Kundrejt një numri të konsideruar që u struk në foletë e tjerëve, ku gjetën strehë dhe pranimin e së keqes, mohimin e vet të gjithmonshëm, mbeti pjesa tjetër, e cila në çdo mënyrë i bëri sfidë politikës së armikut dhe atë e urrejti me dinjitetin më njerëzor, më civilizues, duke e ruajtur autencitetin, emrin e vet. Në mbarëvajtjen e këtij procesi, pati vështirësi, lajthitje, pengesa dhe çka jo tjetër. Mirëpo, u gjend formula e pashkruar, e sedimentuar në themel të shtruar që moti, e cila mundësoi pengimin e tretjes së plotë në bashkëdyzime të reja. Nga aspekti ekonomik, herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, e herë në mënyrë të tërthortë, u ruajtë dozë e theksuar e mëvetësisë. Pozita gjeostrategjike, begatitë natyrore, si dhe sistemi i krijuar ekonomik nëpër formacione shoqërore zhvillimore, sikur u shndërrua në traditë, nga e cila ruhet një tërësi e veçantë, që ka disa ndikime në forcimin dhe realizimin e mbijetesës.

Në këtë vazhde shqiptarët janë popull i rrallë, që pësoi shumë nën thundrat e huaja, por që nuk u zhduk krejtësisht. Në mënyrë të ngjashme pati fatin populli Zhid i Izraelit, i cili ishte i rrethuar nga arabët, nga bizantinët e tjerë, dhe lëngoi pa shtet të vetin shekuj me radhë. Ka popuj edhe më tragjikë,

siç janë kurdët, të cilët sot e kësaj dite iu mohohet edhe minimalja. Shqiptarët janë të ballafaquar me realitetin: për të qenë apo për të mos qenë. E sotmja është shtresim i marramendjeve të shumta përgjatë më shumë se dy milienumeve. Është kjo çështje në vete, që imponon studim të thellë, ndonëse assesi të shkëputur nga konteksti historik, i katrahurave të tmerrshme, i varreve, në të cilat shqiptarët nuk u strehuan tërësisht, nuk i lejuan vend vetes në ate të amshueshme, në humbëtorë të plotë.

Kur bëhet fjalë për mbijetesën e shqiptarëve në kushte tejet të ndërlikuara, duhet pasur parasysh faktorin e pushtuesve. Pushtuesit fqinj gjithmonë janë më të rrezikshmit. Ata në mënyrë gjithpërfshirëse imponojnë metoda të paskrupullta të shkrirjes dhe asimilimit. Janë prezent në të gjitha fazat dhe proceset. Prania e drejpërdrejtë e popullatës pushtuese në ambientin ku jeton populli i robëruar, krijon hapësirë më të gjerë të veprimit. Të mbështetur në supromacinë, epërsinë e regjimit, të forcës, bëjnë presion në përhapjen e tmerrit, për të arritur përqafimin e nënshtrimit gradual, madje intensiv, të ngutshëm. Pushtues të shqiptarëve qenë kryesisht fqinjët (me përjashtim të Turqisë), grekët, sllavët dhe llatinët (italianët). Përjashtim bën Turqia, veçanërisht nga pikëpamja e radiusit të largësisë, e cila për këtë shkak nuk ishte në gjendje të shpronësojë, të shkrijë plotësisht elementin shqiptar. Serbia mesjetare, me shumicë ka asimiluar shqiptarë, edhe pse periudha e sundimit ishte më e shkurtër në krahasim me regjimet tjera.

Një gjë e tillë arrihet në saxe të fesë së njëjtë dhe pranisë së elementit sllav në të gjitha mjediset, në dasmë, gazmende tjera, në mort. Kleri sllav orthodox nuk kishte për qëllim të predikonte atë që

e imponon feja; për te thelbësore ishte realizimi programatik i shndërrimit të shqiptarëve në sllavë. Priftat shqiptarë, ndonëse kishin të njëjtat libra të shenjta, të njëjtin predikim, ishin të detyruar të jenë nën mbikqyrjen rigoroze të priftërinjve sllavë (shih: Konstantin Jireček, **Istoriya srba, I, II, Prosveta, Beograd, 1988** dhe publikime tjera). Ngërthimet dhe fërkimet e çdoditshme, kontaktet e përditshme qëllimkëqia, bëjnë të mundur shuarjen graduale të popullit të pushtuar. Paskrupullsia e arrinë kulmin dhe përdorimin e dhunës, jo vetëm nga aspekti psikologjik, por edhe fizik.

Kisha orthodoxe greke, njëra nga krahët më reacionarë, lufton gjithashtu për eliminimin dhe mohimin e popullit shqiptar. Ajo bën çmos në zhvlerësimin e tërë arsenalit të kombësisë shqiptare. Në këtë drejtim, edhe kur kishte të përbashkët fenë orthodoxe, elementi grek zbaton mënyrat më barbare dhe brutale kundër shqiptarëve. Atyre sa herë që mundet iu imponon shkëputjen nga trangu i vet, nga qenësorja, për të krijuar një simbiozë, me intensitete të theksuara, për mohimin e popullit autokton. Tendencia e tyre, siç është rasti edhe me sllavët, është prezente edhe në të tashmen. Greqia ka përvetësuar tokat shqiptare (Çamëria etj.), por nuk është kënaqur me kaq, prandaj e ëndërron edhe pjesën tjetër të Epirit Verior (siç e quan Vorio Epiri). Serbia nuk është e kënaqur me marrjen me dhunë të trojeve shqiptare të sanxhakut të Nishit, me mbajtjen koloni të Kosovës dhe të viseve tjera jashtë Shqipërisë, por sa herë që i jipet rasti synon të depërtojë edhe në pjesët veriore të Shqipërisë. Mali i Zi tërë mirëqenien strategjike dhe ekonomike e ka arritur në saxe të uzurpimit të tokave të shqiptarëve. Maqedonia tërë

mirëqenien materiale e gjeostrategjike e ka të mbështetur në tokat shqiptare.

Perandoria Osmane nuk cilësohet me diç tjetër, përveç me objektivat e tjetërsimit dhe të asimilimit. Në fakt, regjimi i saj është kundërthënës, madje edhe në doktrinat fetare. Librat e shenjta nuk mundësojnë mohimin e kombeve dhe të gjuhëve. Përkundër kësaj, shqiptarëve iu mohohet përkatësia kombëtare, gjuha, simbolet, kultura dhe tradita. Predikimi i mirëfilltë fetar sqaron se kombi është më i vjetër se feja, sepse është i imponuar, sipas përkatësisë prindore, të identifikuar dhe kombësi të caktuar. Feja është përcaktim i vullnetit në fazën e pjekurisë intelektuale. Këto attribute shkelen nga regjimi osman. Shqiptarët i quajnë me emër tjetër, të cilëve, bëjnë përpjekje t'i rrënojnë edhe gjuhë tjetër. D.m.th., asgjë mangut nga të tjerët për përfshirjen, materializimin e plotë të këtij plani poshtërues. Kësisoj, administrata, ushtarakët, autoritetet e ndryshme turke, nuk janë në gjendje të fusin në qenie tjetër substancën, frymën e tërësishme të tyre.

Duke i vënë në spikamë vetëm disa nga dimensionet e shumta, mbetet çështje e rëndësishme elementi shqiptar edhe kështu siç është. Përballimi me gjithë këto furtuna, çfarëdo popull do ta dobësonte. Në realitet, shqiptarët janë dobësuar në do pikëpamje, ndonëse nuk janë çrrënjësuar krejtësisht. Mbijetesa e tyre, edhe në këso kushtesh shumë të rënda, simbolizon forcën e rrënjës, shtresimin dhe shtrirjen e gjerë të fiseve ilire nëpër territore të gjera, bazën e tyre materiale dhe shpirtërore, origjinalitetin e gjuhës dhe të qëndrueshmërisë së saj, vitalitetin, kulturën, traditën dhe atributet tjera, që i cilësojnë kombet e civilizuar.

Së këndejmi, çështja e shqiptarëve nuk do të ishte çështje e parëndomtë, virtuoze, sikur të mos gjendej në këtë mozaik të problemeve. Pështja e rrethinës e bënë të veçuar dhe i vënë në trajtesë pietetet, pa i lënë pasdore edhe mangësitë përcjellëse.

18.3. Disonanca në mes vitalitetit dhe mangësive të popullit shqiptar

*"...Ah, atëbotë
duhej të vdiste i madh e i vogël
e t'mos lejonin kët' t'keqe kaq t'madhe."
Mikel Maruli Tarkanjota*

Ekzistenca e tanishme, edhe për aq sa ka mbetur, e popullit shqiptar është provë dhe dëshmi e vitalitetit të këtij kombi. Ky u përballë me probleme të shumta, sidomos të natyrës së pengimit të formësimit të kombit, për ndryshim nga shumë popuj tjerë. Gjatë tërë historisë ideologjia e pushtuesve kishte mbështetje në dy kahe:

1. në shfrytëzimin e pasurive të natyrës, të pozitës gjeostrategjike si dhe
2. në zhdukjen e popullatës vendëse, për të pasur më pastaj mundësi për pronësi legjitime të të gjitha trevave shqiptare.

Kjo e para, eksploatimi dhe shfrytëzimi është realizuar plotësisht, ngase normat pushtuese iu kanë mundësuar që të gjitha rezultatet të shkojnë në hambarët e shtetit sundues. Ndërkaq, e dyta, ka pasur vetëm konotacione të pjesërishtme, pasi që, përkundër dhunës dhe terrorit, gjenocidit të pandërprerë, nuk është arritur të fshihet nga harta tërë elementi shqiptar. Është kjo pasojë e vitalitetit,

të një burimi të pashterrshëm, të një rrënje të lashtë, e cila kishte krijuar superioritet në kohën para se të ishte okupuar, përparësi në shumë fusha kundrejt popujve tjerë për rreth dhe më gjerë.

Faktori i dimensionit ekzistencial flet më së miri për fondin e pashterrësisë së tërësishme të këtij kombi. Mirëpo, kur vihen në raport anët, ecuritë pozitive, me mangësitë dhe sindromet negative, mund të shihet disonancë mjaft e theksuar. Në këtë rrafsh asnjëherë nuk mund të vëhet shenja e barazimit, ndonëse si rezultatë e specifikave të shumta, është vështirë të gjendet baraspesha. Sidoqoftë, duhet trajtuar në stilin se ekzistojnë të dy anët, të mirat dhe të këqiat. Te secili popull janë të pranishme këto dy tërësi. Secila variron nga tjetra, duke e dhënë rezultatin më të madh apo më të vogël.

Për shqiptarët mund të nxirren premisa të veçuara, që dalin nga tërë kompleksi i sublimuar i çështjes. Në një anë, sfidimi i pamohueshëm i situatave të ndërlikuara dhe armiqësore, është cilësi tepër e vlefshme, që nuk zëvendësohet me asgjë. Në anën tjetër, disa veprime nuk e lënë pa njollë tërë virtuoze të, e bëjnë problematikë të diskutueshme, të cilës vështirë i gjendet fundi. Është fjala për ngulmimet në arritje të mëdha, të sukseseve impozante të shteteve që i mbajnë nën sundim. Janë të njohur emra të shumtë, në cilësinë e burrështetasve të shquar, të krijuesve, artistëve, qeveritarëve, ushtarakëve, që nga periudha romake, madje ajo bizantine, turke, kur personalitetet shqiptare krijuan emër dhe lanë nam të pashlyer. Këta i kontribuan shteteve, nën ombrellën e të cilëve gjendeshin, që ishin të sunduar dhe të trajtuar si të nënshtruar. Pa dyshim, në rolin e sundimtarëve e shtypën edhe popullin e vet, për t'ia ruajtur ekzistencën dhe pres-

tigjin shtetit okupues. Shumëherë, shqiptarët, si individë krijuan dhe lanë vepra madhore, me çka shtetet dhe regjimet pushtuese u afirmuan dhe u zgjatë jeta e dominimit. Nga pikëpamja kolektive, po ashtu, sa herë që u mobilizuan, në suazat e politikës dhe regjimit të pushtetmbajtësve, nuk mbetën pa rezultate.

Tërë ky kontribut mund të kuptohet si shkathtësi, aftësi, vitalitet i pjesëtarëve të këtij kombi. Është kjo veti fascinante, ndonëse sa i përket përgjegjësisë që këtë rol ta kenë lozur për shtetin e vet, hapë temë tjetër, tejet të gjerë, si dhe të ndërlikuar. Diskrepanca e interesave dhe locimit të veprimeve aty ku duhet, apo ku nuk duhet, mund të arsyetohet se në shpirtin e këtij populli ka ndikuar robëria e gjatë, politika e robit, por mbi të gjitha potenciali dhe energjia që e posedon, të cilën në një formë a në një tjetër, disi duhet të shfaqë, të manifestojë. Me këtë sikur vepron ligji i entropisë, me të cilin gjërat vihen në lëvizje, pa marrë parasysh se për kë janë të favorshme.

Në kontekstin e kësaj pjese të çështjes, gjithësesi është më mirë që nga gjiri i këtij populli (lexo: të nënshtruar, të okupuar), lindën emra të mëdhenj, se sa të mos kishin kurrëfarë emri të shquar. Do të ishte më e pranueshme që tërë atë mund, kreativitet ta mbillnin për interesat e kombit dhe të shtetit të vet, të shtetit që nuk e patën, por që duhet ta formonin. Fijëzimi i detajeve shpie gjithnjë e më tepër te thellësitë dhe në errësirat e labirinthit, por që ato në formë të caktuar, është e udhës të zgjidhen, të ndriqohen, të përfillen.

Ndër mangësitë më të theksuara mund të konsiderohen ikjet e shpeshta nga vetja. Shpërnguljet e tilla, vërtetë, nuk janë të pamotivuara, porse kur

merren për bazë tejdimensionimet e tyre, patjetër paraqesin kaptinë në vete, të atillë që duhet trajtuar seriozisht. Rruga më e lehtë, sikur të jetë shpërngulja, pa e llogaritur mirë se kujt i lihen trojet, plangu dhe pasuria, malli, atdheu dhe pronësia stërgjyshore. Kësisoj, zgjedhja e problemit për të ikur nga përbindëshit, nga ata që i gllabërojnë shpirtërisht dhe fizikisht, nuk është vendimi më fatlum dhe i qëlluar. Në këtë kontekst, problemi është shumë më i thellë, seç duket në shikim të parë. Shpërnguljet masive nga trojet e veta, pa marrë parasysh në cilën periudhë kohore, paraqesin saktosjen më të tmerrshme të tërësisë së kombit. Duke dëshiruar të ruhet diç, humbaset edhe më shumë, duke tentuar të ruhet ndokush, në një farë dore humbaset ngapak çdokush. Ikjet e shpeshta dhe masive nuk mund të vështrohen jashtë kontekstit të vetëdijes kombëtare, të mos thadrimit të bindjes se mbi të gjitha është ruajtja e kombit. Ruajtja e kombit, faktikisht mund të bëhet, nëse paraprakisht sigurohet kushti i vetëm: shteti, sovraniteti i tij. Largimi nga vendi i vet, pa marrë parasysh a e gëzon mëvetësinë apo gjendet nën okupim, përmban aktin kundërthënës me tendencën se me këtë mënyrë ruhet diçka nga qenësorja.

Migrimet janë dukuri e pranishme te të gjithë popujt tjerë në botë. Dhe, tejdimensionimi analitik mund të devalvojë këtë plagë, ta bëjë nganjëherë më tepër romantike, se sa një të ligë të qenë të popullit përkatës. Edhe popujt e civilizuar, ata që më herët e kanë fituar lirinë dhe sovranitetin, e kanë të zhvilluar shtetin, ekonominë, mirëqenien në përgjithësi, siç janë për shembull gjermanët, të cilët përkundër të arriturave në shtetin e tyre nuk ndalen nga proceset migratore, sidomos drejt Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, posa t'iu jepet rasti dhe kur e gjejnë interesin më të madh. Edhe popujt tjerë veprojnë në këtë mënyrë. Prandaj, këto lëvizje migratore gjithëmonë janë të pranishme dhe sado që janë pjesë e realitetit të hidhur, ato ekzistojnë. Në këtë vazhdë, as te shqiptarët nuk mund të kërkohet ndonjë përjashtim i posaçëm.

Mirëpo, shtruarja e problemit të emigrimit të shqiptarëve ka të bëjë edhe me disa specifika, që nuk mund të maten me të tjerëve. Së pari, ky është popull i vogël, i zvogëluar pikërisht nga gllabëruesit përreth. Memzi ka mbetur madhësia e sotme. Çfarëdo lëvizje në kuptimin e emigrimit, këtë popull e dëmton dukshëm, sepse edhe kështu siç është, përmbanë dëmtime tejmase. Përgjysmimi i disahershëm, i shndërruar gati në refren tragjik, kësaj popullate ia ka zvogëluar potencialin dhe strukturën dhe, së këndejmi, pushtuesve iu ka krijuar shansë të ushtrimit të reprezalieve më të vrazhdëta, më çnjerëzore, për të nënshtruar deri në maksimum pjesën e mbetur. Nga kjo prizëmë duhet të vështrohet edhe problemi i shqiptarëve. Së dyti, vetëm prania e shqiptarëve me pjesëmarrje më të madhe në tërë popullsinë e tokave shqiptare, e ruan relevancën e fakteve për legjitimitetin e autoktonisë në këto troje. Shpopullëzimi i këtyre viseve shkon në favor të armikut, sepse për ekzistencën faktike dikur veçse mund të flitet dhe çdo gjë mund t'i takojë vetëm të së kaluarës, aktualiteti mbetet i zvetënuar dhe i përmbushur vetëm me dëshira të parealizueshme. Shembull eklatant që shërben si provë e këtij konstatimi janë tokat shqiptare të tërë rajonit të Sanxhakut të Nishit, të cilat pas krizës së Lindjes (1875) u shpopullëzuan me dhunë nga elementi shqiptarë dhe tash për këto vise vetëm nostalgjia mund të

mbijetojë. Paqartësia e problemit bëhet edhe më e madhe, kur gjërat vetëm përmenden, porse nuk kuptohen rrënjësisht. Në këtë prizëm mund të zhvillohen teoretizime, që mund të jenë në shpërputhje të plotë me realitetin praktik. Plaga e lëshuarjes së vatrave stërgjyshore nuk është duke u mbyllur. Përkundrazi, ajo thuase vjen e zgjerohet.

Zgjerimi i rrugës mërgimtare është çështje në vete. Në këtë rrafsh duhet të zhveshen disa elemente, që janë diametralisht të kundërta me periudhat e kaluara.

Derisa për Lëvizjen Shqiptare të Lidhjes së Prizrenit, e cila në kushte të disfavorshme shënoi epokë të ndritshme, potenciali dhe struktura e popullsisë ishte heterogjene, madje me bindje homogjene përse i përket moskundërshtimit të padishahut, e sotmja nuk duhet të jetë e tillë. E njëjta analogji vlen edhe për luftërat çlirimtare të viteve 1908-1912, me të cilat u sendërtua çlirimi i tokave shqiptare, duke e përfshirë edhe Shkupin, kryeqendrën e katër Vilajeteve shqiptare, por ato ishin të prira dhe të udhëhequra nga një numër i vogël i tribunëve popullor, por edhe më të vogël të njerëzve të ditur e të shkolluar sipas rangjeve dhe niveleve botërore. Kur vëhet në raport me të sotmen, pa dyshim lind nevoja për diskutim, sepse kemi të bëjmë për dy tërësi me cilësi plotësisht të diferencuara. Edhe Lufta e Dytë Botërore nuk kishte kushte të sotme, sa i përket plejadave të kuadrave të shkolluara, vetëdijes kombëtare. Për të gjitha këto epoka të mëparshme, me të drejtë mund të thuhet se mungesa masive e zhvillimit, bëri të mundur ngecjen në kuptim të formësimit të vetëdijes kombëtare. Këtij fakti kur ia shtojmë lakadredhat që i patën shqiptarët gjatë historisë, të cilët e patën vështirë të

ngrisin kokën dhe veten ta quajnë me emër të vet, çështja bëhet edhe më e ndërlikuar. Pra, në kohën e formimit të kombeve, shqiptarët nuk patën shansën të definojnë veten deri në fund. Kjo mangësi, jo për fajin e tyre, la zbrastësira edhe në kokat e njerëzve, në tërë kombin, për të mos peshuar si duhet dimensionin kombëtar. Laryshia e problemit bëhet edhe më kolorite, kur relativizohet edhe më tepër nëpërmjet shpërnguljeve dhe veprimeve, shpeshëherë të pakontrolluara.

Nëse atëherë arsyetimet për shumëçka gjenden në mungesën e kuadrit të popullsisë së arsimuar, tashmë një gjë e tillë nuk ka vend. Sado që edhe tash ekzistojnë mangësi të shumta në përfshirjen e procesit të arsimit, kur shkalla e analfabetizmit të shqiptarët është mjaft e theksuar, dosido struktura e tanishme arsimore, vetëdija shqiptare në të gjitha tokat shqiptare është më e avancuar. Prandaj, lajthitjet, gabimet e tashme janë shumë më të rënda se sa ato të djeshmet. Në këtë kontekst mund të thuhet se edhe okupatorët nuk kanë ndejur duarkryq; ata kanë shënuar zhvillim, përforcim, gjë që edhe tash avancimi i shqiptarëve përballet me një armik më të perfeksionuar, sa i përket arsenalit ushtarako-polikor, propagandimit dhe metodave tjera djallëzore. Është kjo e vërtetë e pamohueshme, siç është e vërteta tjetër, që ka të bëjë me vetëdijësimin, përkatësisht me shtimin e ndërgjegjës të kombit të shtypur, i cili aspiratat për pavarësi dhe çlirim nuk i shfaqti vetëm dekadave të fundit, por ato i shfaqti edhe më herët, madje jo vetëm në mënyrë retorike, por edhe me vepra madhore.

Fundja, te shqiptarët ekzistojnë disonanca të theksuara. Disa vepra janë shumë parimore, prijetare, që në çdo rrjedhë mund të përkujtohen me

pietet të njëmendët. Ka po ashtu të tilla që nuk iu përngjajnë të parave. Përkundrazi, ato i zvetënojnë dhe i komprometojnë. Kjo nevojitet të jetë pasqyrë, në ballë të së cilës duhet të gjenden të gjithë. Të shohin veten ku gjenden dhe çka duhet të veprohet në korrigjimin e mundshëm të mangësive.

Shqiptarëve iu nevojitet konsolidim i gjithanshëm, i gjithëmbarshtëm. Në veçanti, ata që e përbëjnë kompaktësinë e autoktonisë, patjetër atë duhet ta përforcojnë vazhdimisht. Lëshuarja e trojeve, pa arsye të pashtekdalje, nuk mund të gjejë mbështetje në asnjë kohë. Ajo që deri tash ka ngjarë, sidomos në kohët e mëhershme, është e pamundur të korrigjohet. Mirëpo, e tashmja ende gjendet në mundësinë e marrjes së vendimeve meritore. Lakmia ndaj Perëndimit është shkatërrim i vetvetes. Perëndimit dhe çdo shteti tjetër të zhvilluar duhet t'i lakmohet në kontekstin e mobilizimit, të kthjellimit, të aftësimin, të gjetjes së strategjive, të rrugëve të tyre të zhvillimit, me qëllim që të shërbejnë si model dhe qasje për t'i arritur ato. Shtet pa popull nuk ka. Pavarësia e shtetit jo vetëm që nuk mund të mbërrihet, por është e pakuptimtë pa popull. Pavarësia nevojitet pikërisht për resursin njerëzor.

Për të gjitha çështjet duhet të kryqëzohen rrafshet e pasqyrave. Matja e largësive, e realiteteve, e anëve pozitive dhe negative, shpie deri te vlerësimi objektiv i të gjitha çështjeve, pa marrë parasysh cilës kohë i përkasin. Virtyti kombëtar duhet të jetë pronë e ardhmërisë. Evropianizimi i çështjeve, edhe i asaj shqiptare, nuk është zgjidhje fatlume, pa përcaktimin decidiv të tërësisë etnike shqiptare. Arritja dhe realizimi i kësaj aspirote është i mundshëm, po që se bazament bëhet vetëdijësimi kombëtar, deri në masën e çfarëdo sakrifice. Me këtë lakmia do të

marrë kahe të kundërt: kthehet kah shteti i përbashkët shqiptar.

Ato që kanë ngjarë (në kuptimin negativ) mund të mos ngjajnë. Ato që nuk kanë ngjarë (në kuptimin pozitiv) mund të ngjajnë. Nevojitet timon i riparuar në duar të riparuar. Domosdoshmëri janë kokat e denja për respekt të vetvetes. Historia i ndërron rrjedhat, nga njerka mund të shndërrohet në nënë, nëse shqiptarët vet e drejtojnë ardhmërinë. Lidhur me këtë nevojitet shumë punë dhe mund, porse çdo gjë është e mundshme.



*Rrugëtimi nëpër Vilajetin e Samsunit (gusht, 1997).
Për ke këndon gjeli?*

PËRFUNDIM

"E vërteta buron nga çdo zemër njerëzore dhe njeriut i duhet që ta kërkon aty dhe të udhëhiqet nga e vërteta, ashtu si e sheh atë. Por, askush nuk ka të drejtë t'i detyrojë të tjerët që të veprojnë sipas pikëvështrimit të tij për të vërtetën".

Gandi

Tragjedia e një populli nuk është pse ai është i vogël, por sepse e zvogëlon veten. Shqiptarët kanë historikun e vet të lashtësisë, me pararendësit e tyre, të njohur me emrin Ilirë. Në kohën e ilirisë shtrirja e tyre ishte e gjerë, së paku dhjetë herë më shumë se sa ka sipërfaqe shteti më së i përgjysmuar shqiptarë, ose nja pesë herë më shumë se sa tokat e tashme në kompaktësinë unike të banuara me shqiptarë (brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë).

Për shkak të pushtimit shumëshekullor, te populli shqiptarë ngjajnë tronditje të njëpasnjëshme. Njëri ndër problemet më të theksuara është emigrimi. Me ndërrimin e pushtuesve dhe pas kryengritjeve kundër tyre pasojnë shpërnguljet masive, për t'i ikur reprezalieve dhe shtypjeve nga regjimet që dalin fitimtare. Dyndjet e shqiptarëve, më herët të Ilirëve, fillojnë që nga pushtimet e tokave të tyre nga hordhitë romake, më pastaj edhe gjatë Perandorisë Bizantine. Luftërat e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane paraqesin digën më të fortë të pengimit të shtrirjes së mëtejme nëpër shtetet

e Evropës. Kjo epope e lavdishme, sa ishte e rëndësishme në kontekstin e gjerë evropian, aq ishte fatale për popullsinë shqiptare, ngase më pastaj një numër i madh shpërngulet për në Jugun e Italisë dhe gjatë. Më tej, përfundimi i luftërave austriako-turke në fund të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII, epilog e ka shpërnguljen masive të shqiptarëve të Kosovës për në rajonin e Banatit, përkatësisht të Hungarisë. Tronditje shumë e rëndë është ndjekja me dhunë e shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, prej ku në vitin 1878 shpopullëzohen nga shqiptarët afro 700 vendbanime. Popullsia e dëbuar vendoset në Kosovë dhe dëshmi identifikuese janë mbiemrat, të cilët në të shumtën e rasteve i mbajnë edhe sot (mbiemrat sipas vendbanimeve të tyre të mëhershme). Me shpërbërjen e Perandorisë Osmane dhe riokupimin e tokave nga sllavët (serbët e malazezët) në vitin 1912, hapet sërish derë e gjerë për shpërngulje masive. Turqia bëhet vend prijtar që i pranon qindëra mija shqiptarë. Vargimi i shpërnguljeve zgjatet gjatë tërë shekullit XX. Për shtatë dekada rresht, me intensitete të ndryshme, rrugën e pakthim për në Turqi e marrin disa qindra mijë shqiptarë. Ekzodi është më i dendur sidomos në mes Dy Luftërave Botërore, pas marrëveshjes së arritur në mes Jugosllavisë së Versajit dhe Turqisë (të nënshkruar në vitin 1938). Vazhdimësia e shpërnguljeve masive nuk përfundon me kaq. Marrëveshja vazhdon të zbatohet edhe pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë viteve të pesëdhjeta, kur arrihet marrëveshja xhentëlmene në mes Jugosllavisë së AVNOJ-it dhe të Turqisë.

Atdhe i ri për shqiptarët, e një pjese të tyre, bëhet Turqia. Sipas të dhënave të paverifikuara konsiderohet se në popullatën e Turqisë me prejardhje

shqiptare janë 5-6 milionë banorë. Natyrisht, ky numër është i shumëzuar me shumë gjenerata të lindura atje. Popullata shqiptare është e dispersuar pothuaj në mbarë Turqinë. Nëpër vilajetet e saj më të njohura qërthullojnë oaze të shumta të shqiptarëve. Enklavat janë herë të mëdha e herë të padukshme. Faktikisht atje njihen me emrin arnaut. Prej shumë vilajeteve të njohura, dallohet edhe Vilajeti i Samsunit, i cili përmbanë një oazë të veçantë të popullatës me origjinë shqiptare, të cilët në këtë ambient kanë filluar të vendosen që nga viti 1913/14. Ndër komunat e banuara me këtë element etnik është e njohur Bafra. Në atë mjedis edhe sot e kësaj dite janë të pranishme mjaft simbole të shqiptarëve, siç është gjuha, tradita, besa dhe virtyte tjera, që i kanë bartur nga atdheu i tyre.

Me trajtimin e kësaj çështjeje vehen në pah prova të shumta, që i dëshmojnë pasojat dhe gollgotën shqiptare, të krijuar nga okupatorët serbomalazez. Shqiptarët si popull i përvuajtur dhe i vyeshëm, në mjedisin ku jetojnë kanë krijuar emër dhe përgjithësisht i mbanë krenia e të parëve, por edhe e gjeneratave të mëvonshme. Duke u thelluar në këtë problematikë, mësohet për një plagë të rëndë, e cila te shqiptarët ka zënë vend me vite dhe shekuj të tërë.

Në mjedisin e vështruar shqiptarët të përcaktuar në cilësinë e banorëve të përhershëm, prandaj, nuk njihen inferior. Asimilimi është i patjetërsueshëm, gjë që është e kuptueshme, ngase peshku i madh e gëlltit të voglin. Dhe, ç'është e rëndësishme, ky popull për atë shtet ka dhënë personalitete të shquara, figura me kalibër historik, që kanë kontribuar në formimin, zhvillimin e Perandorisë, por edhe të Turqisë së re moderne. Në sajë të kësaj,

enklavat e shqiptarëve janë të shtrira kryesisht në vise të volitshme, me kushte të mira për jetesë.

Në kontekstin e trajtimit të kësaj teme, sado që parciale, por që shërben si mostër e zgjedhur, me të cilën ilustruhet mjaft afër edhe përfshirja e gjatë e kësaj popullate në mbarë shtetin. Çfarëdo analize që bëhet në këtë segment, veçse i ndriçon pedatjet e një populli të përvuajtur e të pambrojtur, të shtypur për shumë shekuj e të përballur me gjenocid të pandërprerë nga pushtetmbajtësit sllav. Asgjë nuk mund të ndryshohet dhe, faktikisht, hyrja në trajtimin e kësaj problematike, as që ka këtë qëllim.

Ç'është e vërteta, ekzodi i shqiptarëve nuk ka të ndalur as aktualisht. Një numër shumë i madh (konsiderohen më se gjysmë milioni) e kanë marrë botën në sy, pikërisht viteve të fundit, gjatë viteve të 90-ta. Drejtimi dhe kahu i shpërnguljeve ka ndryshuar. Popullsia e të gjitha moshave, me strukturë heterogjene arsimore janë drejtuar kah shtetet Perëndimore të Evropës. Përpiqen të gjejnë strehim të përkohshëm në shtete të ndryshme, si bie fjala, në Gjermani, Zvicër e gjetkë, deri edhe përtej Atlantikut, në SHBA dhe në Australi. Duke e vështruar tekstin e eseve për jetën, realitetin e shqiptarëve në Turqi, mund të definojnë premisat e epilogut, të cilat janë të sigurta për shqiptarët. Analogjikisht, kushtet janë tjera në shtetet e Perëndimit në krahasim me Turqinë, andaj, edhe procesi i asimilimit është edhe më specifik dhe i ngutshëm. Së këndejmi, as presioni ushtarako-policor, gjendja kaotike në Kosovë, reprezaliet më çnjerëzore që i bëhen popullatës shqiptare, nuk e arsyetojnë këtë shpërngulje kaq të madhe.

Për këtë arsye shqiptarët duhet të përgjigjen në pyetjen: Për kë bie këmbana? Shfaqja e aspiratave

për pavarësi dhe sovranitet, në mënyrë të sublimuar duhet të nënkuptojnë edhe sakrificën. Faktografia për pronësinë e tokave shqiptare e ka mbështetjen pikërisht te popullata e këtij etniteti, që është e pranishme. Zbrazja e Kosovës dhe e viseve tjera shqiptare nga elementi autokton, pushtuesit veçse ia lehtëson zgjidhjen e problemit, për të bërë pastrimin e qetë etnik, për dallim nga ai i shekullit XIX, kur shkretërohen nga kjo popullatë tërë rajoni i Toplicës, i Kosanicës dhe i Pusta Rekës, përkatësisht i tërë rajonit të Nishit nëpërmjet hordhive ushtarake. Tashmë për këtë rajon sall mund të flitet se i kujt ka qenë. Mungesa e popullatës autoktone krijon artikulum memec dhe të paqëndrueshëm.

Me sublimimin e eseve dhe të udhëpërshkrimeve lidhur me shqiptarët në Vilajetin e Samsunit, aktualisht secili mund ta gjejë veten, që zgjedhje të mundshme e ka gjetur diasporën. Sado që tash mendohet në diç të përkohshme, përfundimi mund të jetë fatal, i rrezikuar nga asimilimi dhe tjetërsimi i pashmangshëm dhe i plotë i kësaj pjese të popullsisë. Fundja, shqiptarët janë popull i vogël, që të jenë në funksion të burimit të pashtershëm për t'u zgjeruar kaq shumë nëpër meridiane të largëta. Duke kërkuar rehatinë, humbasen qenësorja: kombi. Humbaset edhe pjesa e mbetur, e reduktuar në mënyrë drastike, ndonëse e sfiduar nga vitaliteti i një populli të lashtë, i njohur me shumëçka në histori.

Prishtinë, shtator-nëntor, 1997

Dr. Ali Jakupi

TO THEM KOSOVA IS A DREAM
(Albanians in the region of Samsun)

Summary

Tragedy of a nation is not in being small, but in that he diminishes itself. Albanians have their ancient history in their ancestors known as "Ilir". During the Iliria they were wide spread, at least ten times more than the borders of today's state of Albanians of five times more than the territories today inhabited with Albanians (in and outside borders of Albania).

Because of centuries of occupation Albanians had continuous perturbations. One of the major problems was the migration. With the change of the occupiers and after the revolt against them, followed the massive migration, to be saved from the violence and repression of the winning side. Migrations of Albanians and early of Ilir's start with the occupation of the Romans and after with the occupation of the Byzantine Empire. Wars fought by Skenderbeu against the Osman Empire represent the wall which prevented its expansion in the countries of Europe. These glorious times as much as was important within the European context, was fatal to Albanians, because, a great number of them migrated to South Italy and in other places. Then with ending of Austro-Turk wars by the end of the XVII century and at the beginning of the XVIII century. The epilogue is migration of Albanians of Kosova to the region of Banati, in Hungary. A heavy perturbation was the violent pursuit of Albanians from Sanxhaku of Nish, where during the year 1878 are depopulated about 700

dwelling. The pursued population is settled in Kosova and as an identification proofs are the surnames, which in the most cases they bear them even now (surnames of the earlier dwelling residences). With the fall of the Osman Empire, and with the reoccupation of Albanian territories by Slov's (serbs and Monte Negrons) in 1912, a massive wave of migrating Albanians. This migration continued during the XX century. For seven decades thousands and thousand of Albanians took the one way ticket going in Turkey. The exodus in dense between the two World Wars, after the agreement that Yugoslavia of Versaille and Turkey signed in 1938. The agreement continued to be applied after World War Two, during the fifties when was achieved a gentlemen's agreement between Yugoslavia of AVNOJ and Turkey.

A new fatherhand to Albanians becomes Turkey. According to unverified informations there are about 5 to 6 million people in Turkey with Albanian descenting. Of course these figure are multiplied with the number of the generations born there. Albanian population is dispersed in the whole territory of Turkey. The enclaves are sometimes big sometimes invisible. They are known there by the name "arnaut". One of known regions is the one of Samsun, which consist of an enclave with the population of Albanian descentings, which have started their settelment since 1913/14. Bafra is a commune known with this ethnic element. In this enviroment there can be noticed many Albanian symbols such as the language, tradition, besa, and other virtues, brought from their homeland.

Analysis of this matter shows proofs of suffering of Albanians, made by the serb occupiers as a nation that has suffered and as working nation has made his place in the environment where he lives and are proud in their ancestors.

In these territories they have settled themselves in a permanent manner so they don't feel inferior. The process of assimilated is inevitable, which is undestormable, because the big fish swallows the little fish. And what's important, this nation has given to the Empire and to modern Turkey distinguished figures. Thanks to this the Albanian enclaves are spread in the territories with good conditions for living. Within the context of treating this there, even parcial as it is, it's a model that shows quite closely the dispersion of this population in the whole country. Any analyses shows the attempts of a nation undefended, quelled century after century, suffering and facing the constant genocide of slav regimes. Nothing can't be changed, and the fact is that, treating this matter doesn't have intention on doing this.

The truth is that exodus of Albanians is not stopped yet. A great number of Albanians (about 500.000) has migrated during the '90 is of this century. The direction of migration is changed. Population of all ages, with heterogeneous educating structure is turned to Western Europe countries. Trying to find temporary settlement in different countries such as Germany, Switzerland even USA, and Australia. Reading the essay on life, motives and reality of Albanians in Turkey, you can define the epilogue about these Albanians. The conditions are different in Western countries compared to them in Turkey, so this makes the process of assimilation is specific and pressing. And this can't be justified with the military police pressure, unstable situation, repression.

That's why we must answer the question: For whom the bell tolls? The aspiration for independence and soverignty includes sacrifices to Albanians, is based on it's population. Emptyin Kosova and other Albanian

regions we're making the job easier to the occupiers on ethnical cleansing from the non Slavic element in quite way, contrary to the one in the last century where the region of Toplica, Kosancia, Pusta Reka, in fact the whole regions of Nish was deserted from this population.

The sublimation of these essays on Albanians of Samsun region, anybody can find himself which has chosen diaspora as a possible solution. Eventhough it is ment to be a temporary solution, it might have fatal ending, endangered from assimilation, and inevitable alternation of these part of population. Still, we're a small nation, we can't afford to be widened so far in distant meridians. In a search of comfort we're losing the nation. We're losing the remained part, reduced drastically and challenged by the vitality of an ancient nation, known for lots of things in history.

Dr. Ali Yakupi

KOSOVA ONLAR İÇİN BİR HAYAL

Samsun İlinde Yaşayan Arnavutlar

Bir ulusun trajedisi onun küçük bir ulus olması değil kendisini küçümsemesidir. Arnavutlar İlriler olarak adlandırılan atalarından kadar uzanan çok eski bir tarihe sahiptirler. Arnavutların İlriler zamanındaki yayılma sahaları çok geniş olup şu anda varolan Arnavut Ülkesi topraklarının en azından on kati ya da tüm Arnavutların (Arnavutluk içi ve dışı) yaşadığı alanların en azından beş kati olarak bulunmaktaydı. Uzun asırlar süren işgaller sebebiyle Arnavut Ulusunda birbiri ardınca sarsıcı olaylar yaşanmıştır. İşgalcilerin (işgal kuvvetlerinin) değişmesi ve onlara karşı olan ayaklanmalardan sonra toplu göçler meydana gelmiş, kazanan rejimlerin baskı ve zulümünden kurtulabilmek için kaçmak zorunda kalmışlardır. Arnavutların bu çalkantıları (dolaşımları) Romalıların İlrilerin topraklarını işgal etmeleriyle başlamış ve sonrasında ise Bizans İmparatorluğunun saldırılarıyla devam etmiştir. İskender Bey'in Osmanlı İmparatorluğuna karşı.

Yaptığı savaşlar Osmanlı'nın Avrupa Ülkeleri üzerine genişlemelerine önemli bir engel yaratmıştır. Bu şanlı savaşlar Avrupa genelinde olduğu kadar Arnavut Ulusu için de bir o kadar acı olmuştur çünkü Arnavutların büyük bir kısmı İtalya'nın güney bölgesi ve diğer bölgelere göç etmişlerdir. Hemen ardından Avusturya-Türk savaşlarının sona ermesiyle XVII yy. Sonu ve XVII yy. başlarında sonuç olarak Kosova Arnavutlarının Banat Bölgesine (Macaristan) toplu göçleri olmuştur. Arnavutlara karşı yapılan diğer vahim

bir sarinti ise 1878 yilinda Arnavutlari Niş Sancağındaki 700 kadar olan yerleşim bölgelerinde etnik temizliğin yapılmış olmasıdır. Kendi topraklarından kovulmuş olan halk da Kosova bölgesine yerleşmiştir. Bunu doğruluyucu kanıt ise kovulmuş olan halkın birçoğunun önceden orada yaşamış oldukları yörelerin adlarını soyadları olarak bugüne kadar getirmeleridir. Osmanlı İmparatorluğunun dağılması ve 1912 yılında Slavlar tarafından tekrar işgal edilmesi ile toplu göçlere tekrar geniş bir kapı açılmıştır. Yetmiş yıl süre ile devamlı olarak, değişik boyutlarda birkaç yüzbin Arnavut bir daha geri dönmek üzere Türkiye'ye göç yolunu almışmasıyla Birinci ve İkinci Dünya Savaşlarında artmıştır. Arnavutların bu toplu göçleri bu kadarla da kalmamıştır. Anlaşmanın uygulanması İkinci Dünya Savaşı'ndan sonra da devam etmiştir. Elli yıllarda Yugoslavya AVNOY ve Türkiye arasında varılan centilmenlik anlaşması ile göçler devamlılığını yitirmemiştir.

Türkiye artık geniş Arnavut kitlelerinin yeni vatanları olmuştur. Doğruluğu henüz kanıtlanmamış verilere göre Türkiye'de Arnavut asıllı olarak 5-6 milyon kadar insan yaşamaktadır. Doğal olarak bu rakam yeni yetişmiş olan kuşakların çoğalmalarıyla orantılıdır. Arnavutlar tüm Türkiye geneline dağılmıştır. Türkiye'nin en tanınmış vilayetlerindeki verimli arazilerin birçoğunu Arnavutlar işlemişlerdir. Arnavutlara verilen araziler bazen küçük bazen de büyük çapta olmuşlardır. Genelde Arnavut olarak çağrılmaktadırlar. Tanınmış birçok vilayetler arasında Samsun vilayeti de yer alır. Arnavutlar bu verimli arazilere 1913-1914 yılları arasında yerleştirilmiştir. Arnavutların yaşadığı en önemli bölgelerden biri de Bafra'dır. Bu yaşam ortamında bugün dahi Arnavutlara ait dil, örf ve adetlerle, besa (verilen sözü tutması sözünde durma) gibi

onları tanımlayan ve bir önceki vatanlarından taşıdıkları diğer özellikleri de hala yaşattıkları görülmektedir. Sirp ve Karadağ işgalcileri tarafından meydana getirilen bu sorunun birçok kez tartışılması Arnavut Ulsu'na ve doğurduğu kötü sonuçları kanıtlamaktadır. Arnavutlar çalışkan ve çok sorunlu bir ulus (çileli) olarak bulundukları ortamda atalarından da taşınmış oldukları değerlerle birçok isim yaratmışlardır. Bu olgu daha sonraki kuşaklarda da devam etmiştir. Bu soruna daha bir derine inerek böylece Arnavut Ulusunda yıllarca yüzyıllarca geniş bir yer tutmuş olan (önemli) yarayı öğrenmiş olduk. Gözlemlenen bu yaşam ortamında Arnavutlar orada devamlı yaşamış olan sakinler (vatandaşlar) niteliğinde kabul edilmişlerdir. Bu nedenle de kendilerini yabancı olarak hissetmemişlerdir. Bununla beraber asimile olmak kaçınılmazdır. Herkezin bildiği üzere büyük küçük balığı yutar. Önemli olan bir başka özellik de bu ulusun Osmanlı Devleti şanlı kahramanlar yetiştirip tarihi kişilikler çıkartarak, imparatorluğun gelişmesine yardımcı olmakla kalmayıp, Modern Türkiye'nin kuruluş ve gelişmesine yardım etmiş olmalarıdır. Bu sayede Arnavut arazileri uygun yerlerde beraberinde iyi yaşam koşullarıyla birlikte uygun bölgelere yayılmışlardır. Bu ulusun, ülkenin genelinde olan dağılımlarını bayağı yakından gösterecek, kısmi olmakla beraber, bu konunun tartışılması etrafında seçilmiş bir örnek olarak hizmet görmektedir. Bu alanda yapılan herhangi bir analiz çok sorunlu ve korumasız bir ulusun çabalarını yüzyıllarca Slav işgalcileri tarafından ezilen ve devamlı soykırımla karşı karşıya kalan bir ulusun çabalarını yalnızca aydınlatmaktadır hiç bir şey değiştirilemez ve bu konuyu tartışmamızın amacı da bu değildir.

Gerçek olan şu ki Arnavutların bu göçleri günümüzde de durmuş değildir. Geniş bir Arnavut

kitlesi (yaklaşık 500000 kişi) özellikle XX yy. in 90' yıllarında dünyayı göze almışlardır. Şimdi ise göçlerin yönü ve çizgisi değişmiştir. Değişik yaş ve eğitim ortalamalı Arnavutlar Batı Avrupa Ülkelerinden Almanya, İsviçre vb. Ülkelerde Atlas Okyanusu ötesindeki ABD ve Avustralya gibi ülkelerde geçici işinma hakkı bulmaya çalışmışlardır. Türkiye de yaşamakta olan Arnavutlar' in yaşamlarındaki gerçekler onları buna iten nedenlerden Arnavut Ulusu için güvenli olabilecek sonuçlar çıkarılabilir. Bilindiği üzere Türkiye de batı ülkelerine kıyasla koşullar başkadır. Bu yüzden asimile aşamaları çok daha belirli ve çabuk olmuştur. Bunu ne polis ne de ordu saldırıları, ne Kosova' daki karmaşık durum ve ne de Arnavut Ulusuna karşı yapılan en insanlık dışı muameleler dahi, bu kadar geniş boyutlu bir göçün gerekçesini açıklayamazlar.

Bu yüzden Arnavutların şu soruya cevap vermeleri gerekiyor: Çanlar kimin için çalışıyor? Bağımsızlık ve egemenlik yüksek ideallerinin tekrar belirmesi, vatan uğruna hayatını feda etme kavramlarını da beraberinde getirmektedir. Arnavut topraklarının sahiplilik hakkı özellikle üzerinde yaşayan etnik ulusun haklarına dayanmaktadır. Kosova ve Arnavutların yaşadığı diğer bölgelerin boşaltılması işgalcilerin etnik temizliği daha kolay yapmalarını sağlayıp, sorunun çözümünü çabuklaştırır (Otoktan elementten arındırma sorunu) XIX yy. da işgal ordusu istilalarından Toplitsa, Kosantsa ve Psuta reka (Tüm Niş Bölgesi) bölgelerinin boşaltılıp ıssızlaştırılmalarından daha farklı olmak üzere çok sakin ve sinsi bir şekilde Slav olmayan bir elementten etnik temizlik yapması kolaylaştırılmaktadır. Şimdi ise bu bölge üzerine yalnızca bir zamanlar kimin olduğu hakkında konuşulabilir. Etnik ulusun zayıflığı, daya-niksiz ve sakak bir olgu yaratmaktadır (belirtmektedir).

Samsun vilayetinde yaşayan Arnavutlarla ilgili yol açıklamalarımız ve araştırmalarımızdan bugün her Arnavut dolaylı ya da dolaysız olarak kendini bulmaktadır. Çünkü birçok kişi çözüm olarak yurtdışını seçmişlerdir. Her ne kadar geçici yerleşim olarak düşünülürse de sonuç geniş bir Arnavut kitlesi için, asimile ve kaçınılmaz diğer değişiklik tehlikeleriyle karşılaşacaklarından sonuç çok vahim olabilir. Netice olarak bu kadar uzak meridyenlere dağılmış olan Arnavut Ulusu canlılığını devamlı koruyan bir fonksiyonda kalmaları gerekmektedir. Yapılan bu göçlerle bu fonksiyon zayıflamaktadır. Çünkü Arnavut Ulusu geniş nüfuzlu bir ulus değildir. Rahatlığı (refahi) ararken (ulusa) en gerekli olan şey kaybolur: Millet! Tarihte birçok özellikleriyle bilinen bu kadar eski bir ulusun varlığı bugünde feci bir şekilde yok edilmek istenmektedir, buna karşı gelemezsek Arnavutların kalan kısmı da kaydolacaktır.



SHËNIME PËR AUTORIN

Ali Jakupi u lind më 23.06.1943 në Shallc (komuna e Vushtrrisë). Fakultetin Ekonomik e ka kryer në Prishtinë, ndërsa studimet pasunievristare (marketingun) në Zagreb.

Është doktor i shkencave ekonomike.

Ka punuar në kombinatin «Trepça» (në Mitrovicë) në arsim në Vushtrri, ishte drejtor gjeneral në këto ndërmarrje: ndërmarrja ndërtimore «Kosova» (në Vushtrri), në fabrikën e konfeksionit «Polet» (në Vushtrri), në ndërmarrjen gaztare botuese e grafike «Rilindja» (në Prishtinë).

Tash është profesor në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë dhe në Fakultetin Ekonomik në Tetovë.

Deri tash ka botuar më se 15 libra (tekste shkollore, vepra shkencore, publicistike, letrare), si dhe punime shkencore dhe profesionale.

Jeton në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

Parathënie, 5

1. Shekujt e përndjekjeve, 9
2. Kush e hapi rrugën për Turqi, 15
3. Shqiptarët nëpër vilajetet e Turqisë, 23
4. Vilajeti i Samsunit e mbanë gjallë shqipen, 31
5. Bafra - oazë e vërtetë e shqiptarëve, 39
6. Kush u shpërngul në Bafra, 49
7. Kujtimet e të gjallëve për shpërnguljet në Turqi, përkatësisht për në Bafra, 61
8. Udhëtimi me qerre të drunjëta e me qe, 69
9. Familja Sfarça e njohur jo vetëm në rrethinën e vet, 81
10. Periudhat e pedatjeve për në Turqi dhe brenda saj, 93
11. Shqiptarët me nga dy mbiemra, 103
12. Malli për atdhe zvetënohet gradualisht, 109
13. Në vilajetin e Samsunit (dhe në Turqi përgjithësisht) shqiptarët kanë krijuar emër, 119
14. Traditat që ende mbretërojnë, 131
15. Edhe anekdotat kanë domethënie shqiptare, 139
16. Çka ka mbetur nga shqiptarët e vilajetit të Samsunit, 147
17. Ç'ka të përbashkët Turqia me shtetet e Evropës për fatin e shqiptarëve, 155
18. Sublimime të premisave të tragjikave me përmasa kombëtare, 167
- 18.1. Motivi për hartimin e eseut, 167
- 18.2. Mbijetesa e shqiptarëve - veçori madhore, 173
- 18.3. Disonanca në mes vitalitetit dhe mangësive të popullit shqiptar, 181
- Përfundim, 191
- To them Kosova is a dream (summary), 197
- Kosova onlar için bir hayal!, 201
- Shënime për autorin, 206

Dr. ALI JAKUPI

PËR ATA KOSOVA ËSHTË ËNDËRR
- Shqiptarët në Vilajetin e Samsunit -
(udhëpërshkrime - ese)

Korrektor
Shpëtim Jakupi

Realizimi kompjuterik
VATRA
Valon J. Fetahu
Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën
INTERPRESS R. COMPANY
Prishtinë

KUD: 910.4(091)

JAKUPI, Ali

Për ata Kosova është ëndërr / Ali
Jakupi.- Prishtinë.- 1998.- Vatra.-
Prishtinë.- (Interpress R. Company:
Prishtinë).- 208 f.; 12,5x20 cm.

Tir. 500